

Janar 2020
Numri: 142
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

DHIMBJA DHE SHPRESA




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Janar 2020

VITI: XIV

NUMRI: 142

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Të gjitha vendet e umetit po përpëliten prej vuajtjeve. Kjo është e vërtetë. Nganjëherë ndjejmë dhimbje në Bosnje, nganjëherë në Arakan... Gjithmonë ndjejmë dhimbje në Turkistanin Lindor, në Palestinë, dhe në Çeçeni... Kudsit është plaga e zemrës sonë që s'po di të shërohet. Por gjithmonë ka shpresë.

Gjithmonë ka shpresë, sepse njeriu nuk mund të jetojë pa Islamin. Në një botë ku nuk ka myslimanë, është vetëm bota e kiametit. Andaj, nëse do të ekzistojë kjo botë, do të ekzistojë edhe Islami, edhe myslimanët...

Islami erdhi në një epokë kur njerëzit kishin degraduar. Islami e kapi njeriun për dore dhe i hyri përpjekjes për ta ndërtuar përsëri "pjekurinë njerëzore" që Krijuesi e emërton "eshrefi mahlukat / krijesa më fisnike". Ky mision ishte misioni i Muhamedit, (a.s.).

Njerëzimi në atë periudhë kishte marrë fund me plot kuptimin e fjalës. Të mos harrojmë se bëhet fjalë për një periudhë kur vajzat varroseshin në tokë të gjalla. Pra, po flasim për një periudhë të cilën Mehmet Akif Ersoji e ka përshkruar: "Njerëzit i kishin kaluar hienat në agresivitet. Nëse një njeri nuk kishte dhëmbë, atë e hanin vëllezërit e tij."

Muhamedi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ua mori zemrat atyre njerëzve, i mbrojti përsëri dhe prej atyre njerëzve u formua "umeti fisnik". Ky ishte ndërtimi nga zeroja i njeriut dhe shoqërisë. Edhe iniciativa për këtë ndërtim ka lidhje me të vërtetën se njeriu nuk mund të jetojë pa Islamin, sepse Krijuesi kështu e ka krijuar njeriun. Mungesa e Islamit është procesi i kalbjes së njeriut. Për këtë arsye, Islami është i domosdoshëm për të gjithë ata që kanë ardhur si njerëz në këtë botë.

Në këtë pikë edhe umeti Islam (ndryshe quhet edhe umeti që e ka pranuar Islamin), po përjeton sprovën e zbatimit të Islamit. Çdo njeri apo shoqëri (ndryshe quhet umeti që duhet të ftohet në Islam), potencialisht gjendet brenda mundësisë për t'u njohur me Islamin. Edhe nëse një njeri ka rënë në pikën zero, përsëri ka shpresë që të hyjë në rrugë të Allahut Teala.

Andaj duhet të përpiqemi sikur po ecim në gjurmët e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili e nisi rrugën me thirrjen: "Çohu dhe paralajmëro!", në mënyrë që këtë shpresë ta shndërronte në proces të ndërtimit. Për këtë arsye, ne duhet ta ndjejmë këtë shqetësim dhe duhet ta përvetësojmë atë pjekuri shpirtërore.

A është e mundur të arrihet kjo? Përse të mos jetë e mundur?

Ndjenjat dhe mendimet që i kam ndarë me ju më poshtë, shprehin edhe shqetësimin, edhe shpresën që Revista Etika i mbart nga zemrat në zemra përgjatë gjithë këtyre viteve. Është e vërtetë se vitet kalojnë, por ja që ka edhe një kalendar hyjnor për realizimin e këtyre gjërave. Ne nuk kemi të drejtë të themi se këto punë është e pamundur të bëhen. Andaj gjithmonë duhet të themi: "Do të bëhen inshallah. Umeti do ta marrë veten përsëri inshallah."

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.



Në vepra nuk kërkohet shumica, por mirësia
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

16

Përmbajtja



9

Kudsi, si amanet
Doç. dr. Adem Ergyl




34

Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash




16

20



Besimi ka kushte
Nuredin Jëlldëz

- 5 **Dhimbja dhe shpresa**
Ahmet Tashgetiren
- 12 **Të ndjesh dhimbjen e tjetrit**
Ali Riza Temel
- 14 **Namazi dhe Kurani**
Xhafer Durmush
- 20 **Nuk ka vend për panik**
Idris Arpat
- 22 **Edukimi i vullnetit sipas Sunetit**
Shemsedin Kërësh
- 24 **Allahu i do të devotshmit**
As. doç. dr. Mustafa Karabaxhak
- 27 **Misteri në të fshehtat e kohës**
Ali Byjykçapar
- 28 **Modestia dhe mendjemadhësia**
Sami Gëksyn
- 30 **Mirënjohja ndaj mirësive**
B. Xhahit Ezedmir



48

Një Ajet - Një Hadith 32

Foshnja që frikësohej nga lindja 41
Ferudun Ozdemir

El-Hasib 42
Ilir Hoxha

Mbi drejtësinë, lirinë dhe paqen 47
Edison Çeraj

Profeti ynë, shembull 48
Ferit Piku

Qetësia që vjen nga përkujtimi i Allahut 52
Nurten Selma Çevikollu



44

Begatia që vjen prej kursimit
As. dr. Mustafa Xhanllë

Aventura martesore
Esin Akdeniz Tuxhar

55





Dhimbja dhe shpresa

— Ahmet Tashgetiren —

Të gjitha vendet e umetit po përpëliten prej vuajtjeve. Kjo është e vërtetë. Nganjëherë ndjejmë dhimbje në Bosnje, nganjëherë në Arakan... Gjithmonë ndjejmë dhimbje në Turkistanin Lindor, në Palestinë, dhe në Çeçeni... Kudsi është plaga e zemrës sonë që s'po di të shërohet. Por gjithmonë ka shpresë.

Gjithmonë ka shpresë, sepse njeriu nuk mund të jetojë pa Islamin. Në një botë ku nuk ka myslimanë, është vetëm bota e kiametit. Andaj, nëse do të ekzistojë kjo botë, do të ekzistojë edhe Islami, edhe myslimanët...

Islami erdhi në një epokë kur njerëzit kishin degraduar. Islami e kapi njeriun për dore dhe i hyri përpjekjes për ta ndërtuar përsëri “pjekurinë njerëzore” që Krijuesi e emërton “eshrefi mahlukat / krijesa më fisnike”. Ky mision ishte misioni i Muhamedit, (a.s.).

Njerëzimi në atë periudhë kishte marrë fund me plot kuptimin e fjalës. Të mos harrojmë se bëhet fjalë për një periudhë kur vajzat varroseshin në tokë të gjalla. Pra, po flasim për një periudhë të cilën Mehmet Akif Ersoji e ka përshkruar: “Njerëzit

i kishin kaluar hienat në agresivitet. Nëse një njeri nuk kishte dhëmbë, atë e hanin vëllezërit e tij.”

Muhamedi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ua mori zemrat atyre njerëzve, i mbrujti përsëri dhe prej atyre njerëzve u formua “umeti fisnik”. Ky ishte ndërtimi nga zeroja i njeriut dhe shoqërisë. Edhe iniciativa për këtë ndërtim ka lidhje me të vërtetën se njeriu nuk mund të jetojë pa Islamin, sepse Krijuesi kështu e ka krijuar njeriun. Mungesa e Islamit është procesi i kalbjes së njeriut. Për këtë arsye, Islami është i domosdoshëm për të gjithë ata që kanë ardhur si njerëz në këtë botë.

Në këtë pikë edhe umeti Islam (ndryshe quhet edhe umeti që e ka pranuar Islamin), po përjeton sprovën e zbatimit të Islamit. Çdo njeri apo shoqëri (ndryshe quhet umeti që duhet të ftohet në Islam), potencialisht gjendet brenda mundësisë për t'u njohur me Islamin. Edhe nëse një njeri ka rënë në pikën zero, përsëri ka shpresë që të hyjë në rrugë të Allahut Teala.

Andaj duhet të përpiqemi sikur po ecim në gjurmët e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili e nisi

rrugën me thirrjen: “Çohu dhe paralajmëro!”, në mënyrë që këtë shpresë ta shndërronte në proces të ndërtimit. Për këtë arsye, ne duhet ta ndjejmë këtë shqetësim dhe duhet ta përvetësojmë atë pjekuri shpirtërore.

A është e mundur të arrihet kjo? Përse të mos jetë e mundur?

Ndjenjat dhe mendimet që i kam ndarë me ju më poshtë, shprehin edhe shqetësimin, edhe shpresën që Revista Etika i mbart nga zemrat në zemra përgjatë gjithë këtyre viteve. Është e vërtetë se vitet kalojnë, por ja që ka edhe një kalendar hyjnor për realizimin e këtyre gjërave. Ne nuk kemi të drejtë të themi se këto punë është e pamundur të bëhen. Andaj gjithmonë duhet të themi: “Do të bëhen inshallah. Umeti do ta marrë veten përsëri inshallah.”

Tashmë ejani dhe t’i ndajmë së bashku shqetësimet dhe shpresat:

“Ju bie shteti!”

Nëse do të ishte e mundur ta lexonim vetëm ajetin e mëposhtëm, të mendonim rreth tij, ta ndërtonim botën e ndjenjave dhe mendimeve tona sipas tij dhe t’i caktonim gjendjet e veprimet tona si umet sipas tij, do të kishim mundësi t’i prishnim të gjitha ato “strategjitë shkatërruese”. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia (do të humbni shtetin). Bëhuni të durueshëm, sepse Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit.” (Enfal, 46)

Në qendër të bindjes do të vendoset Allahu dhe i Dërguari i Tij. Bindja ndaj të gjitha fuqive të tjera (duke përfshirë këtu edhe udhëheqësit që Kurani i cilëson si ulu’l-emr), duhet të bëhet në raport me bindjen që ata e shfaqin ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Kur të ketë kontradikta në këtë çështje, atëherë problemi duhet të zgjidhet sipas rregullave për të cilat na ka njoftuar Allahu dhe i Dërguari. (Shik. Nisa, 59) Menjëherë pas bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij vjen thirrja hyjnore për të mos u grindur ndërmjet nesh, për të mos u përçarë dhe për të mos u ndarë. Veçanërisht për të mos u ndarë në aspektin shpirtëror edhe pse ndarja në aspektin e shërbimeve mund të jetë e pashmangshme. Allahu Teala po u thotë atyre që dëgjojnë: “Mos u ndani pjesë-pjesë!” Pas kësaj menjëherë paralajmërohem për rrezikun shpirtëror, mental dhe psikologjik që sjell përçarja. “Pastaj kaplohem nga frika, biem në dobësi shpirtërore dhe vullneti na thyhet.” Menjëherë pas kësaj gjendje tragjike, shndërrohem edhe si njerëz, edhe si shoqëri që paguajnë çmim

të madh. Në Kuranin Fisnik përdoret fjala “Rih”. Kuptimi leksikor i kësaj fjale është “erë”. Erë do të thotë krijesë që ka fuqi ndikuese. Komentuesit e Kuranit e kanë kuptuar këtë në formën: “Do të humbisni fuqinë dhe shtetin tuaj.” Po, ja panorama e qartë e ndodhive në botën islame!

Ky ajet fisnik na njofton se fuqia e bashkuar e besimtarëve është edhe forcë dhe erë për ta. Ndërsa, nëse ata përçahen, atëherë kjo fuqi shndërrohet në një forcë që nuk i ushqen, por që i dobëson ata. Madje, çmimi që mund të paguhet për këtë humbje mund të arrijë deri në “humbjen e shtetit”. Nëse humbjen e shtetit këtu e komentojmë duke parë gjendjen konkrete të botës islame, do ta shohim qartë se shtetet që formojnë shoqëritë islame janë shtete boshe dhe se i kanë humbur cilësitë për të qenë shtete.

Nëse do të kapemi fort për litarit (Kuranit) të Allahut...

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.” (Al Imran, 103)

Kush mund ta shkaktojë këtë përçarje nëse të gjithë së bashku jemi kapur fort pas litarit të Allahut Teala? Si jemi përçarë nëse Allahu (xh.xh.), i ka bashkuar zemrat tona? Çfarë do të thotë që shoqëritë myslimanë i bëjnë gropën njëra-tjetrës nëse Allahu i lartësuar na ka shpëtuar nga buza e greminës së zjarrit? Çfarë roli kemi në hapjen e kësaj grope? Si do ta japim llogarinë për këtë në audiencën e Allahut?

* * *

KUFIJTË PËRGJATË LUFTËS

“O besimtarë! Kur të shkonit në luftë, në rrugë të Allahut, shqyrtoni gjithçka me kujdes! Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: “Nuk je besimtar”, me qëllim që të fitoni kënaqësi të kësaj jete, ndërkohë që tek Allahu ka fitime të shumta. Të tillë keni qenë edhe ju më parë e Allahu ju dha mirësi; prandaj gjithmonë sqarojini mirë të gjitha punët! Se Allahu është Njohës i veprave tuaja.” (Nisa, 94)

Në këtë ajet kuranor Allahu Teala sikur na jep një kornizë e cila na e mundëson që t’i analizojmë të gjitha dobësitë e njeriut. Pra, ky ajet na urdhëron që ta dëgjojmë dhe kuptojmë mirë edhe arsyetimin

e njerëzve me të cilët luftojmë. Ne duhet ta lexojmë një mijë herë pjesën e ajetit në të cilën thuhet: "... Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: "Nuk je besimtar", me qëllim që të fitoni kënaqësi të kësaj jete..." Pastaj duhet të mendohemi një mijë herë për ta vlerësuar situatën tonë dhe për ta parë se si i kemi marrëdhëniet me njerëzit, shoqëritë, medhhebet e ndryshme, xhematet, tarikatat apo me grupet e besimeve të ndryshme. A i kemi këto lidhje vetëm për interesin e kësaj bote? Çdo veprim që shfaqim duhet ta kalojmë në filtrat e këtij ajeti fisnik. Me këtë ajet kuranor Zoti (xh.xh.), kërkon që ta hetojmë njetin tonë. Siç thotë edhe i Dërguari i Allahut (a.s.): Për kë e kemi bërë hixhretin? Për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, apo për hir të ndonjë gruaje me të cilën dëshirojmë të martohemi? Përse ia kemi drejtuar shpatën atij që kemi përballë? Mos vallë e kemi bërë këtë, në mënyrë që të marrim pjesë sa më të madhe nga plaçka e luftës? Apo e kemi bërë ngaqë nuk duam ortakë me të cilët ta ndajmë pasurinë, pronën dhe pushtetin? A nuk i keni sjellë në mendje ato që mund të dalin në pah para Allahut Teala te i Cili do të merren në llogari edhe qëllimet? Nëse njerëzve nuk ua kemi hapur zemrat dhe nuk ua kemi parë, atëherë si ka mundësi që ua kemi drejtuar shpatën për t'i varë?

* * *

NËSE E KEMI HUMBUR SHTETIN...

Të zbatuarit e Islamit në kuptimin e vërtetë në ditët e sotme është i mundur vetëm me "perceptimin e vëllazërisë". Nëse nuk arrijmë ta bëjmë këtë, atëherë shtetin e humbim, fuqinë e humbim, bëhemi të pandikueshëm, plogështohemi dhe mbetemi të mallëngjyer për një atmosferë që mund të na qetësojë. Çdo popull që e humbet shtetin, bie në poshtërim. Për këtë arsye, gjyshërit tanë nuk kanë thënë kot: "Ose shteti në krye, ose të vdesim të gjithë."

Strukturat që e kanë brendësinë e tyre të boshatisur dhe që zemrat e administruesve të tyre hyjnë nën ndikimin e erërave të të tjerëve, nuk është e drejtë t'i konsiderojmë si shtet.

* * *

UMETI: TAKIMI I MADH I NJERËZIMIT

Umet do të thotë shoqëri njerëzish që e kapin për dore të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Pra, do të thotë shoqëri njerëzish që lyhen me bojën dhe përvetësojnë moralin e Pejgamberit.

Popujt, ngjyrat dhe gjuhët e ndryshme mblidhen nën kubënë universale të "umetit të Islamit". Vija e

Ne duhet të lutemi patjetër. Lutje do të thotë që të strehohemi te mirësia, ndihma dhe mëshira e Allahut Teala. Pa lutje nuk bën. Ne si umet kemi nevojë të pafundme për mëshirën, mirësinë dhe ndihmën e të Plotmëshirshmit. Edhe nëse nuk kemi asnjë hall, prapë se prapë ne marrim e japim frymë me mirësinë e Atij. Për këtë arsye, zemrat tona duhet të jenë të lidhura me pragun e Atij.

umetit do të thotë vijë universale Islamo-humanitare. Umeti Islam në çdo kohë tregon takimin e madh njerëzor.

Për shembull, atmosfera e Arafatit në haxh në këtë kontekst absolutisht është takim i umetit. Aty gjenden me qindra ngjyra, raca dhe gjuhë që janë takuar në audiencën e Krijuesit. Arafati pothuajse është përfaqësuesi i miniaturës së njerëzve të umetit të madh në këtë botë që janë zhveshur nga cilësitë negative, që veprojnë me ndjenjën e nënshtrimit ndaj Zotit, që i kanë lidhur zemrat me njëri-tjetrin, që sillen me mëshirë kundrejt njëri-tjetrit, që janë prijës në të mirë dhe që e ndalojnë të keqen...

PYETJA E DITËS

Vallë sa përputhet umeti Islam në këtë kohë me "Umetin e Nderuar" që e përkufizojnë fjalët hyjnore dhe që e ka thurur i Dërguari i Allahut (a.s.), me duart e tij të bekuara? Shihet qartë që ka vuajtje. Shihet qartë që ka padrejtësi. Shihet qartë që ka njerëz të privuar nga të drejtat e tyre.

Arif Nihati thotë në poezinë e tij me titull "Azia": "Ebu Xhehli po shëtit nëpër kontinente." Ndërkohe umeti Islam i pati dhënë fund Ebu Xhehilit në Epokën e Lumturisë... Nga erdhi përsëri tani ky Ebu Xhehli? Çfarë i ka ndodhur umetit Islam që ka ardhur Ebu Xhehli?

Nëse vëmë re flamuj të huaj, trazira, padrejtësi dhe pushtime në vendet islame, domethënë se diçka i ka ndodhur dhe po i ndodh "krenarisë" sonë. Liria është kushti absolut i Islamit dhe myslimanit. Nëse myslimanët po përjetojnë problemin e lirisë vende-vende, do të thotë se ne si umet e kemi një problem.

NËSE UMETI DO TË ISHTE UMET...

Nëse umeti do të ishte umet, Gaza nuk do të ishte Gaza. Nëse umeti do të ishte umet, një fëmijë mysliman nuk do të vdiste nga uria në Somali. Nga ana tjetër, nuk do të kishte asnjë mbret që do ta kishte fronin prej floriri. Nëse umeti do të ishte umet, bota islame nuk do të përpëlitej në vuajtje të tilla. Prandaj umeti duhet të jetë umet. Umeti duhet të ndjekë të Dërguarin e Allahut (a.s.). Umeti duhet të zbatojë Kuranin Fisnik. Në këtë mënyrë, duhet të gjejë krenarinë. Umeti duhet të arrijë një pjekuri të tillë që ta përfaqësojë Islamit në personalitetin e vet. Për ta arritur këtë duhet të fillojmë procesin e ndërtimit të njerëzve, të vendeve dhe të shteteve një nga një. Kjo është sprovë jonë.

Të qenët umet do të thotë që brendësinë e myslimanizmit tonë ta thurim me rregullat e personalitetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). A është e mundur të heqim dorë prej kësaj, ta anashkalojmë këtë dhe të pohojmë se jemi “umeti i Muhamedit” me këtë gjendje?

Vuajtjet që po përjetohej në të gjithë umetin po lindin nga largësia ndërmjet nesh dhe Resulullahut (a.s.). Për këtë arsye, edhe shpëtimi do të jetë te afrimi me atë. Domethënë, shpëtimi do të jetë në të qenët umet i vërtetë...

LUTJET TONA DUHET TË JENË REALE

Ne duhet të lutemi patjetër. Lutje do të thotë që të strehohemi te mirësia, ndihma dhe mëshira e Allahut Teala. Pa lutje nuk bën. Ne si umet kemi nevojë të pafundme për mëshirën, mirësinë dhe ndihmën e të Plotmëshirshmit. Edhe nëse nuk kemi asnjë hall, prapë se prapë ne marrim e japim frymë me mirësinë e Atij. Për këtë arsye, zemrat tona duhet të jenë të lidhura me pragun e Atij. Por nëse po përjetojmë dhimbje si umet, atëherë jemi të detyruar të trokasim edhe më shumë në derën e bujarisë së Atij. Ndoshta së pari duhet t'i përveshim krahët për të bërë lutje reale. Lutje reale do të thotë përpjekje për ta rindërtuar veten. Rindërtim njeri pas njeriu, vend pas vendi dhe shtet pas shteti. Kështu duhet të bëjmë listën e atyre që i kemi humbur, në mënyrë që të përpiqemi t'i fitojmë përsëri një nga një.

Nëse na kanë humbur sytë, duhet të përpiqemi t'i gjejmë. Nëse na ka humbur vetëdija, duhet të përpiqemi ta gjejmë. Nëse na ka humbur zemra, duhet të përpiqemi ta gjejmë dhe ta përmirësojmë. Nëse na ka humbur toka, duhet të përpiqemi ta rifitojmë. Nëse na ka humbur shteti, duhet të përpiqemi ta riformojmë. Të gjitha këto duhet t'i bëjmë me një pjekuri dhe përkushtim siç kërkon Krijuesi i madhëruar.

T'i ndërtojmë përsëri xhamitë, minberet, mihra-bet, namazet, agjërimet, haxhet, zekatet, sexhdet, rukutë, imamët, myezinët, nënat, baballarët, të rinjtë, të moshuarit... Të edukojmë përsëri njerëz si Ebu Bekri, Omeri, Osmani, Aliu, Muadhi, Ammari, Fatimeja, Hatixheja, Aishja, Nesibja...

Pasi ta bëjmë lutjen reale, zemrat duhet t'ia drejtojmë Allahut të Lartësuar. Zemrat tona duhet të shprehin me gjithë fuqinë e tyre atë që ndjejnë. Ato duhet të bërtasin me të madhe siç bërtet nga dhimbja nëna që është e detyruar ta lërë fëmijën e saj në rrugë në Somali. Zemrat tona duhet ta shprehin me të madhe atë që ndjejnë siç bërtiti me të madhe nga dhimbja nëna që i çanë barkun në Bosnje. Zemrat tona duhet të klithin siç klithin shtëpitë e shkatërruara me topa në Gaza, apo siç klithin civilët që qëllohen në Afganistan, apo si klithmat e grupeve të njerëzve që ekzekutohen nga udhëheqësit e tyre në Siri, Libi dhe Egjipt...

Për shkak të situatës së mjeruar në të cilën gjendet bota islame, edhe Palestina është në gjendje të mjeruar...

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, ka thënë: “*Si të jeni, ashtu do të udhëhiqeni.*”, apo jo? Po, siç jemi ashtu edhe po udhëhiqemi.

Atëherë çfarë pamjeje po shfaqin 1.7 miliard myslimanë që plaga e Palestinës, vuajtja e Eritreas dhe drama e Afganistanit nuk po marrin fund?

A është shumë i rëndësishëm për plagët e Palestinës dhe për plagët tjera të ngjashme fakti që Islami është apo jo deciziv? Po, është shumë i rëndësishëm, sepse myslimanët e ditëve të sotme janë myslimanë të copëtuar. Ata janë myslimanë që e kanë humbur tërësinë e umetit. Madje kanë humbur edhe tërësinë e xhematit. T'i zgjasësh dorën një myslimani jo në ndonjë vend të largët të botës, por aty afër në Palestinë, të preokupohesh me dhimbjen e myslimanit që gjendet krejt pranë tashmë totalisht është bërë çështje individuale. Por ja që Islami nuk mendon ashtu. Në ajetin e 39-të të sures Shura thuhet: “Ata besimtarët bëjnë qëndresë dhe marrin hak duke u solidarizuar me njëri-tjetrin kur i godet ndonjë padrejtësi në marrjen e të drejtave dhe në mbrojtjen e vendit të tyre.” Domethënë se Islami e ka bërë përgjegjës myslimanin kundrejt myslimanit tjetër. Por si do të kryhet kjo përgjegjësi? Sa vetë mund të largohen nga obligimet e jetës kur Islami na thërrret? Palestina, Afganistani, Eritrea, Azerbajxhani, Turkistani etj. janë vende ku myslimanët gjenden në masa të gjera. Sa na interesojnë neve shqetësimet e myslimanëve për ta vënë Islamit në zbatim? Apo çfarë kemi bërë në planin individual edhe nëse interesohemi shumë? Domethënë se shkatërrimi i diçizivitetit të Islamit e zhduk që në themel fuqinë e umetit.

KUJDSI SI AMANET


— Doç. dr. Adem Ergyl —

Besimtari është njeri besnik, domethënë është një njeri që posedon personalitetin dhe virtytin që e bëjnë të besueshëm. Ndërmjet amanetit, besueshmërisë dhe besimit ka një lidhje tepër të fortë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Ai njeri që nuk e mban amanetin, domethënë, njeriu që nuk është i besueshëm, nuk ka edhe besim.”*¹ Madje, një njeri që nuk është i besueshëm, edhe pse nga jashtë mund të duket si mysliman, në të vërtetë në vetvete mbar një pjesë të hipokrizisë.²

Allahu Teala tokën ua ka lënë amanet jo shkatë-

rrimtarëve dhe atyre që derdhin gjak, por besimtarëve, njësuësve, myslimanëve dhe të mirëve, apo thënë me një shprehje tjetër, robërve të devotshëm që mbartin cilësinë për të qenë zëvendësit e Tij.³ Domethënë, udhëheqja duhet të jetë në duart e robërve të tillë. Veçanërisht në ndërtimin, rregullimin dhe pastrimin e xhamive, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në kryerjen e adhurimit, Zoti (xh.xh.), dëshiron që të marrin rol robërit e tij të zgjedhur. Këta robër para së gjithash duhet të jenë besimtarë dhe njësuës të Zotit. Pastaj ata duhet të

XHAMIA AKSA SI NJËRA PREJ TRI XHAMIVE MË TË MËDHA, SIÇ KA QENË DJE EDHE SOT ËSHTË NJË AMANET I ALLAHUT PËR BESIMTARËT MONOTEISTË, SEPSE UMETI I MUHAMEDIT SOT ËSHTË I VETMI UMET QË I POSEDON KËTO CILËSI. TRASHËGIMTARËT E VËRTETË TË IBRAHIMIT (A.S.), I CILI KA HEDHUR THEMELET E KËSAJ XHAMIE, TASHMË JANË VETËM MYSLIMANËT.



jenë të dëlirë në aspektin e besimit, veprave dhe sjelljeve. Allahu i Lartësuar ka këtë mesazh në lidhje me këtë çështje:

“Nuk u takon idhujtarëve të përkujdesen për faltoret e Allahut, përderisa edhe ata vetë dëshmojnë se janë mosbesimtarë. Të kota do të jenë veprat e tyre dhe në zjarrin e Xhehenemit do të qëndrojnë përgjithmonë. Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.” (Teube, 17-18)

Në ndërtimin e Qabesë, e cila është faltorja e parë



Kudsi dhe mjedisi përreth ku gjendet Mesxhidu'l-Aksa, siç shprehet edhe Kurani Fisnik, është një vend i “Shenjtë” dhe i “Bekuar”. Siç i është dhënë Qabesë së Shenjtë emri “Harem” që do të thotë se mjedisi i saj duhet të respektohet dhe aty nuk duhet të shfaqen disa gjendje e veprime të ndryshme, në të njëjtën mënyrë edhe Kudsit Fisnik i është thënë “Kuds” që do të thotë “vend i cili duhet të mbahet pastër nga çdo lloj ndyrësie, mëkati dhe papastërtie duke filluar që nga shirku dhe mohimi”.

në sipërfaqen e tokës, së pari kanë marrë detyrë peygamberët të cilët kanë qenë robër të zgjedhur. Kurani Fisnik na tregon se Ibrahim i dhe Ismaili, alihejima's-selam, e kanë kryer detyrën e rindërtimit të Qabesë së Bekuar mbi themelet e saj të vjetra.⁴ Prej deklaratave të të Dërguarit të Allahut (a.s.), kuptojmë se edhe themelet e Mesxhidu'l-Aksa që gjendet në Kuds janë hedhur nga Ibrahim i (a.s.). Ndërsa Davudi dhe Sulejmani, alejhima's-selam, kanë vazhduar ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kësaj xhamie.

Xhamia Aksa si njëra prej tri xhamive më të mëdha, siç ka qenë dje edhe sot është një amanet i Allahut për besimtarët monoteistë, sepse umeti i

Muhamedit sot është i vetmi umet që i posedon këto cilësi. Trashëgimtarët e vërtetë të Ibrahimit (a.s.), i cili ka hedhur themelet e kësaj xhamie, tashmë janë vetëm myslimanët. Zoti (xh.xh.), sikundër hebrenjtë dhe të krishterët që pohojnë se e besojnë Ibrahimin (a.s.), thotë në Kuranin Fisnik se të krishterët dhe hebrenjtë e kanë humbur këtë meritë dhe se trashëgimtarët e vërtetë të tij janë vetëm pasuesit e Muhamedit (a.s.):

“Ibrahimi nuk ka qenë as hebre, as i krishterë, por ka qenë besimtar i vërtetë (monoteist) i përulur ndaj Allahut dhe nuk ka qenë nga politeistët. Pa dyshim, njerëzit më të afërt me Ibrahimin janë ata që e pasuan atë dhe ky Profet me besimtarët (e tij). Allahu është mbrojtës i besimtarëve.” (Al Imran, 67-68)

Kudsi dhe mjedisi përreth ku gjendet Mesxhidu'l-Aksa, siç shprehet edhe Kurani Fisnik, është një vend i “Shenjtë” dhe i “Bekuar”.⁵ Siç i është dhënë Qabesë së Shenjtë emri “Harem” që do të thotë se mjedisi i saj duhet të respektohet dhe aty nuk duhet të shfaqen disa gjendje e veprime të ndryshme, në të njëjtën mënyrë edhe Kudsit Fisnik i është thënë “Kuds” që do të thotë “vend i cili duhet të mbahet pastër nga çdo lloj ndyrësie, mëkati dhe papastërtie duke filluar që nga shirku dhe mohimi”. Kuptimi leksikor i fjalës Kuds është: “I pastër nga çdo lloj gabimi, mangësie dhe papastërtie.” Kudsi dhe mjedisi që e rrethon është bërë “mubarek/i shenjtë” për shkak se aty janë shfaqur shumë begati shpirtërore. Ai është një vend që ka pritur shumë peygamberë. Pra, ai është një vend i shenjtë në të cilin ka zbritur shpallja hyjnore.

Ndërsa një kujtim tjetër i shenjtë që Kudsi dhe Mesxhidu'l-Aksa kanë për umetin e Muhamedit është e vërteta se në këtë vend i Dërguari i Allahut (a.s.), ka bërë njërën prej ndalesave të rëndësishme përgjatë natës së Israsë dhe Miraxhit. Ai ishte stacioni i fundit i udhëtimit të natës pas Mekës dhe Medines i cili quhet Isra dhe pika e fillimit të udhëtimit të Miraxhit për në shtatë qiejt e më tutje. Natën e Miraxhit peygamberi ynë i nderuar është bërë imam për shpirtat e të gjithë peygamberëve. Kjo ishte një shenjë e qartë se prijësia në udhëheqjen e tokës tashmë i ishte dhënë atij si peygamber i kohës së fundit. Kjo shenjë e ka ngarkuar edhe umetin e tij me përgjegjësinë për ta vazhduar këtë prijësi.

Të gjitha këto të vërteta tregojnë se Kudsi Sherif është një amanet i Zotit (xh.xh.), për këtë umet. Çdo lloj amaneti sigurisht që meriton të mbrohet. Kjo është një përgjegjësi e madhe për atë që e ka

marrë përsipër amanetin. Mendoni për këtë amanet që poseduesi i tij është Allahu Teala, pejgamberët dhe Profeti i kohës së fundit, Muhamed Mustafaja (a.s.). Atëherë, si duhet të mbrohet një amanet i shenjtë? Ja pra, për të menduar madje për të menduar thellë pikërisht mbi këtë temë dhe pastaj për të bërë atë që është e nevojshme, duhet t'i përdorim të gjitha mundësitë.

Emri i vendosjes së një gjëje në vendin që nuk e meriton është padrejtësi. Në ditët e sotme Xhamia Aksa po përjeton një padrejtësi të madhe, sepse duart madje edhe këmbët e ndyra të zullumqarëve gjenden mbi të. Allahu i Lartësuar thotë:

“Kush është më fajtor se ai që pengon të përmendet nëpër xhamitë e Allahut Emri i Tij dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre?! Ata nuk duhet të hyjnë në to, përveçse të frikësuar. Për ata, në këtë jetë ka poshtërim, kurse në jetën tjetër dënim të madh.” (Bakara, 114)

Të shpëtuarit e Xhamisë Aksa, e cila ishte kibra jonë e parë si një dritare që hapet drejt horizonteve të tjera, nga duart e zullumqarëve, është prej farzeve më të rëndësishme për umetin në ditët e sotme. Përderisa ky farz të mos kryhet, i gjithë umeti është përgjegjës në plan individual, në plan xhematesh dhe në plan shtetesh. Të gjithë sipas mundësisë janë të obliguar të bëjnë diçka në lidhje me këtë çështje. Ne jemi të obliguar të zëmë vendin tonë në rreshtat e luftës për këtë kauzë me duart, gjuhët dhe zemrat tona. Andaj, veten duhet ta shohim si një kokërr orizi që e plotëson peshën. Pra, duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të themi: “Nëse kjo punë nuk bëhet vetëm me mua, atëherë nuk mund të bëhet edhe pa mua.” Kështu që duhet të posedojmë një qëndrim aktiv dhe të gjallë.

Çfarë mund të bëhet në lidhje me këtë çështje?

- Ta mbajmë të gjallë vetëdijen në lidhje me Kuds-in si në vetët tona, ashtu edhe te njerëzit që na rrethojnë.

- Duhet të synojmë që si individë të bëhemi besimtarë të fortë dhe si popull të arrijmë një fuqi me të cilën do t'i mposhtim armiqtë.

- T'i përdorim në këtë rrugë vlerat dhe mundësitë si pasuria, dija, etj. sipas fuqisë që të kemi.

- T'u japim rëndësi vizitave të Kudsi Sherifit.

- T'u japim mbështetje materialo-shpirtërore atyre që bëjnë rezistencë në lidhje me këtë çështje.

- Të bëjmë sa më shumë lutje, në mënyrë që të jemi aktivë dhe të përpiqemi për të fituar ndihmën e mëshirën hyjnore.

Së fundi, nëse themi: “Të mos e prekë dora e huaj faltoren tonë.”, atëherë duhet ta dimë se kjo gjendje do ta ketë një çmim. Ky amanet i shenjtë i Zotit (xh. xh.), nuk duhet të gjendet nën çizmet e tiranëve, por duhet të gjendet mbi kokat e besimtarëve. Nëse si umet dëshirojmë të përjetojmë miraxhe të reja, hapi për shpëtimin e Kudsit do të jetë një pikë e rëndësishme për këtë iniciativë.

Me myftiun e Kudsit, Sheh Sadedin Ilmiun...

NGJARJA MË E DHIMBSHME PËR UMETIN ISLAM

Fatih Emin: Kur thuhet Kuds, gjëja e parë që na vjen në mendje është Mesxhidu'l-Aksa. Çfarë ndjenjash ju zgjon në botën tuaj shpirtërore të qenët myfti i një vendi në të cilin gjendet Xhamia Aksa?

Sadedin Ilmiu: Padyshim se të marrësh përsipër përgjegjësitë e myslimanëve në një vend që Allahu e ka bekuar, është një detyrë fisnike, por në të njëjtën kohë edhe me shumë përgjegjësi. Krahas moshës sime të thyer, shpresa dhe mendimi im i vetëm është që Kudsi dhe si rezultat Xhamia Aksa të hyjnë nën udhëheqjen islame.

Fatih Emin: Cila është ngjarja që ka ndikuar te ju më së shumti përgjatë gjithë jetës?

Sadedin Ilmi: Data 21 Gusht 1996 është një ditë që nuk mund të harrohet jo vetëm nga unë, por edhe nga umeti. Kjo është data kur Mesxhidu'l-Aksa është djegur nga hebrenjtë. Kjo është një ditë që kaloi në histori si tabloja e njollosjes së fytyrës dhe poshtërimit të besimtarëve, robërve të nderuar të Allahut, ngaqë u larguan nga rruga e Allahut. Largimin nga rruga e Allahut së pari e bënë kuadrot udhëheqës.

Pothuajse shtatëdhjetë vjet prej jetës sime kanë kaluar në vuajtje, probleme dhe vështirësi si një besimtar. Që në fillimet e viteve të rinisë, Perandoria Osmane u shkatërrua nga armiqtë e Allahut. Pas rënies së Perandorisë Osmane, i gjithë umeti hyri në një atmosferë ku vazhdimisht përjetohehin tablo të dhimbshme. Por siç e thashë edhe më parë, asnjë ngjarje nuk ka ndikuar te unë siç ka ndikuar djegia e Xhamisë Aksa prej hebrenjve. Kjo ndoshta ngaqë kam jetuar aty. E gjithë mërzia ime padyshim shkaktohej ngaqë nuk kisha mundësi të bëja ndonjë gjë kundër hebrenjve.

■ **REFERENCAT:** 1) Ahmed ibn Hanbel, Musned, III, 135, hadithi nr: 13225; Ibn Hibban, Sahih, hadithi nr: 194. 2) Buhari, Iman, 24; Muslim, Iman, 107-108. 3) Surja Bakara, 30. 4) Surja Bakara, 127. 5) Shik. Surja Maide, 21; Surja Taha, 21; Surja Naziat, 16; Surja A'raf, 137; Surja Isra, 1.



TË NDJESH DHIMBJEN E TJETRIT

— Ali Riza Temel —

Shkrimtari i famshëm, Tolstoi e ka përkufizuar në këtë mënyrë njeriun e vërtetë: “Nëse një njeri ndjen dhimbje, ai është i gjallë. Nëse mund ta kuptojë dhimbjen e të tjerëve, ai është njeri.” Edhe sulltani i poetëve, Nexhip Fazëlli thotë: “Te unë gjendet edhe dhimbja e atyre që nuk janë të vetëdijshëm për të.” Në këtë mënyrë shprehte njeriun e përsosur që mund të ndjejë edhe dhimbjet e atyre që nuk janë të vetëdijshëm se kanë dhimbje.

Të formuarit si njeri fillon me kalimin nga nefsi emmare te nefsi levvame. Një njeri që e ndjen veten keq ngaqë ka bërë ndonjë gabim apo ngaqë i ka shkaktuar ndonjë dëm dikujt, do të thotë se ka hedhur hapin drejt njerëzimit. Kur një qen e kafshon një njeri, nuk e ndjen se i ka shkaktuar dhimbje atij. Nëse një ka e vret me brirë një njeri, edhe ai nuk pikëllohet për shkak se i ka shkaktuar dhimbje atij. Ata që e ndjejnë dhimbjen e të tjerëve, nuk u shkaktajnë dhimbje atyre, sepse të njëjtën dhimbje e ndjejnë ndoshta edhe më shumë në ndërgjegjen e tyre. Ata që nuk ndiejnë keqardhje nga vuajtjet që u shkaktajnë të tjerëve dhe ata që nuk e ndiejnë dhimbjen e të tjerëve nuk kanë ndonjë ndryshim nga qeni dhe kau. Mbi të gjitha, kafshët nuk janë përgjegjëse për ato që bëjnë. Ndërsa për njerëzit e tillë Allahu Teala shprehet: “...**Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi...**” (A’raf, 179) Pra, kjo shprehje e Kuranit Fisnik është për njerëzit e tillë.

Mëshirë do të thotë që të bashkohesh e të bëhesh një me krijesat e tjera, t’i mbartësh në zemër vuajtjet e problemet e tyre dhe të jetosh së bashku me ato. Ata që nuk e ndiejnë këtë bashkim janë egoistë, të vetmuar dhe të pandjeshëm. Ata gjenden jashtë familjes njerëzore.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, e ka shprehur në këtë mënyrë se si duhet t’i ndajmë gëzimet e hidhërimet me të tjerët dhe se si duhet të jetë njeriu, në veçanti njeriu musliman, në lidhje me çështjet e bashkimit me të tjerët: “*Besimtarët në dashurinë, mëshirën dhe butësinë ndaj njëri-tjetrit i ngjajnë një trupi që kur një organ i tij ndjen ndonjë shqetësim, edhe organet e tjera ndajnë dhimbjen e pagjumësisë e të temperaturës me të.*” (Buhari, Edeb, 27.) Syri e shoqëron dhimbjen e përjetuar duke derdhur lot. Mëshira është majaja e njerëzimit. Ata që janë të privuar nga kjo maja, nuk mund ta arrijnë pjekurinë njerëzore. Edhe pse janë njerëz në pamje, në të vërtetë nuk janë të tillë. Të jesh njeri do të thotë të bashkohesh me familjen e njerëzimit. I Dërguari i Allahut (a.s.), i cili ishte dërguar si mëshirë për botët, ka thënë: “*Nuk do të besoni përderisa të mos doni për vëllain besimtar atë që doni për vete.*” (Tirmidhi, Hadithi nr: 2515.)

Ata që e kanë përfaqësuar më së miri shpirtin e

ndarjes së halleve me të tjerët janë ensarët që i ndihmuan muhaxhirët për çdo gjë. Allahu i Lartësuar thotë në lidhje me ata: ***“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi për atë që u është dhënë atyre. Ata duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtare. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.”*** (Hashr, 9)

Ata që ia dhanë ushqimin mysafirit dhe fjetën vetë të uritur, përfaqësojnë pikën kulmore të mëshirës dhe humanizmit. Në krye të atyre që e përfaqësojnë këtë pikë kulmore vjen i Dërguari i Allahut, (a.s.). Ai asnjëherë nuk u ka thënë “jo” atyre që i kanë kërkuar diçka. Nëse ka pasur, u ka dhënë. Nëse nuk ka pasur, i ka sugjeruar të tjerët që t’u jepnin. Një grua kishte bërë një pelerinë me duart e saj dhe ia kishte dhuruar të Dërguarit të Allahut (a.s.). Pejgamberi ynë i nderuar e mori dhuratën dhe e veshi. Një sahabi i tha: “O i Dërguari i Allahut! A mund të ma jepni mua këtë?” Edhe pse Pejgamberi (a.s.), kishte nevojë për atë pelerinë, nuk i tha jo atij sahabit, por menjëherë e hoqi dhe ia dha. Shembuj të tillë ka shumë në lidhje me sahabët që janë edukuar në mejtepin e Pejgamberit.

Sa’d ibn Rebia (r.a.), i cili ishte prej ensarëve, i tha vëllait të tij në besim, Abdurrahman ibn Aufit (r.a.): “Le ta ndajmë pasurinë time gjysmë për gjysmë.” Ndërsa Abdurrahmani iu përgjigj: “Allahu t’i faltë dhe t’i begatofte pasurinë e familjen. Ju më tregoni rrugën e tregut.”

Ebu Rebia, Harith ibn Hishami dhe biri i Ebu Xhehlit, Ikrime patën arritur në pragun e vdekjes ngaqë ishin plagosur në fund të një përpjekjeje të vështirë në luftën e Tebukut. Harithi kërkoi ujë për të pirë, por kur e kuptoi se edhe Ikrime ishte i etur, ia dërgoi ujin atij pa e prekur aspak. Edhe Ikrime ia dërgoi ujin në të njëjtën mënyrë Ebu Rebias. Më së fundi, të gjithë ndërruan jetë pa e pirë dot një pikë ujë.

Në botën e ditëve të sotme e cila po materializohet jashtëzakonisht, është e pamundur të rastisësh në sakrificat të tilla. Madje, është bërë e vështirë t’u be-sohet edhe këtyre ngjarjeve që kanë ndodhur përgjatë historisë. Për këtë arsye, këto tablo të vëllazërisë së vërtetë kanë filluar të shikohen me syrin e legjendës. Kjo, sepse këto ngjarje bien në kundërshtim me mentalitetin e njerëzve të materializuar.

Altruizmi i cili është bazë në Tasavuf, nga një aspekt do të thotë të shkrihesh te vëllai në besim. Pra, është qasja: “E jotja është e jotja. E imja është e jotja.” Ndërsa në botën materialiste dhe kapitaliste ku pangopësia ka arritur pikën më të lartë, sundon qasja: “E imja është e imja, edhe e jotja është e imja.” Njerëzit pothuajse janë të burgosur nëpër burgjet e egoizmit dhe pasionit.

Në këtë botë për të cilën pohohet se është moderne, e civilizuar dhe në të cilën të drejtat e njeriut mba-

hen në plan të parë, nuk bëhet fjalë të ketë mëshirë, sakrificë dhe altruizëm. Lëreni që nuk bëhet fjalë për ndarjen dhe lehtësimin e vuajtjeve, por po bëhet garë për shtimin e halleve e të problemeve.

Në një botë të tillë ku sundojnë garat për armatime, kolonializmi, pangopësia, intrigat, luftërat, komplotet dhe terrorizmi, njerëzimi ditë pas dite po shkon me shpejtësi drejt humnerës. Prodhimi dhe zhvillimi i bombave atomike dhe atyre me hidrogjen janë shenjë e kësaj katastrofe dhe çmendurie. Paratë dhe përpjekjet të cilat jepen për të djegur, shkatërruar dhe shfarosur, po të harxhoheshin për të mbështjellë plagët, për t’i ndihmuar njerëzit, për ta mposhtur varfërinë dhe për të formuar atmosferën e vëllazërisë dhe solidaritetit, për të gjithë do të kishim një botë më të qetë, më të lumtur dhe më të sigurt.

Shkaku kryesor i barbarisë dhe krimeve që po përjetojmë është qasja ndaj jetës duke mos e futur në llogari ahiretin dhe botën e përhershme. Prej atyre njerëzve që e shohin këtë botë sikur të ishte gjithçka dhe që besojnë se me vdekjen çdo gjë do të shndërrohet në një hiç, nuk mund të priten mirësi apo vepra që i pranon humanizmi dhe ndërgjegjja. Ata që e shohin çdo gjë si interes, bëjnë çdo gjë për t’i arritur interesat e tyre. Në këtë mënyrë, në plan të parë nuk del “gara në mirësi” siç thotë Kurani Fisnik, por del “gara në ligësi”. Ndërsa rezultati i garës në ligësi është i njohur prej të gjithëve.

Ajo që i ka hije njeriut, i cili është vepra më e bukur e Allahut dhe mëkëmbësi i Tij në sipërfaqen e tokës, është që të veprojë në përputhje me vlerën dhe detyrën e vet, ta dojë krijesën për hir të Krijuesit, të mos mendojë vetëm për vete, të përpiqet me zemër për t’u ndihmuar të tjerëve, të marrë lutjet e njerëzve dhe të fitojë kënaqësinë e Zotit (xh.xh.).

Për të arritur përsëri identitetin e vërtetë prej njeriu dhe myslimani, në mënyrë që të mos biem në gradën e qenve që sillen rreth e rrotull kockave dhe të hutave e hienave që kërkojnë këрма, jemi të detyruar që ta fillojmë gjithë së bashku “garën në mirësi”. Nëse arrijmë ta kuptojmë të vërtetën se “kënaqësia për të dhënë është më e lartë se kënaqësia për të marrë”, do të thotë se do të përparojmë.

Tashmë le t’i japim fund materialit tonë me këto shprehje të pashoqe të Xhelaledin Rumiut: “Miq! Nga Shemsi Tebrizi kam mësuar të ndjej. Para se ta njihja atë, qëndroja në krye të oxhakut kur të varfrit e rrugës dridheshin nga i ftohti i acartë. Kur të uriturit kalonin para derës sime, unë gjendesha në krye të sofrës. Ndërsa tani nuk ngopem dot pa u ngopur të uriturit. Përderisa të mos vishen të gjithë ata që s’kanë roba, ndjej të ftohtë edhe nëse gjendem pranë zjarrit. Prej Tebrizit mësova se një dije që të pengon të ndjesh, nuk është gjë tjetër përveçse barrë.”

Allahu Teala na bëftë prej atyre që ndjejnë, që i qajnë hallet e të tjerëve dhe që i marrin përsipër për t’i zgjidhur. Amin!



Namazi dhe Kurani

— Xhafer Durmush —

Në suren Ankebut thuhet: **“Allahu i ka krijuar qiejt dhe Tokën me qëllim të plotë. Kjo është një shenjë për besimtarët! Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.”** (Ankebut, 44-45)

Siç shprehet edhe në tefsirin e të ndjerit Omer Nasuhi Bilmenit, qëllimi nga urdhri që i jepet të Dërguarit të Allahut (a.s.), në formën: “Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit!..”, është ky: “Vazhdo ta lexosh Kuranin Fisnik i cili i nxjerr në pah shumë të vërteta, i cili i shpjegon dispozitat, i cili përmban histori mësimdhënëse dhe i cili i shpie besimtarët te lumturia e të dy botëve me këshillat etike të tij. Predikojta këtë edhe umetit, në mënyrë që të vazhdojë ta lexojë Kuranin dhe t’i përvetësojë cilësitë etike që gjenden nëpër ajetet fisnike të tij. Pasi të veprojnë kështu, do të bëhen prej robërve që i do Allahu (xh.xh.).”¹

Ndërsa në Ruhu'l-Bejan kjo fjali shpjegohet siç vijon: “Lexoje Librin (Kuranin) për t’iu afruar Allahut, për ta mësuar përmendësh dhe për të medituar rreth të vërtetave të kuptimeve të tij. Atij njeriu që e lexon Kuranin duke menduar dhe medituar rreth tij, i hapen të fshehta që nuk i janë zbuluar askujt më parë.”² Sepse leximi i Kuranit që bëhet duke menduar e medituar, i jep lexuesit ndjenja sublime dhe ia përforcon besimin. Në shtëpitë ku lexohet Kurani Fisnik zbret prej shpirtërore.³ I Dërguari i

Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ka dhënë këtë sihariq: **“Allahu i Lartësuar i përmend te engjëjt e ndershëm ata që e lexojnë Kuranin.”**⁴

Gjithashtu, siç shprehet përsëri në tefsirin e të ndjerit Omer Nasuhi Bilmenit, ajo që synohet nga urdhri që i jepet të Dërguarit të Allahut (a.s.), në formën: “Fale namazin!”, është: “Vazhdo ta falësh sipas rregullave namazin i cili është ibadeti më i madh. Këtë predikojta edhe umetit tënd, sepse namazet e falura në formë të rregullt, e mbrojnë falësin nga veprimet që bien ndesh me kënaqësinë e Allahut Teala.”⁵ Namazi e përfshin në vetvete edhe dhikrin. Për këtë arsye është adhurimi më i madh dhe më i rëndësishëm. Krahas këtyre, dijetarët myslimanë janë shprehur se falësi i namazit bën mëkat nëse namazet që i fal nuk e inkurajojnë për të bërë mirësi dhe nuk e ndalojnë nga gjynahet.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka njoftuar se namazi i një vakti do të jetë shkak për faljen e mëkateve të vogla që bëhen deri në kohën e namazit tjetër.⁶ Gjithashtu ka dhënë edhe përgëzimin se namazi së bashku me zekatin dhe mbajtjen e lidhjeve farefisnore janë prej veprave që të çojnë në xhenet.⁷

Siç vihet re, këto ajete fisnike vendosin para nesh një kornizë. Krahas këtyre, myslimani gjithmonë duhet të jetë i vetëdijshëm se është i rrethuar nga mirësitë e Allahut të Madhëruar. Ai nuk duhet ta harrojë asnjëherë të vërtetën se tokën në të cilën jetojmë, qiejt madhështorë dhe çdo gjë që gjendet ndërmjet tyre i ka krijuar Ai pa asnjë mangësi. Të gjitha këto Allahu (xh.xh.), i administron pa shkak-

tuar asnjë çekuilibrim. Myslimani së pari duhet t'i shohë me vëmendje këto ajete që flasin për krijimin. Pastaj duhet ta lexojë Kuranin Fisnik duke menduar dhe medituar rreth tij, sepse njëri prej dy burimeve kryesore është Kurani Fisnik i cili na e ndriçon rrugën me çdo verset dhe fjali të tij. Ja pra, edhe këto dy ajete fisnike na vendosin para një kornizë të mrekullueshme të jetës. Sigurisht që burimi i dytë kryesor është Suneti i të Dërguarit të Allahut (a.s.). Suneti është tërësia e fjalëve, veprave dhe aprovimeve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili ia ka predikuar njerëzimit Kuranin Fisnik duke e shpjeguar.

Pasi myslimani ta pajisë zemrën dhe mendjen me këtë vetëdije, duhet të shfaqë kujdes për t'i falur namazet obligative duke i respektuar rregullat, me përkushtim të plotë shpirtëror dhe në kohën e tyre, sepse fuqia që na jep dinamizmin për të jetuar siç besojmë janë ibadetet. Namazi është esenca e adhurimeve për shkak se e mbron besimtarin nga paturpësitë dhe ligësitë. Ndërkohë myslimani nuk duhet t'ia përkushtojë punës dhe fitimit në këtë botë të gjithë kohën e tij duke u mjaftuar vetëm me faljen e namazeve farz. Ai nuk duhet ta çojë kohën dëm duke mos u shërbyer qëllimeve të tjera përgjatë kohës që i mbetet. Përkundrazi, ai duhet të përpiqet në mënyrë të veçantë për ta mbrojtur lidhjen me Allahun dhe për të mos mbetur i shkujdesur ndaj Tij. Këtë na e kujton fjalia në ajetin fisnik: **“Përkujtimi i Allahut (dhikri) është (ibadeti) më i madh.”**

Tashmë ajo që duhet të bëjmë është që t'i shikojmë gjërat dhe ngjarjet me syrin që merr mësim, t'ua mësojmë të tjerëve Kuranin Fisnik siç ua ka pas mësuar shokëve të tij i Dërguari i Allahut

(a.s.), ta lexojmë Kuranin në shtëpitë tona, ta vendosim namazin në qendrën e jetës, ta falim atë siç e falin robërit e devotshëm të Allahut dhe të zgjohemi në kohën e agimit për të bërë dhikër.

Të gjitha këto duke u nisur nga natyra e tyre sjellin në pah një pjekuri shpirtërore. Urdhri për të debatuar në mënyrën më të mirë⁸ me elhi kitabin ka ardhur pas ajeteve që përbëjnë temën tonë. Nisur nga ky fakt, besojmë se ky urdhër është mjaft i rëndësishëm.

■ **REFERENCAT:** 1) Përkthimi dhe komentimi në turqisht i Kuranit Fisnik, Omer Nasuhi Bilmen, Botimet Kahraman, vëll. 5, fq. 2668. 2) Komentimi i Ruh'u'l-Bejan, Ismail Haki Bursevi, Botimet Erkam, vëll. 14, fq. 619. 3) Muslim, Dhikr, 38. 4) Ebu Davud, Vitir, 14. 5) Përkthimi dhe komentimi në turqisht i Kuranit Fisnik, Omer Nasuhi Bilmen, Botimet Kahraman, vëll. 5, fq. 2669. 6) Buhari, Hudud, 27. 7) Shik. Buhari, Edeb, 10. 8) Surja Ankebut, 46.



PRANIMI I LUTJEVE

Lutje do të thotë që t'i ngremë duart dhe t'ia shprehim gjendjen tonë Allahut (xh.xh.), duke qenë të vetëdijshëm për dobësinë që posedojmë. Allahu i Lartësuar kërkon që ta përdorim këtë mundësi duke u shprehur në ajetin fisnik: **“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua...”**¹ Në këtë mënyrë, Zoti i Plotfuqishëm shprehet se dera e lutjes gjithmonë është e hapur.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na e mëson esencën e kësaj çështjeje dhe na sugjeron duke u shprehur: **“Sexhdja është momenti kur rob i gjendet më afër Zotit. Për këtë arsye, mundohuni të bëni sa më shumë lutje në sexhde.”**² Një herë Sa'd ibn Ebi Vakkasi (r.a.), i kërkoj të Dërguarit të Allahut (a.s.), që të lutej për të, në mënyrë që t'i pranoheshin lutjet. Pejgamberi ynë i nderuar i kujtoi një rregull të përgjithshëm Sa'd ibn Ebi Vakkasit (r.a.), duke i thënë: **“Ha gjëra hallall dhe të pastra, në mënyrë që të të pranohen lutjet.”**³ Në një hadith tjetër, Pejgamberi na njofton se **“lutja e të dhunuarit, lutja e mysafirit dhe lutja e babait për fëmijët nuk refuzohet”**.⁴ Në këtë mënyrë, Profeti (a.s.), na tregon se duhet t'i vlerësojmë kohët specifike kur të bëjmë lutje.

Sahabët e nderuar nuk i mbajtën dot mend lutjet që i Dërguari i Allahut (a.s.), i bëri një herë. Për këtë arsye, i thanë: **“O i Dërguari i Allahut! Ti bëre shumë lutje, por nuk i mbajtën dot mend.”** Nisur nga këto fjalë, Pejgamberi (a.s.), i sugjeroi që të luteshin duke thënë: **“O Allah! Edhe unë i kërkoj prej teje ato mirësi që i kërkoj i Dërguari Yt, Muhamedi (a.s.). Gjithashtu të kërkoj mbrojtje nga ato gjëra të këqija që edhe ai të kërkoj mbrojtje...”**⁵

Islami edhe i fton besimtarët që të luten, edhe i mëson se si ta bëjnë diçka të tillë. Pyetja e sotme duhet të jetë kjo: **“Sa e vlerësojmë mirësinë që Zoti na e ka mundësuar t'ia parashtrijmë gjendjen tonë?”**

■ **REFERENCAT:** 1) Surja Bakara, 186. 2) Muslim, salat, 215. 3) Ahmed ibn Hanbel, Musned, vll. 3, fq. 321. 4) Ebu Davud, Vitir, 29. 5) Tirmidhi, Deavat, 89.



Në vepra nuk kërkohet shumica, por mirësia

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Allahu Teala thotë në suren Mulk: **“Ai i ka krijuar vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.”**¹ Në ajetin fisnik shpjegohet se shkakut dhe urtësia e krijimit të vdekjes (mevt) dhe jetës (hajati) është për të provuar se kush do të bëjë vepra më të mira (ahsenu amela). Kjo deklaratë i ka caktuar një qëllim dhe synim jetës personale dhe shoqërore të besimtarëve. Pra, jo kush bën më shumë vepra, por kush bën vepra më të mira.

Kjo botë në të vërtetë është skenë e sprovës. Askush nuk mund të mendojë se nuk do të sprovohet ngaqë mund të thotë se “besoj”. Kjo temë është shpjeguar qartë në ajetet fisnike: **“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë genë para tyre, në mënyrë që, Allahu t’i dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë. A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se do t’i shpëtojnë dënimit Tonë?! Sa keq që gjykojnë**

ata! Kush shpreson takimin e Allahut, ta dijë se Dita e caktuar nga Ai do të arrijë. Ai dëgjon dhe di gjithçka.”²

Mbi të gjitha, fakti që vdekja është përmendur para jetës në ajetin që përbën bazën e shkrimit tonë, tregon se është një theks që na e vendos dhe përforcon vetëdijen për të bërë veprat dhe për të shfaqur sjelljet më të mira. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: **“Vdekja mjafton si paralajmërues.”**

Nga ana tjetër, të harruarit e vdekjes dhe marrjes në llogari, janë prej shkaqeve kryesore të gabimeve që bëhen. Prej ajetit fisnik kuptohet se ata që merren veçanërisht me arsimin dhe aktivitetet e thirrjes në fe, në të gjitha veprat dhe sjelljet që përfshijnë të tërë jetën, duhet ta mbajnë në plan të parë parimin për ta bërë veprën sa më mirë. Madje, prej ajetit mund të nxjerrim edhe këtë kuptim për prijësit e xhematëve: **“Ata nuk duhet të bëhen shejhu’l-evrad, por duhet të bëhen shejhu’l-irshad.”** Kjo do të thotë

1. Mulk, 2.

2. Ankebut, 2-5.

se këta prijës të xhemateve nuk duhet t'u sugjerojnë shumë dhikër njerëzve, por duhet t'u sugjerojnë që t'i bëjnë veprat sa më mirë, sepse, nëse marrim parasysh faktin se tarikatet janë apo duhet të jenë institucione që synojnë përsosmërinë në fetari me kusht që të mos dalin jashtë kornizës së sheriatit, para se t'i këshillojnë xhematet me shumë dhikër duhet t'i këshillojnë për të shfaqur përpikëri ndaj farzeve dhe të drejtave nga aspekti "për të bërë vepra të mira". Sa i saktë mund të konsiderohet si rregull që muridët të cilët kanë mangësi në këndimin e sureve në namaz, t'u jepet shumë dhikër për të bërë në vend që t'u mësohen rregullat e leximit të Kuranit dhe t'u jepet dije e përgjithshme?

Nëse preferohet bërja e veprave të shumta dhe jo bukuria/përsosmëria në to, atëherë kjo do të shkaktojë humbje të mëdha si një shkarje e parësisë në qëllimin e krijimit. Në fetari duhet të bëhet jashtëzakonisht kujdes ndaj kësaj pike, sepse fetaria nuk është çështje pohimi apo shtirjeje, por është çështje sinqeriteti dhe veprimi në përputhje me parimet.

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), pa një grup sahabësh që insistonin për të mbajtur agjërim pa shkëputje (savmi visal), i paralajmëroi ata duke u thënë: *"Merrni përsipër vepra që mund t'i bëni."*³ Në këtë mënyrë i urdhëroi dhe i këshilloi që të mos rendin për të bërë sa më shumë vepra, por për t'i kryer sa më mirë ato që mund t'i bëjnë.

Aishja, (r.a.), ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"Allahu dëshiron që kur dikush prej jush të bëjë ndonjë punë, ta bëjë atë sa më mirë."*⁴

Kryerja e punës në mënyrë sa më të mirë dhe të bukur është cilësi që u përket atyre të cilëve e kanë të zhvilluar ndjenjën e bukurisë dhe përgjegjësisë, domethënë, atyre që e përvetësojnë punën dhe janë të aftë për ta bërë.

Teuhidi në besim, sinqeriteti në adhurim, ndershmëria në vepra, delikatesa në art dhe estetika e bukuria në punë janë prej gjërave që i përfshin shprehja "ahsenu amela" e ajetit fisnik dhe prej gjërave që i sugjeron hadithi që e transmeton nëna jonë, Aishja. Nisur nga këto mund të arrijmë në një përfundim të tillë: Kryerja e punës në kohën më të

shkurtër, në formën më të bukur dhe në cilësinë më të lartë me kusht që të jetë prej gjërave të ligshme, duhet të jetë cilësia dalluese e myslimanit në punë.

Ata që bëjnë dredhi në punë dhe që e pandehin si zgjuarsí apo mençuri anashkalimin e përgjegjësisë, dihet qartazi se janë larg përsosmërisë dhe cilësisë në punë. Veçanërisht ata që kanë në dorë udhëheqjen e shoqërisë duhet t'i kryejnë përgjegjësitë e tyre në mënyrën më të bukur, domethënë sipas parimeve. Nëse ata nuk i kryejnë përgjegjësitë sipas parimeve dhe nuk e posedojnë pjekurinë për t'u dhënë rëndësi shërbimeve ndaj umetit, atëherë kjo është një gjendje shumë tragjike. Paralajmërimi: *"Kur t'u jepet puna atyre që nuk janë të aftë për të, prite kiametin!"*⁵, e shpjegon mjaftueshëm tragjedinë në këtë çështje.

Parimi për ta bërë punën në formën më të mirë (ahsenu amela) na mëson t'i përdorim aftësitë në fushat e tyre, të tërhiqemi nga një punë që s'mund ta bëjmë dhe t'ua lëmë atë njerëzve që janë të aftë për ta kryer.

Arritja e suksesit në fushat e tregtisë, artit, udhëheqjes dhe industrisë është në raport me arritjen e suksesit për të zbatuar Islamin në formën më të përsosur, i cili na bazë ka sjell idealin për të bërë më të mirën. Gjithashtu, kjo ka lidhje edhe me dëshirën për të bërë më të mirën në vepra.

**NËSE PREFEROHET
BËRJA E VEPRAVE TË SHUMTA
DHE JO BUKURIA/PËRSOSMËRIA
NË TO, ATËHERË KJO DO TË
SHKAKTOJË HUMBJE TË MËDHA SI NJË
SHKARJE E PARËSISË NË QËLLIMIN
E KRIJIMIT. NË FETARI DUHET TË
BËHET JASHTËZAKONISHT KUJDES
NDAJ KËSAJ PIKE, SEPSE FETARIA
NUK ËSHTË ÇËSHTJE POHIMI APO
SHTIRJEJE, POR ËSHTË ÇËSHTJE
SINQERITETI DHE VEPRIMI NË
PËRPUTHJE ME PARIMET.**

REZULTATI

Bukurinë në vepër jemi të detyruar ta kërkojmë te pasimi i besimit dhe te zbatimi i parimeve që ka formuar bota e besimit tonë. Çdo gjë që është e huaj ndaj vlerave të besimit, ajo është e papranueshme edhe pse mund të jetë e bukur. Edhe një punë e kryer pa përpjekjen për ta përsosur atë, është në kundërshtim me parimin edhe pse mund të jetë e kërkuar kryerja e saj. Për këtë arsye, ajo nuk e shpie kryerësin e saj te qëllimi i vërtetë. Domethënë, nuk është efektive për ta çuar te kënaqësia e Allahut Teala.

Islami, i cili kërkon mirësi edhe në luftë apo në therjen e kafshëve, para së gjithash i thërret myslimanët për t'u bërë njerëz që preokupohen me vepra të mira e të bukura edhe nëse nuk janë të shumta, sepse "njeriut nuk i shihet guna, por i shihet puna".

Atëherë, bukurinë në punë nuk duhet ta flijojmë ndaj shumicës në të.

3. Shik. Buhari, Savm 49, Rikak 18; Muslim Iman 199, Sijam 58; Ebu Davud, Tatavvu' 27; Nesai, Kible 13; Ibn Maxhe, Zuhd 28; Muvatta, Salatu'l-lejl 4; Ahmed b. Hanbel, Musned II, 231, 250, 412, 418, 496.

4. Bejhaki, Shuabu'l-Iman, IV, 334-335 (Bejrut, 1990).

5. Buhari, Ilm.

Besimi ka kushte

— Nuredin Jëlldëz —

MËKATET QË BËHEN KUNDREJT ALLAHUT (XH.XH.) DHE GJYNAHET QË JANË SHNDËRRUAR NË RUTINË E MBAJNË TË GJALLË PYETJEN: “PËR ÇFARË ËSHTË BESIMI NË AHIRET? KU MBETI KY BESIM?” KUSH MUND T’I BESOJË FJALËS “BESIM NË AHIRET” NË KËTË BOTË KU PO KONSIDEROHEN KREJT NORMALE VEPRAT TË CILAT DO TË BËHEN SHKAK PËR SKUQJEN E FYTYRËS NË BOTËN E PËRTEJME, MADJE EDHE PËR T’U DJEGUR NË ZJARR?

Të gjithë e dimë se besimi ka gjashtë kushte. Shprehja: “Kushtet e besimit janë gjashtë.”, është një e dhënë që thuhet lehtë aq sa thuhet shprehja “unë apo ti”. Kjo e dhënë është e vërtetë. Besimi me të vërtetë ka gjashtë kushte. Këto gjashtë kushte janë parimet e domosdoshme për t’u bërë njeri besimtar i cili do të hyjë në xhenet. Allahu, engjëjt, librat, peygamberët, ahireti dhe kaderi. Atë që thotë se u besoj këtyre, e quajmë besimtar. Përderisa të mos ketë diçka në kundërshtim me këto, ai është besimtar dhe një individ i shoqërisë besimtare. Gjëja më e vogël që duhet për të hyrë në xhenet dhe për të shpëtuar nga zjarri i xhehenemit përbëhet nga këto. Ditën kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, i ka ftuar njerëzit të Allahut, këto ishin kushtet e besimit. Edhe sot këto janë bazat që duhet të besohen. Kjo listë nuk

do të ndryshojë deri në kohën e kiametit. Ne kështu besojmë dhe jemi të bindur se kjo është e vërteta.

Që nga brezi i parë i myslimanëve, besimtarët ua kanë mësuar këto fëmijëve të tyre që kanë dëshiruar t'i edukojnë dhe rrisin si besimtarë. Në këtë mënyrë, përgjatë gjithë historisë këto janë mësuar si kushtet e besimit. Elhamdulillah-lah/falënderimi i takon Allahut.

Ndërkohë që këto janë kushtet e besimit tonë, a duhet t'i deklarojmë me gjuhë dhe t'i vërtetojmë me zemër? Për shembull, a duhet ta pohojmë dhe pranojmë në botën tonë të brendshme besimin ndaj engjëjve? Ne duhet ta shtjellojmë në këtë formë këtë pa shkuar në debate shkencore. Pra, le ta shqyrtojmë këtë nga aspekti i besimit ndaj engjëjve. Nëse një njeri thotë: “Sigurisht që u besoj engjëjve.”, por ia shtrin dorën dhe e shikon me sy haramin në ndonjë vend të fshehur prej njerëzve, çfarë përgjigjeje do t'i jepte pyetjes: “Ti sikur u besojë engjëjve?” Kjo çështje qëndron para nesh si një problem serioz. A nuk do të thotë besimi ndaj engjëjve që ta dish se engjëjt e vëzhgojnë një vend për të cilin pandehet se nuk e shikon askush? Të pranosh se engjëjt gjenden edhe në një vend ku mbaron matematika e biologjia dhe se ata e shohin edhe atë që nuk e shohin sytë e njerëzve, duhet të jetë rezultati praktik i besimit ndaj engjëjve. Të besosh ekzistencën e engjëjve që mbushin qiejt është tjetër gjë dhe të besosh në një formë absolute ndaj ekzistencës së engjëjve që na rrethojnë është tjetër gjë. Andaj, besimi ndaj engjëjve i cili është njëri prej gjashtë kushteve të imanit, duhet të njihet dhe përvetësohet si një kusht i domosdoshëm për ta pranuar të vërtetën se nuk mund të ketë një jetë pa engjëjt, se nuk mund të fshihet gjë prej tyre dhe se nesër ata do të jenë dëshmitarë për ne në audiençën e Allahut Teala. Ky është besimi i cili luan rol të rëndësishëm në jetën tonë.

Të njëjtat gjëra mund t'i themi edhe për besimin ndaj librave. Libri që këndohet nëpër varreza është tjetër gjë dhe libri që orienton nefsën tona është tjetër gjë. Sot si besimtarë besojmë se u është zbritur Ungjilli umeteve të mëparshme, por ja që besimi ynë është sipërfaqësor. Ne i besojmë atij libri parimisht dhe themi: “Allahu e ka dërguar një libër të tillë. Njerëzit janë bërë besimtarë ose jobesimtarë duke i besuar apo duke mos i besuar atij.” Por ja që asnjë besimtar nuk thotë: “Vallë, a është në përputhje me Ungjillin ky veprim që bëj?” Në fakt, edhe nuk duhet ta thotë këtë, sep-

**FAKTI QË JEMI QUAJTUR BESIMTARË/
MYSLIMANË NUK NA JEP TË DREJTË T'I
BËJMË ELASTIKË KUSHTET E BESIMIT
SIPAS VETES DHE KOHËS SONË. BAZAT
E NJË BESIMI QË ËSHTË SHKËPUTUR
GRADUALISHT NGA ORIGJINA DHE
KUSHTET E TIJ PËRBËJNË NJË DEFEKT
QË I BIE NË SY ÇDO BESIMTARI DHE
QË KËRKON PËRPJEKJE PËR T'U
RREGULLUAR.**

se besimi parimisht ndaj Ungjillit nuk e bën të domosdoshme marrjen e tij për udhërrëfyes. A mund ta themi të njëjtën gjë edhe për Kuranin Fisnik? Mos vallë i besojmë edhe Kuranit parimisht? Përderisa të mos e zbatojmë Kuranin, do të thotë se nuk e kemi besuar siç duhet.

Edhe aspektet e tjera nuk janë të ndryshme me këtë. Andaj është e rëndësishme se në çfarë pozite e vendosim kaderin kur martohemi dhe kur vlerësojmë rezultatet që lindin nga kjo martesë. Një besim i zakonshëm ndaj kaderit nuk mund të jetë i njëjtë me besimin e një besimtarë që e ndjen se kaderi përparon si një tren mbi shina. Përderisa të mos e shohim kaderin si binarët mbi të cilët ecim, besimi për të cilin po flasim do të thotë se nuk është bashkuar me kushtin e tij.

Mëkatet që bëhen kundrejt Allahut (xh.xh.) dhe gjynahet që janë shndërruar në rutinë e mbajnë të gjallë pyetjen: “Për çfarë është besimi në ahiret? Ku mbeti ky besim?” Kush mund t'i besojë fjalës “besim në ahiret” në këtë botë ku po konsiderohen krejt normale veprat të cilat do të bëhen shkak për skuqjen e fytyrës në botën e përtejme, madje edhe për t'u djegur në zjarr? Për çfarë besimi mund të flasë një shoqëri që e percepton botën tjetër si të dhënat e frikshme të botës virtuale? Të kuptuarit e jetës dhe të vdekjes në formën si “jetesë sipër dhe nën tokë”, nuk është një mangësi që mund të rregullohet duke u shprehur: “Besoj.”

Fakti që jemi quajtur besimtarë/myslimanë nuk na jep të drejtë t'i bëjmë elastikë kushtet e besimit sipas vetes dhe kohës sonë. Bazat e një besimi që është shkëputur gradualisht nga origjina dhe kushtet e tij përbëjnë një defekt që i bie në sy çdo besimtarë dhe që kërkon përpjekje për t'u rregulluar. Besimi ynë përbëhet nga vlerat që sot vërtetohen në praktikë dhe nesër u shikohen rezultatet. Ky është kushti.

NUK KA VEND PËR PANIK

— Idris Arpat —

Kur të na jepet mundësia për t'u ulur dhe për të biseduar, mendoj se do të ishte jashtëzakonisht bukur nëse themi fjalë që ia shtojnë bashkëbiseduesit nivelin e të kuptuarit, që ia kënaqin zemrën dhe që ia zgjerojnë horizontin. Nëse në atë bisedë do të harxhohet pak apo shumë kohë, sigurisht që duhet të flitet për diçka të dobishme, sepse kapitali që po harxhojmë është koha e cila përbën jetën tonë. Ndërsa çdo lloj veprimi tjetër në kundërshtim me këtë është shpërdorim i kohës. Ne siç nuk kemi kohë për ta shpërdoruar, nuk mund të themi edhe fjalë që ia nxijnë jetën bashkëbiseduesit, që ia ngrenë nervat dhe që e detyrojnë për të na urryer apo për t'ia nxitur mllefën. Kjo është një situatë negative.

Në Kuranin Fisnik thuhet: *"Thuaju, robërve të Mi, që të flasim atë që është më e mira..."* (Isra, 53) Në fakt, shoqëria është mjaft e tensionuar. Andaj, nuk ka asnjë kuptim që ta shtojmë edhe më shumë tensionin.

* * *

Ka prej atyre njerëzve që gjithmonë janë pozitivë. Në kuvendin ku gjenden përhapin një atmosferë pozitive. Edhe pse kanë shqetësimet dhe problemet e tyre, ato i mbajnë brenda dhe gjithmonë preferojnë të buzëqeshin. Kur njerëzit e tillë frekuentojnë diku, ua shtojnë gëzimin të tjerëve. Këta janë njerëz që gjembat i mbajnë brenda dhe trëndafilat i nxjerrin jashtë.

Në këtë botë ka një mijë e një lloj gjendjesh. Pra, ka festë, ka edhe fatkeqësi. Ka shëndet, ka edhe sëmundje. Ka pasuri, ka edhe varfëri... Sido që të jetë situata, nuk duhet të tensionohemi, nuk duhet të kaplohem nga dëshpërimi dhe pesimizmi, nuk duhet të bëjmë panik, por duhet të përpiqemi t'i zgjidhim problemet me gjaktohtësi duke kërkuar ndihmë nga Allahu i Lartësuar. Nëse ato që na ndodhin do t'i hidhnim prapa duke thënë: "Është një re. Andaj, do të kalojë.", do të shfaqnim një qëndrim shumë të qëlluar dhe pozitiv.

Sidoqoftë nuk jemi në xhennet, por gjendemi si udhëtarë në këtë botë të përkohshme. Në këtë botë kanë ardhur dhe kanë ikur shumë pejgamberë, shumë njerëz të mëdhenj dhe shumë njerëz të mirë. Andaj mendoj që edhe ne t'i plotësojmë ditët tona të kufizuara duke



u mbështetur te Allahu, duke kërkuar ndihmën e Tij, duke u përpjekur në maksimum, duke thënë këngën tonë dhe duke ua ditur vlerën mirësive që na ka dhënë Ai.

* * *

Të urtët kanë thënë: “Shpirti e gjen rehatinë në punë.” Kjo është e vërteta. Njeriu është programuar nga Fuqia Krijuese që të veprojë sipas situatës. Pa shikojeni fëmijën. Ai nuk rri në asnjë vend dhe vrapon kudo që shkon.

Përroi vazhdon të rrjedhë, era vazhdon të fryjë, zogu vazhdon të fluturojë... Edhe një ferrë çel lule dhe jep aromë kur i vjen koha. Gjyshërit tanë kanë thënë: “Aty ku ka lëvizje ka edhe begati.”

Njeriu duhet ta kërkojë lumturinë duke u aktivizuar dhe duke punuar. Andaj, më mirë le të dërrmohemi duke punuar, sesa të zëmë ndryshk. Si ka thënë populli: “Njeriu që ka preokupime është njeri i lumtur.”

Edhe pushimin e konsiderojmë brenda punës. Zemra jonë punon përgjatë gjithë jetës ngaqë pushon shpesh herë. Të pushuarit është një nevojë e natyrshme e organizmit. Kjo nevojë nuk mund të neglizhohet. Pushimin mund ta realizojmë edhe duke ndërruar punë. Kjo do të thotë se është e mundur që lodhjet fizike mund t'i shuajmë duke punuar me mendje dhe lodhjet mentale mund t'i shuajmë duke punuar fizikisht. Në këtë mënyrë, edhe pushimi realizohet, edhe produktiviteti e begatia shtohen.

Allahu i Lartësuar thotë në suren Jasin: **“Sigurisht që atë ditë banorët e Xhenetit (janë të preokupuar) nuk do të mendojnë për gjë tjetër, veç lumturisë së tyre.”** (Jasin, 55)

Njeriu kurrë nuk do të bëhet i lumtur duke mos punuar, duke bërë thashetheme, duke bërë një jetë monotone, duke qëndruar nëpër qoshet e kafeneve dhe duke vështruar përreth i dëshpëruar. Njeriu do ta gjejë begatinë në lëvizje dhe lumturinë në punë.

* * *

Mendoj se dëshira për të punuar nuk duhet të na pengojë për t'i parë bukuritë. Këtë fjali veçanërisht po e përdor për bukuritë në natyrë. Sigurisht që këtu mund të përfshihen edhe fushat e tjera. Më kujtohet një shprehje e profesorit tonë të nderuar, Bekir Topallogllusë: “Të gjithë njerëzit e mëdhenj kanë ndjerë interesim për natyrën. Sa më shumë që përparonte shkenca, ky interesim shndërrohej në mahnitje.”

Natyra gjendet para syve tanë si një libër që e ka

shkruar Allahu (xh.xh.) dhe si një galeri e arteve të bukura. “Kurani Fisnik flet, ndërsa natyra e aprovon atë në mënyrë të vazhdueshme.” Ata presin të gjithë njerëzit që t'i shohin këto bukuri të pafundme dhe t'i perceptojnë.

Mendimi ynë që do të fokusohet te natyra, do të na shpjerë të mahnitja dhe admirimi. Kjo do të bëhet shkak për forcimin e besimit dhe për shtimin e gëzimit e lumturisë sonë.

Dëshira e tepërt për të punuar sa më shumë (tamahu) na shkakton lodhje. Ndërsa lodhja na pengon që t'i përkushtohemi mjedisit, ngjarjeve dhe gjërave të bukura. Për këtë arsye, nëse do të bëjmë tamah dhe do të lodhemi, nuk do t'i shohim dot bukuritë që na rrethojnë dhe nuk do të përjetojmë mahnitje e admirim. Ky është një privim i madh.

* * *

Të urtët kanë thënë: “Ekuilibri është rregull i artë. Teprimi është kundër tij.” Sa bukur që kanë thënë! Kjo është e vlefshme për të gjithë jetën tonë duke përfshirë këtu edhe ibadetet.

Njeriu gjithmonë nuk mund të jetojë duke bërë kujdes në maksimum. Gjithashtu edhe rregullat vazhdimisht nuk mund t'i zbatojë të gjitha. Nganjëherë mund të bjerë në shkujdesje dhe nganjëherë tjetër mund ta humbasë vëmendjen. Pra, njeriu mund të gabojë. Përveçse mund të gabojë, mund edhe të mos i kuptojë gabimet që ka bërë.

Ja, pikërisht në këtë pikë lind nevoja për paralajmërime dhe këshilla që bëhen në mënyrë miqësore dhe të përshtatshme. Njeriu këto paralajmërime duhet t'i shohë si mirësi e Allahut Teala. Në të kundërt, asnjëherë nuk mund të shpëtojmë prej mangësive dhe gabimeve. Populli ka thënë: “Ai që nuk e duron paralajmërimin, nuk mund ta arrijë përsosmërinë.”

Kur ta paralajmërojmë apo kundërshtojmë bashkëbiseduesin, duhet ta bëjmë në mënyrë miqësore dhe jo ta largojmë atë prej nesh. Koha, vendi dhe kushtet janë të rëndësishme. Niveli dhe gjendja shpirtërore janë të rëndësishme. Dinjiteti, sedra, krenaria, etj. janë të rëndësishme. Andaj kundërshtimi nuk mund të bëhet me nxitim. Përndryshe, duke menduar se po rregullojmë vetullën, mund të nxjerrin syrin.

Njeriu që kundërshton nuk duhet të jetë një tip i dhënë pas kundërshtimit. Ai nuk duhet të gjejë mangësi për çdo gjë dhe nuk duhet të ndërhyjë në çdo veprim. Ai gjithashtu duhet ta shikojë edhe anën e mbushur të gotës. Pra, nuk duhet t'i nënvlerësojë anët pozitive. Nëse është e mundur, kundërshtimi duhet të shoqërohet edhe me buzëqeshje.

Edukimi i vullnetit sipas Sunetit

— Shemsedin Kërësh —

Në shumë ajete të Kuranit Fisnik tregohet se çfarë pasojash mund të ketë nëse vullneti nuk merret nën sundim. Ndërmjet këtyre më të rëndësishme janë ajetet që flasim për shndërrimin e dëshirave vetjake në zot.¹

“Prandaj, mos e lër atë që nuk beson në të (Ditën e Kiametit) dhe që jepet pas epsheve të veta, të të nxjerrë (nga rruga e drejtë), përndryshe do të shkatërrohesh.”²

“A e ke parë ti atë që epushin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij?”³

“...Kush është në humbje më të madhe, se ata që udhëhiqen nga dëshirat e veta.”⁴

Fjala “heva” që është përdorur në këto ajete, në një ajet tjetër⁵ është përdorur në kuptimin që era e merr një objekt dhe e zvarrit në ndonjë vend të paditur. Dëshirat që nuk merren dot nën kontroll luajnë me njeriun siç luan era e fortë me ndonjë send. Më së fundi, ky njeri nuk e di se ku mund të përfundojë.

Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), u ka bërë sahabëve praktikë në edukimin e marrjes së nefsit nën kontroll. Në një hadith fisnik që e ka transmetuar Sheddad ibn Evsi (r.a.), i cili është i varrosur në Kuds, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Njeri i mençur është ai që e sundon nefsën dhe punon për pas vdekjes. Ndërsa njeri i paafët është ai që ndjek dëshirat e nefsit dhe pastaj vazhdimisht i shpreh kërkesa Allahut.”⁶ Folja “dane” që kalon në shprehjen “men dane nefsehu”, vjen nga e njëjta rrënjë me fjalën “din/fe”. Pra, kjo do të thotë që njeriu duhet ta marrë veten nën kontroll me anë të fesë (me urdhrat hyjnorë). Edhe në këtë hadith ka edukim të dëshirave dhe të vullnetit:

“Nuk ka besuar ai që dëshirat e të cilit nuk i pasojnë rregullat që kam sjell.”⁷ Në shpjegimin e këtij hadithi fisnik, Ibn Rexhep Hanbeli është shprehur: “Të gjitha mëkatet burojnë nga përparësia që u jepet dëshirave e epsheve kundrejt dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Allahu Teala në shumë ajete të Kuranit Fisnik i ka cilësuar politeistët si “njerëz që ndjekin dëshirat dhe epshet e tyre”. Edhe veprat që janë bidat burojnë nga përparësia



që u jepet dëshirave vetjake kundrejt dispozitave të shariatit.”⁸

VEPRAT QË DUHET DHE S'DUHET T'I DUAM

I Dërguari i Allahut (a.s.), nuk i ka dhënë vullnetit vetëm edukimin praktik, por ka bërë edhe edukimin e dëshirave që akoma nuk janë realizuar dhe nuk janë hedhur nga teoria në vepër. Në literaturën e hadithit gjendet një kapitull që titullohet “kitabul-temenni”. Kur i studiojmë këto hadithe të këtij kapitulli, gjejmë detaje interesante, të fshehta dhe urtësi në lidhje me edukimin e dëshirave të parealizuara.

Sipas të Dërguarit të Allahut (a.s.), gjërat që duhet të dëshirohen prej nesh janë xhihadit dhe rënia dëshmor.⁹ Ai është shprehur se po të mos ishte sevapi i hixhretit, do të dëshironte të ishte prej ensarëve.¹⁰ Në krye të veprave që duhet t'i duam pas besimit dhe xhihadit vjen të qenët muhaxhir apo ensar. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “*Besimtari nuk ngopet duke bërë mirësi derisa të shkojë në xhenet.*”¹¹ Edhe të kënduarit e Kuranit Fisnik, të vepruarit me të, të harxhuarit e pasurisë në rrugë të Allahut janë prej veprave që duhet t'i duam.¹²

Gjithashtu ka edhe gjëra që nuk duhet t'i duam. Për shembull, të dëshirosh vdekjen nuk është diçka e drejtë.¹³ Allahu Teala i ka krijuar njerëzit të ndryshëm nga njëri-tjetri. Të gjithë sprovohen me aftësitë dhe cilësitë që u janë dhënë. Andaj, nuk është e drejtë që burrat të dëshirojnë për t'u bërë gra dhe gratë të dëshirojnë për t'u bërë burra. Edhe burrat, edhe gratë do ta marrin pjesën e tyre nga aspekti i sevapit për veprat e mira që bëjnë.¹⁴ Hyrja në luftë me armikun pa asnjë arsye, nuk është

prej gjërave të dëshiruara.¹⁵ Por nëse lufta bëhet e pashmangshme, bëhet qëndresë. Madje mund të thuhet edhe këto poezi siç ka vepruar i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe sahabët në luftën e Hendekut:

“Levla ente mehtedejna ve la tasaddakna vela sal-lejna,

Fe enzilen sekineten alejna,

Inne'l-melee kad begau alejna,

Idha eradu fitneten ebejna ebejna.”

“O Zot! Po të mos ishe Ti, nuk do të udhëzoheshim, nuk do të bënim mirësi dhe nuk do të falnim namaz. Zbrit mbi ne paqen, sepse këta njerëz po na sulmojnë. Nëse këta shkaktojnë përçarje, ne do të bëjmë qëndresë dhe do të rezistojmë.”¹⁶

Fuqia kundër qafirëve që e kalojnë çdo kufi është prej gjërave që dëshirohet, sepse edhe Luti (a.s.), tha kundrejt njerëzve të tërbuar dhe dashakeqës: “*...Sikur unë të kisha fuqi (që t'ju dëboj) ose të mbështetesh në ndonjë krah të fuqishëm!*”¹⁷ I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “*Besimtari i fuqishëm është më i dashur te Allahu se besimtari i dobët.*”¹⁸ Pra, fuqia është diçka që mund të dëshirohet. Por këtu duhet të shprehim edhe diçka. Nëse arrijmë të sigurojmë fuqi, atëherë kjo fuqi nuk duhet t'i fusë në dorë vlerat tona dhe ne. Në një hadith thuhet se kur gjykatësi të merret në llogari ditën e gjykimit, do të thotë: “Ah sikur të mos isha bërë gjykues ndërmjet dy vetave qoftë edhe për një mosmarrëveshje në lidhje me një kokërr hurme.”¹⁹ Në lidhje me transmetimin e këtij hadithi janë thënë gjëra të ndryshme. Krahas kësaj, këtu nuk sugjerohet largimi nga gjykimi, por paralajmërimi i atij që vjen në këtë detyrë. Andaj, duhet të jemi të kujdesshëm kur të gjykojmë ndërmjet dy vetave dhe të mos e teprojmë në dëshirimin e kësaj detyrë.

■ **REFERENCAT:** 1) Xhathije, 23. 2) Taha, 16. 3) Furkan, 43. 4) Kasas, 50. 5) Haxh, 31: “...Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), i ngjan atij që bie nga qielli e që e rrëmben zogu ose i ngjan atij që stuhia e erës e ka hedhur në një vend të largët e të humbur.” 6) Tirmidhi, Kijame, err-Rekaik ve'l-vera, 25; Ibn Maxhe, Zuhd 31 (hadithi nr: 4260). 7) Mustedrek, IV, 164. 8) Ibn Rexhep Hanbeli, Xhamiu'l-Ulumi ve'l-Hikem, fq. 678. 9) Buhari, Temenni, 1. 10) Buhari, Temenni, 9. 11) Tirmidhi, Ilm, 19 (hadithi nr: 2686). 12) Buhari, Temenni, 5. 13) Buhari, Temenni, 6. 14) Nisa, 32. 15) Buhari, Temenni, 8. 16) Buhari, Temenni, 7. 17) Hud, 80. 18) Muslim, Kader, 34. 19) Ibn Hibban, Sahih, Kada, 1 (hadithi nr: 5055).



ALLAHU i do të devotshmit

— As. doç. dr. Mustafa Karbaxhak —

Kuptimi leksikor i fjalës takva është “të mbrosh, të mbrohesh, të largohesh, të shfaqësh respekt, të bëhesh fetar, të bindesh, të frikësohesh dhe të hezitosh”. Ndërsa në kuptimin terminologjik do të thotë: “Përpikëri që shfaqet në zbatimin e urdhrave dhe sugjerimeve të fesë dhe në largimin nga mëkatet.” Fjala takva në Kuranin Fisnik dhe hadithet e Pejgamberit (a.s.), nganjëherë përdoret sipas kuptimit leksikor dhe nganjëherë tjetër në kuptimin: “Ruajtje nga ndëshkimi duke i zbatuar urdhrat e Allahut dhe duke u larguar nga gjërat që ka ndaluar Ai.” Ndërsa njeriut të devotshëm i thuhet “muttaki”. Në përgjithësi pejgamberët u kanë thënë kështu umeteve të tyre: **“Kini frikë Allahun dhe mu bindni mua!”** (Shuara, 26/108, 126, 131, 144, 179.)

Kurani Fisnik është një libër që e komenton vetë veten e tij. Ndërkohë që Allahu Teala ia ka lënë Pejgamberit (a.s) shpjegimin e disa koncepteve, disa të tjera i ka shpjeguar vetë. Njëri prej koncepteve që Allahu Teala e ka shpjeguar vetë është koncepti “mutteki/i devotshëm”. Allahu i madhëruar shprehet si më poshtë se kush është i devotshëm: **“Elif, Lâm, Mîm. Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit, të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne. Dhe për ata që besojnë në atë që të është shpallur ty (o Muhamed), në atë që është shpallur përpara teje dhe që me bindje i besojnë jetës tjetër. Ata janë udhëzuar në rrugë të drejtë nga Zoti i tyre dhe pikërisht ata janë të shpëtuarit.”** (Bakara, 1-5)

CILËSITË E TË DEVOTSHMËVE

Sipas këtij shpjegimi të Allahut Teala, për t'u bërë i devotshëm së pari duhet t'i besojmë gajbit. Besimi në gajb do të thotë besim në atë që nuk e sheh. Bazat e besimit të myslimanët në të vërtetë të gjitha janë gajb. Në këtë kontekst, ne i besojmë Zotit, engjëjve, pejgamberëve, ditës së gjykimit dhe kadasë e kaderit edhe pse nuk kemi aspak të dhëna në lidhje me ta. Çështja për të cilën njerëzit kanë hyrë në debate të panevojshme për ta kuptuar dhe që e kanë shtjelluar më së shumti prej bazave të besimit është çështja e kadasë dhe kaderit. Në këtë çështje që mendja e njeriut është e kufizuar për ta konceptuar, më e mira është që të mos debatohet. Ebu Hurejre (r.a.), tregon se kur i Dërguari i Allahut,

(a.s.), pa dy vetë në Mesxhidu'n-Nebevi duke debatuar në lidhje me çështjen e kaderit, fytyra i ndryshoi aq shumë sa që iu shfaqën njolla të kuqe si kokrra shege. Atyre u tha: "A me këtë jeni urdhëruar? (Për të debatuar çështje të tilla që nuk i kupton mendja juaj?) Mos vallë unë jam dërguar te ju për këtë? Ata që kanë qenë para jush janë shkatërruar kur kanë filluar të debatohet në këtë çështje. Mos debatoni qoftë edhe një herë tjetër në lidhje me këtë çështje!" (Tirmidhi, Kader, 1.)

Temat për të cilat myslimani interesohet apo debaton në lidhje me to duhet të kenë dobi për këtë botë apo për botën tjetër. I Dërguari i Allahut (a.s.), i është përgjigjur siç vijon sahabit që e pyeti se kur do të ndodhë kiameti: "(Lëri këto pyetje dhe më thuaj) çfarë ke përgatitur për kiametin?" (Buhari, Edeb, 95.)

Domethënë, Resulullahu (a.s.), ka kërkuar që sahabët të mos preokupohen me pyetje të tilla që nuk kanë dobi praktike dhe të mos e humbasin kohën me to.

Ne duhet t'u besojmë bazave të besimit tonë pa u marrë shumë me fjalë siç bëjnë disa në median sociale dhe televizione. Bazat e besimit në Islam janë caktuar si gjashtë. Në të vërtetë bazat e besimit mund të zbriten edhe në besimin ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Madje, mund të zbriten vetëm në besimin ndaj Allahut, sepse një besimtar që i beson Allahut Teala, beson se kanë ardhur edhe pejgamberë, edhe libra nëpërmjet engjëjve për t'i paralajmëruar njerëzit që largohen nga rruga e drejtë. Ai gjithashtu beson se njerëzit që u përmbahen këtyre parimeve do të hyjnë në xhenet dhe se ata që

nuk u përmbahen do të hyjnë në xhehenem (pra, i beson ditës së gjykimit). Ai beson se të gjitha këto gjenden në dijen e pafillimit të Allahut, domethënë, i beson kazasë dhe kaderit.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), shprehet se e ka marrë malli për ata që do t'i besojnë edhe pse nuk e kanë parë. Ebu Hurejre (r.a.), transmeton se një ditë i Dërguari i Allahut (a.s.), shkoi te varrezat bashkë me shokët e tij. Kur arriti te varrezat tha: "Paqja e Allahut qoftë mbi ju o banorët e vendeve të besimtarëve! Inshallah një ditë edhe ne do të bashkohemi me ju. Do desha shumë t'i shikoja vëllezërit e mi." Sahabët e nderuar i thanë: "A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguari i Allahut?" Resulullahu (a.s.), u përgjigj: "Ju jeni shokët e mi. Ndërsa vëllezërit e mi janë ata që nuk kanë ardhur akoma." Nisur nga



**NAMAZI ËSHTË PREJ
IBADETEVE KUSHT TË
MYSLIMANËVE. KUR
ALLAHU TEALA I RADHIT
CILËSITË E BESIMTARËVE
TË CILËT DO TË
SHPËTOJNË, SHPREHET SE
ATA E FALIN NAMAZIN DHE
SE E FALIN NË MËNYRË TË
VAZHDUESHME.**

këto fjalë, sahabët e pyetën: "Si do t'i njohësh (ditën e gjykimit) ata që akoma nuk kanë ardhur nga umeti yt, o i Dërguari i Allahut?" Pejgamberi iu përgjigj atyre duke u bërë këtë pyetje: "Mendoni një njeri që ka një kalë me ballë dhe këmbë të zeza. A nuk mund ta gjej ky njeri kalin e tij në një kope kuajsh krejt të zinj?" Sahabët thanë: "Po, e gjen, o i Dërguari i Allahut." Nisur nga kjo përgjigje, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha: "Ja pra, edhe ata do të vijnë me fytyrë të ndritur dhe me duar e këmbë që shkëlqejnë për shkak të abdestit. Unë do të shkoj para atyre në krye të burimit tim dhe do t'i pres ata aty për t'u dhënë ujë. Kini kujdes! Disa njerëz do të përzihen nga burimi im siç përzihet dhe largohet deveja e huaj nga kopeja. Unë do t'u thërras atyre: Ejani këtu! Mua do të më thuhet: Ata e kanë ndryshuar gjendjen pas teje (nuk e kanë ndjekur sunetin tënd dhe kanë devijuar në rrugë të tjera. Ata kanë bërë mëkate të mëdha.) Nisur nga kjo edhe unë do të them: Le të përzihen! Le të përzihen!" (Muslim, Taharet, 39; Ibn Maxhe, Zuhd, 36.)

Edhe një cilësi tjetër e të devotshmëve është se ata e falin namazin dhe japin nga ato që u ka dhënë Allahu. Namazi dhe zekati janë prej shtyllave të Islamit. Në një hadith fisnik thuhet se namazi është shtylla e fesë. (Bejhaki, Shuabu'l-Iman, IV, 300, hadithi nr: 2550.) Për këtë arsye, namazi është prej ibadeteve kusht të myslimanëve. Kur Allahu Teala i radhit cilësitë e besimtarëve të cilët do të shpëtojnë, shprehet se ata e falin namazin (Mu'minun, 2) dhe

se e falin në mënyrë të vazhdueshme. (Mu'minun, 9; Mearixh, 23, 34.).

TË DEVOTSHMIT JANË EVLIATË (MIQTË) E ALLAHUT

Besimtarët e devotshëm në të njëjtën kohë janë miqtë e Allahut Teala. Zoti (xh.sh.), shprehet se kur njerëzit të besojnë dhe të bëhen të devotshëm, bëhet miqtë e Tij. Për besimtarët e tillë Allahu shprehet se nuk do të ketë frikë dhe brengosje: ***“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.*** (Të tillë janë) ***ata që besojnë dhe që i frikësohen*** (Allahut).” (Junus, 62-63) ***“Pa dyshim, ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu!” dhe pastaj qëndrojnë në rrugën e drejtë, nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar e as për t’u dëshpëruar*** (kur t’u vijë vdekja). ***Ata do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, si shpërblim për atë që kanë punuar.***” (Ahkaf, 13-14)

PËR TË DEVOTSHMIT JANË PËRGATITUR MIRËSI NË KËTË BOTË DHE NË BOTËN E PËRTEJME

Allahu Teala ka përgatitur mirësi edhe në këtë botë edhe në botën tjetër për besimtarët e devotshëm. Njerëzit fillojnë ta shohin që në këtë botë mirësinë e të qenët i devotshëm. Allahu i Madhëruar na njofton se i do njerëzit nëse ata besojnë dhe bëhen të devotshëm. (Shik. Al Imran, 76.) Ai ka deklaruar se këtyre njerëzve do t’u japë shumë mirësi edhe në këtë botë: ***“Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t’u dërgonim bekime nga qielli dhe toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë.***” (A’raf, 96) Gjithashtu Zoti (xh.sh.), shprehet se do t’u lëshojë shi të begatë robërve të tij të devotshëm: ***“Sikur të qëndronin (banorët e Mekës) në rrugën e vërtetë, Ne do t’u jepnim ujë të bollshëm.***” (Xhin, 16)


Allahu i Lartësuar ka përgatitur mirësi edhe në botën e përtejme për besimtarët e devotshëm. Të besuarit në Zot dhe të jetuarit sipas rregullave të Islamit është shkak edhe për arritjen e mirësive të xhenetit: ***“Sikur ihtarët e Librit të besonin dhe të ruheshin nga mohimi, Ne do t’ua mbulonim veprat e këqija dhe do t’i shpinim në kopshtet e kënaqësisë.***” (Maide, 65) Allahu Teala i shpreh si më poshtë një pjesë të mirësive të xhenetit që janë premtuar për të devotshmit: ***“Ja përshkrimi i Xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve (ndaj Allahut): një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty***

lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre. A mund të krahasohet ky shembull me Xhehenemin, ku gjynahçarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t’u jepet ujë i vluar, që ua copëton zorrët?!” (Muhammed, 15) Zoti i Madhëruar shprehet se të devotshmit do të qëndrojnë gjithmonë në xhenet: ***“Por, ata që i frikësohen Zotit të tyre do të kenë kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përjetësisht...”*** (Al Imran, 198)

Si përfundim, të jesh i devotshëm do të thotë të bëhesh siç u ka thënë Allahu të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve: ***“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar. Ashtu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty, e mos i kaloni kufijtë, se Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që punoni ju.***” (Hud, 112) Gjithashtu të jesh i devotshëm do të thotë të largohesh nga mëkatet e mëdha dhe të mos insistosh në mëkatet e vogla. Nëse njeriu bën kujdes kundrejt mëkateve të mëdha, Allahu Teala na njofton se do t’ia falë mëkatet e vogla: ***“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t’ju falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.”*** (Nisa, 31) Gjithashtu të jesh i devotshëm do të thotë të jesh i sinqertë në besim dhe adhurime. ***“Nëse je i sinqertë në fe, të mjafton qoftë edhe pak ibadet.”*** (Hakim, Mustedrek, IV, 341, hadithi nr: 7844.)

“NË QOFTË SE JU U SHMANGENI GJYNAHEVE TË MËDHA, QË JU JANË NDALUAR, NE DO T’JU FALIM GABIMET TUAJA TË VOGLA DHE DO T’JU SHPIEM NË NJË VEND TË NDERUAR.”

(Nisa, 31)



Misteri në të fshehtat e kohës



— Ali Byjyqçapar —

Koha rrjedh vazhdimisht. Ndikimi i saj ndjehet aq shumë prej nesh sa që është e pamundur të mos habitemi. Ndërkohë që dje po jetonim kohën e fëmijërisë, sot papritur vëmë re se kemi arritur moshën e pjekurisë. Vitet janë të mbushura me kohën që i ndjek dhe me shumë gjëra të panjohura që koha na i bën.

Sigurisht që duhet të ketë një mënyrë për ta shndërruar kohën në mirëqenie.

Shumica e njerëzve që na rrethojnë gjithmonë përpiqen ta nxjerrin veten të pastër duke ua hedhur fajet dhe mëkatet të tjerëve. Këta njerëz pothuajse nuk i shohin aspak përgjegjësitë e tyre. Si ka mundësi që jetojmë kaq larg prej qëllimit të ekzistencës sonë duke vepruar në këtë mënyrë? Përgjegjësitë gjithmonë ua hedhim të tjerëve. Andaj, vë re se këtu ka një problem serioz.

Një botëkuptim që nuk ka konsideratë për vete po e përvëlton botën islame. Mirë, por gjithmonë kështu do të vazhdojë kjo gjendje? Nëse do ta vazhdojmë rrugën me të njëjtin botëkuptim, historia vazhdimisht do të përsëritet. Por nëse i marrim përsipër përgjegjësitë dhe hyjmë në rrugën e Allahut (xh. xh.), atëherë botëkuptimi i një historie dhe civilizimi të ri do t'i japë formë jetës sonë dhe do të hapë rrugë për shumë sihariqe.

Feja është veprim!

Pasioni për botën e përtejme që gjendet në esencën tonë do të jetë pika e fillimit për ne dhe urtësia që do të na caktojë drejtimin për rrugëdaljen. Përse përmallohemi për botën e përhershme dhe përpiqemi për të si njerëz? Këtë mister i cili na ka interesuar që nga pejgamberi i parë i Zotit, Ademi (a.s.), duhet ta zbulojmë dhe t'i caktojmë vetes drejtimin tonë.

Ky zë që gjendet në shpirtin tonë na ndjek natë e ditë. Ai na paralajmëron edhe në momente kur nuk e presim dhe na njofton për ekzistencën e vet.

Të thënë "unë" nuk duhet të mendohet si një perceptim që na kujton negativitetin. Njerëzimi duhet të merret në dorë dhe të edukohet. Pastaj ky edukim duhet të kurorëzohet me urtësinë e Islamit. Për këtë arsye, ne e kemi kusht që të luftojmë me këtë botëkuptim të mjerueshëm që ka të njëjtën vlerë me djallëzinë. Ata të cilët pandehin se po bëjnë ndonjë gjë të madhe duke i pastruar nga egoizmi shoqëritë myslimane, i ftoj ta përdorin mendjen dhe të logjikojnë.

Çfarë mbetet pasi të mos jemi njerëz? Për këtë arsye, së pari duhet të caktojmë hartën e rrugës sonë. Pastaj duhet të përballemi me vështirësitë në adhurim ndaj Allahut Teala dhe shërbim ndaj njerëzve. Domethënë, nuk duhet t'i mbylлим veshët kundrejt këtij zëri që na thërret duke bërë titur me gjithë fuqinë e tij nga thellësitë e zemrës.

Formimi i personalitetit fillon kur njeriu e pranon veten e tij. Nëse do të ndërtohet një njeri, para së gjithash duhet të analizohen ato që ndodhin në fushën e egos.

Botëkuptimet e ngushta që i ka sjellë jeta e mendimit evropian jetës së mendimit tonë duhet t'i ndërrojmë me urtësinë tonë të gjerë. Ndoshta duhet t'ia vëmë veshin kësaj deklaratë të Nuredin Topçiu: "Njeriu fetar nuk është një njeri që di atë që nuk e di jofetari, por është një njeri që posedon më shumë fuqi. Feja është burim fuqie për njerëzit, jo burim dijeje." (Sociologji, N. Topçu, fq. 83.)

Modestia DHE MENDJEMADHËSIA

— Sami Gëksyn —

*“Mos ec
nëpër tokë me
mendjemadhësi,
se ti, në të
vërtetë, nuk
mund ta çash
tokën e as të
arrish lartësinë
e maleve.”*

(Isra, 37)

Qëllimi i fesë islame është përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet njerëzve dhe sigurimi i një jete të qetë e të lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër.

Për ta arritur këtë qetësi e lumturi, feja jonë ka vendosur bazat e moralit të lartë. Të qenët e njeriut modest në marrëdhëniet qoftë me njerëzit dhe qoftë me Allahun e Lartësuar, është kushti i parë i kësaj qetësie. Ndërsa mendjemadhësia e cila është e kundërta e kësaj, domethënë mburrja është faktori më i madh i dëshpërimit.

Modesti do të thotë që t'i duash njerëzit (për hir të Krijuesit) kushdo qofshin ata, të mos i përçmosh, të mos u mburresh, të mos shfaqësh epërsi ndaj tyre, të takohesh dhe të bisedosh me ata. Ndërsa e kundërta e kësaj është mendjemadhësia.

Modestia e lartëson njeriun, e pjek dhe e shpie drejt gradave të përsosmërisë. Ndërsa mendjemadhësia e poshtëron njeriun. Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kush shfaq modesti (kundrejt robërve të Allahut) për hir të Allahut Teala, edhe Allahu e lartëson atë një gradë për shkak të kësaj...” (Ibn Maxhe, Zuhd, 16.)

Nëse njeriu sillet me modesti, njerëzit e tjerë fillojnë të ndjejnë dashuri kundrejt tij dhe ta respektojnë. Ja, pikërisht për këtë arsye, njerëzit me moral të lartë dhe të virtytshmit duhen dhe respektohen shumë nga të tjerët. Sikundër kësaj, mendjemëdhënjtë nuk duhen dhe nuk respektohen.

Njeriu modest e shikon veten si një hiç duke menduar madhësitinë e Allahut të Madhëruar. Në këtë mënyrë, arrin vetëdijen se madhështia i përket vetëm Allahut Teala. Ai gjithmonë jeton duke qenë i vetëdijshëm se asnjë lloj gjendje, çfarëdo qoftë ajo, nuk e bën të nevojshme mendjemadhësinë.

Modestia është një cilësi e bukur. Kur të shtohen njerëzit me këtë cilësi, shtohet edhe dashuria, respekti dhe dashuria në shoqëri. Atëherë armiqësitë shuhën, grindjet pakësohen dhe urrejtja zhduket.

Njerëzit që janë modestë nuk ndahen asnjëherë nga veprat e mira dhe gjithmonë dëshirojnë t'i afrohen Allahut të Lartësuar. Sigurisht se kjo gjendje u jep atyre pozita të larta shpirtërore.

Pa dyshim se njeriu më modest nga të gjithë njerëzit që kanë ardhur dhe do të vijë në këtë botë është i Dërguari i Allahut, (a.s.). Ai gjithmonë sillet me modesti edhe pse pozita e tij ishte më i larta dhe interesohet në veçanti me çdo besimtar pa marrë parasysh nëse ishte i varfër, skamnor apo skllav. Ai nuk preferoi të ishte profet sulltan, por profet rob dhe thoshte:

“Përgëzime për atë e mbron dinjitetin e tij, që

është modest, që është zemërbutë, por që nuk lejon ta poshtërojnë, që e harxhon në rrugë të drejtë pasurinë që e ka fituar në mënyrë të ligjshme, që i mëshiron të dobët dhe që vazhdimisht rri me fakihët dhe të urtët. Përgëzime për atë që e ka fitimin hallall, që është i pastër nga brenda dhe nga jashtë dhe që e largon të keqen nga njerëzit. Lum për atë që punon me dijen që ka marrë, e jep në rrugë të Allahut tepriçën e pasurisë së tij dhe që e mban fjalën.” (et-Tergib ve't-Terhib, fq. 558.)

Në lidhje me këtë çështje, edhe Allahu i Madhëruar thotë në një ajet fisnik:

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!” (Furkan, 63)

Edhe njerëzit që bëjnë një jetë modeste dhe që kanë arritur të bëhen njerëz të devotshëm me pjekurinë shpirtërore të moralit të lartë, i tolerojnë krijesat për shkak të Krijuesit dhe e konsiderojnë veten përgjegjës në çdo vend ku mund të arrijë zemra e tyre modeste. Ata gjithmonë i ndihmojnë nevojtarët dhe shfaqin butësi e mëshirë kundrejt tyre. Andaj, në vend se t'ua kthejnë kurrizin njerëzve për shkak të mëkateve të tyre, përipiqen për t'i gjetur xhevahiret që kanë brenda tyre dhe për t'i shndërruar në njerëz që do të hyjnë në xhenetin e përhershëm. Sa bukur që e shpreh ky shembull këtë të vërtetë:

“Përgjatë një fjalimi që Mevlana po mbante në një faltore, vjen një i dehur. Njerëzit që gjendeshin aty deshën ta nxirrnin menjëherë jashtë të dehurin. Mevlana mendoj se i dehuri mund të kishte ardhur për të mësuar ndonjë gjë. Prandaj u kthye nga njerëzit që e lënduan atë dhe u tha:

“Ai ka pirë alkool, por të dehurit jeni ju!”

Tani le të flasim qoftë edhe pak për të kundërtën e modestisë, pra, për mendjemadhësinë.

Mendjemadhësia është një lloj sëmundjeje prej sëmundjeve të zemrës dhe njëra prej fatkeqësive të saj. Allahu, (xh.sh.), nuk i do aspak mendjemdhentë dhe në shumë vende të Kuranit Fisnik i qorton ata me mënyra të ndryshme.

Në ajetin fisnik të 18-të të sures Lukman, Allahu i Lartësuar thotë:

“Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemdhentë e mburracakët!”

Mendjemadhësia është një shfaqje e harbutllëkut, papjekurisë, mungesës së mirësjelljes dhe tiranisë. Për këtë arsye, Allahu, (xh.sh.), e ka kritikuar në Kuran mendjemadhësinë, vetëpëlqimin, mburrjen dhe të shikuarit e vetes më lart se të tjerët.

Përsëri në Kuranin Fisnik, Allahu Teala thotë:

“Në Ditën e Kiametit do t'i shihni ata që kanë

trilluar gënjeshtër për Allahun, me fytyra të nxira. Vallë, a nuk është Xhehenemi vend për ata që janë mendjemdhentë?!” (Zumer, 60)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Nuk mund të hyjë në xhenet ai që ka në zemër mendjemadhësi (qoftë edhe) sa një grimcë.” (Muslim, Iman, 147.)

Hasan Basriu pa një prijës që ecte me mendjemadhësi dhe tha:

“Turp të ketë ai që sheh majtas e djathtas duke e mbajtur kokën përpjetë dhe duke u mburrur. O budalla! Çfarë të pëlqen te vetja që ec duke parë majtas e djathtas aq sa mund të shikosh edhe supet, duke u lëkundur dhe duke u mburrur? Mos të pëlqejnë mirësitë, për të cilat nuk e kemi falënderuar Allahun aq sa e meriton? Apo të pëlqen pasuria që pandeh se e ke fituar pa ndihmën e Allahut dhe për të cilën nuk duhet ta falënderosh Atë?

Kur prijësi i dëgjoi këto fjalë, menjëherë u ndikua, shkoi te Hasan Basriu dhe i kërkoi ndjesë. Ndërsa Hasan Basriu ia ktheu:

“Mos më kërkoni ndjesë mua, por kërkoni falje Allahut Teala dhe pendohu te Ai! A nuk e ke dëgjuar se Ai ka thënë:

“Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve.” (Isra, 37)

Të shfaqësh mendjemadhësi kundrejt njerëzve do të thotë të shfaqësh mendjemadhësi kundrejt Allahut të Lartësuar. Shembullin e parë të kësaj gjendjeje e shohim te djalli i mallkuar, sepse shejtani nuk i bëri sexhde Ademit. Kështu që e kundërshtoi urdhrin e Allahut duke shfaqur mendjemadhësi. Ja çfarë thotë ajeti fisnik në lidhje me këtë çështje:

“Kur u thamë engjëjve: “Përluni në sexhde para Ademit”, ata u përlunë, përveç Iblisit, i cili nuk deshi, u tregua mendjemadh dhe u bë mosbesimtar.” (Bakara, 34)

Ja pra, shejtani tha: “Unë jam më i mirë se ai.” – dhe shfaqti mendjemadhësi kundrejt Ademit, (a.s.). Ai e kundërshtoi urdhrin e Allahut duke shfaqur mendjemadhësi ngaqë nuk i bëri sexhde Ademit (a.s.). Për këtë arsye, u largua një herë e përgjithmonë nga mëshira e Allahut dhe u shkatërrua. Fundi i mendjemdhentëve gjithmonë do të jetë si fundi i shejtanit.

Ejani vëllezër të dashur dhe të bëhemi modestë. Në këtë mënyrë, të përipiqemi ta fitojmë pëlqimin e Allahut Teala dhe ndërmjetësimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Allahu i Lartësuar na mbrojtë të gjithëve prej çdo lloji sëmundjeje të zemrës dhe na bëftë prej besimtarëve të devotshëm!

Amin!..



Mirënjohja

NDAJ MIRËSIVE

— B. Xhahit Êzdemir —

Që nga koha e Ademit, (a.s.), shpirti i Kabilit, i cili përfaqëson injorancën, ka ekzistuar gjithmonë dhe është shfaqur në grada të caktuara sipas kushteve. Civilizimi i famshëm i cili u përhap me ndihmën e fesë islame, e cila iu zbrit Hatemu'l-Enbija, (a.s.), i shqeu errësirat e injorancës në formën me influencuese dhe e shpiu këtë botë për shekuj me radhë të oqeani i drejtësisë dhe paqes.

Në shekujt e fundit, shpirti i Kabilit ka rifituar fuqi. Si rezultat i kësaj, shtetet kolonizuese e ndaluan perandorinë osmane, të cilën e shikonin si pengesë përpara ambicieve egoiste të tyre që nuk perceptohen dot nga asnjë logjikë, dhe pasi e detyruan të tërhiqej nga skena e historisë, u bënë sunduesit e ecurisë së kësaj bote. Kjo periudhë, në të cilën po vihen në praktikë planet më të pandërgjegjshme për hir të orekseve që s'dinë të ngopen, emërtohet si “injanca moderne” nga dijetari egjiptian Muhamed Kutub. Në këtë periudhë, e cila mund të cilësohet si “brutalitet i përgjithshëm”, me mundësitë që ka sjellë edhe teknologjia, bota njerëzore bashkë me pasuritë e saj natyrore po pëson shkatërrimin më të madh.

Të urtët thonë: “Njeriu ha për të jetuar, nuk jeton për të ngrënë.” Por njeriu “modern” i kohës sonë që e ka harruar ahiretin, bën çdo gjë me ambicien për ta ngopur neftin e tij si njerëzit e shthurur të Romës së vjetër. Shpërndarja e të ardhurave në botë është aq e çekuilibruar, saqë në vendet e prapambetura me miliona njerëz vdesin nga uria. Ndërsa të pasurit, ndërkohë që i shfrytëzojnë këta të varfrit duke

i kolonizuar, po vdesin prej sëmundjeve që sjell mbingopja. Në ajetin fisnik thuhet: **“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë “të shijojnë” pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).”** (Rum, 41) Ekuilibri natyror është shkatërruar duke i shfrytëzuar në mënyrë barbare pasuritë natyrore, të cilat i kemi amanet, thjesht për të fituar sa më shumë. Shumë specie bimësh dhe kafshësh janë zhdukur. Për shkak se njeriu, i cili është krijesa më e bukur, e ka kthyer në gërmadhë këtë botë, e cila është më e bukura në gjithësi, njerëzia sot po ndeshet me tragjeditë natyrore. Në një hadith fisnik që ka lidhje me neftin e njeriut, e cila nuk di se çfarë është të mjaftuarit me atë që posedon, thuhet:

“Sikur njeriu të kishte një luginë plot me florinj, do të dëshironte të kishte dy lugina plot me florinj. Sikur të kishte dy lugina plot me florinj, patjetër do të dëshironte të kishte edhe një luginë të tretë plot me florinj. Dëshirat e njeriut nuk kanë të mbaruar. Syriri e tij e ngop vetëm dheu.” (Buhari, Muslim.)

Aliu (r.a.), ka thënë:

“Të varfrit ngelin të uritur aq sa të pasurit e shpërdorojnë pasurinë e tyre.” Ndërkohë që ka shumë njerëz që përpëliten për shkak të skamllëkut, shpërdorimi i pasurisë nga njeriu dhe të qenët koprrac duke menduar vetëm për vete, është prej sjelljeve më të këqija që nuk përputhen me ndershmërinë e tij. Në Kuranin Fisnik thuhet:

“O ju që kenë besuar! Jepni nga të mirat që ju

kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit) **në të cilën nuk ka shit-blerje, as miqësi, as ndër-mjetësi! Jobesimtarët janë keqbërësit e vërtetë.**” (Bakara, 254) Përdorimi i mirësive, të cilat Allahu, (xh.sh.), ia ka dhuruar njeriut, me vetëdijen e të dhënit për hir të Allahut dhe altruizmit dhe në përputhje me pëlqimin e Atij, është lumturia më e madhe. Kjo është prej veprave që njeriut do t’i japë përgëzime në ahiret. Në lidhje me këtë çështje shënohet kështu një sjellje e shkëlqyer e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili është “shembulli më i mirë” nga çdo aspekt për të gjithë:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyeti Aishen, radijallahu anha: “Çfarë ke bërë me delen që u ther në shtëpi?” Ajo iu përgjigj: “E kam ndarë të tërën përveç një kocke shpatulle.” Pasi Pejgamberi mori një përgjigje të tillë, e shprehu kështu gëzimin e tij:

“E gjitha qenka bërë e jona, përveç një kocke shpatulle.”

Edhe robërit e devotshëm, të cilët janë miq të Allahut Teala, janë përpjekur ta mbartin këtë ndjeshmëri profetike.

Njëra prej shenjave të disa sëmundjeve psikologjike është harxhimi i parave në mënyrë të pandërgjegjshme dhe në vende jo të duhura. Në kohën tonë, shumë prej njerëzve që nuk e kanë këtë ndjeshmëri sociale, janë shndërruar në maniakë që bëjnë shpenzime të pallogaritshme. Ndërkohë që shoqëria nuk i zgjat këmbët aq sa ka jorganin dhe po zhytet në batakun e borxhit, është mbushur plot me shembuj negativë duke mos toleruar nga pasionet e pamatura si ndryshimi i mobilieve të shtëpisë brenda disa viteve, zgjedhja e mobilieve më të shtrenjta me ambicien për të blerë gjëra prej markave të famshme, të ngrënët, të pirët dhe argëtimi i pakufishëm, etj... Faktor tjetër i rëndësishëm në lidhje me këtë çështje është shfrytëzimi i njerëzve në emër të “modës” për hir të fitimit të disa firmave të caktuara që e nxisin konsumin. Këtë mashtrim të tmerrshëm e shprehin me këtë gazmore:

“Moda është kaq e shëmtuar saqë ndryshohet një herë në gjashtë muaj ngaqë nuk pëlqehet edhe nga vetë stilistët e modës.”

Imam Azami, Ebu Hanife thotë:

“Për ta kuptuar se nga ka ardhur një pasuri, duhet të shikojmë se ku shpenzohet.” Kjo çështje është ana tjetër, nga aspekti i paqes shoqërore, e gjendjes së frikshme të cilën po e shtjellojmë dhe e cila shkakton disa tragjedi dhe fatkeqësi familjare.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë për atë që do të vuaj në ahiret, ndërkohë që u ka lënë pasardhësve të tij pasuri të madhe, por të fituar me haram:

“Turp, turp për atë njeri që u lë familjarëve të tij pasuri, ndërkohë që vetë do të dalë në audiencën e Zotit (xh.sh.), me të keqen (barrën e llogarisë së pasurisë që ka fituar).” (Sujuti, Xhamiu’s-Sagir, nr: 9693.)

Allahu Teala i ka dhuruar njeriut, të cilin e ka bërë mëkëmbës të Tij në sipërfaqen e tokës, mirësi të pallogaritshme në përputhje me këtë fisnikëri që i ka falur, por sa ia di vlerën njeriu kësaj fisnikërie? Në Kuranin Fisnik thuhet:

“Allahu e ka bërë natën që ju të pushoni, ndërsa ditën e ka bërë të ndritshme për të parë. Vërtet, Allahu është Dhurues i madh ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk janë mirënjohës.” (Gafir, 61) Ndërkohë që shumë njerëz janë të privuar nga mirësia për ta falënderuar Allahun Teala për mirësitë që u ka dhënë, vlen të theksojmë edhe çështjen e mënyrave të respektimit të edukatës së falënderimit të atyre që e kryejnë këtë obligim. Njerëzit e devotshëm thonë:

“Njeriu duhet ta falënderojë Allahun e Lartësuar dy herë për çdo frymëmarrje. Një herë kur të marrë frymë dhe një herë tjetër kur ta japë atë.”

Gjërat që sot hidhen në koshat e mbeturinave kanë përmasa aq të mëdha saqë nëse do të përdoreshin për bamirësi mund ta parandalonin problemin e mungesës së ushqimit në vendet e varfra. Pra, koshat e mbeturina janë të mbushur plot e përplot me mirësi të shpërdoruara. Tashmë kanë filluar të pakësohen ndjeshëm njerëzit që nuk e shkelin bukën që e shohin në tokë, por që e marrin me respekt dhe e vendosin në një vend. Kështu që po shtohen njerëzit që nuk e njohin mungesën e ushqimit dhe që e konsiderojnë si modë lënien e disa kafshatave ushqim në pjatë dhe lënien e një gishti pijeje në gotën e tyre.

Në hadithin fisnik thuhet:

“Ditën e Kiametit, njeriu nuk do të largohet dot nga audienca e Zotit pa dhënë llogari se “si i ka përdorur mirësitë që i ishin dhënë amanet...” (Tirmidhi, Sifatu’l-Kijame, 1.)

Ndërkohë që mund të lartësohemi në gradën e një robi të devotshëm me virtytin e falënderimit të Zotit (xh.sh.), për mirësitë që na ka dhënë, rruga që duhet të ndjekim për të mos u bërë fatkeq në të dy botëve me humbjen e mosmirënjohjes ndaj mirësive, është marrja për shembull e jetës së bekuar të Krenarisë së Gjithësisë, të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili përshkruhet si një “Kuran i gjallë” dhe “Shembulli më i shkëlqyer dhe Mëshirë për Botët”.

“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri tjetrit durimin.”

(Asr, 1-3)

Surja hapet me një betim hyjnor për kohën, sepse ajo është një nga krijesat më madhështore të Allahut dhe për shkak të rëndësisë që ajo paraqet në jetën e njeriut.

Sipas transmetimit të Ibn Xheririt, Aliu (r.a.), ka thënë: “Pasha fatkeqësitë që koha sjell njëra pas tjetrës! Pasha fatkeqësitë që ruajnë njëra tjetrën! E vërteta është se njeriu është në humbje të plotë deri në fundin e kohës.”

Urtësia e të betuarit në kohë është një paralajmërim në lidhje me fatkeqësitë dhe ngjarjet e mëdha, si dhe me ndryshimet e thella që koha do të sjell në jetën tonë.

Koha përmban të gjitha gjërat e çuditshme dhe të mahnitshme. Prandaj ajo është quajtur “Ebul Axheb”, që do të thotë “Babai i çudisë”. Çdo situatë e ngjarje e përgjithshme ose e përveçme, e njohur ose panjohur, e hidhur ose e ëmbël, ndodh pikërisht në të. Shtetet, popujt, të mirat, fatkeqësitë shfaqen në kohë, rriten në të dhe pikërisht aty shuhen dhe mbesin. Koha është “gjëja më e

çuditshme ndër të gjitha gjërat e çuditshme”. Ajo është parametri i ndryshimit që lëvizë dhe ecën pa u ndalur, si kontekst i çdo gjëje, por që në të njëjtën kohë është edhe një proces qëndrimi dhe konstanteje.

Një poet arab thotë:

*Vërej se koha është si një anije,
Vërshon drejt vdekjes së bashku me ne
E lëvizjet e saj nuk mund t'i shquajmë*

Sa më shumë që kalon koha, aq më tepër njeriu i afrohet humbjes, nëse nuk plotëson katër kushte që kanë të bëjnë me përsosjen e tij personale dhe përsosjen e të tjerëve: be-simi tek Allahu dhe te gjithçka që Ai ka urdhëruar të besohet; kryerja e veprave të mira, qofshin këto fizike apo shpirtërore; këshillimi i të tjerëve me këtë të vërtetë dhe këshillimi që të durojnë në përpjekjen e tyre për t’iu përmbajtur urdhrave të Allahut dhe për të duruar sprovat e dhembshme dhe të vështira që mund të ketë përcaktuar Ai.

Sipas një transmetimi nga Ebu Hurejra (r.a.) Pejgamberi (a.s.) ka thënë:
"Ka dy mirësi përballë të cilave shumica e njerëzve qëndrojnë indiferent: Shëndeti dhe koha e lirë."

(Buhari, Rikak 1. Gjithashtu shih Tirmidhi, Zuhd1; Ibni Maxhe, Zuhd 15)

Dy fjalë komenti:

Për të kryer adhurimet, për t'i shprehur Zotit përlujtje, për të bërë mirë dhe për të qenë të dobishëm, rëndësia e shëndetit dhe kohës është e padiskutueshme. Dy mirësitë që njeriu mendon se ka për t'i pasur gjithmonë, por që një ditë do t'i merren, janë pikërisht shëndeti dhe koha. Shprehjet që përdorim në gjuhën tonë dhe fjalët e ndryshme popullore si "Kryet e çdo pune është shëndeti", "me shëndet" etj, tregojnë rëndësinë e padiskutueshme të shëndetit. Kryesorja është që të mund ta vlerësojmë shëndetin jo thjeshtë me fjalë të bukura, por duke e shfrytëzuar atë ashtu siç duhet.

Në pikëpamjen e fesë dhe të punës, koha e lirë është një mirësi që humbet dhe është e vështirë të rigjendet. Sidomos në qytetet e mëdha, ku jeta është e zhurmshme, e shpejtë, e përfshirë në lëvizje të pareshtur dhe e lodhshme, njerëzit ia dinë shumë më mirë vlerën

kohës së lirë. Njeriu i këtij shekulli, i cili ditën e kalon duke ngarendur ndërsa natën e përqendron vëmendjen te televizioni, ka shumë nevojë ta shfrytëzojë kohën e lirë për zhvillimin e tij shpirtëror.

Aq sa shfrytëzohet koha e lirë dhe shëndeti, po aq është edhe rezultati në përpjekjen tonë. Në të kundërt, kauzën e kemi krejt të humbur. Le të mos harrojmë se asnjë prej sekondave që kalojnë nuk do të mund ta kthejmë më prapa. "Koha është si shpata", nëse nuk tregohet kujdes i veçantë ndaj saj, ajo të pret. Gjithashtu edhe shëndeti bën pjesë në ato mirësi vlera e të cilave kuptohet vetëm pasi i humbasim.

Këto dy mirësi duhen përdorur me kujdes e përpikëri në rrugën e afrimit me Allahun e Lartmadhëruar, sepse pikërisht këto janë dy kushtet bazike dhe themelore që na sjellin suksesin e sigurt në kauzën tonë, duke na bërë diferencën me të tjerët.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Vlerësimi i kohës dhe i shëndetit e shpie njeriun në lumturinë e kësaj bote dhe në atë të botës tjetër.
2. Duke e shpërdoruar kohën dhe shëndetin, shumë njerëz e humbasin vlerësimin për to.
3. Islami kërkon që të vlerësohen në masën e duhur koha dhe shëndeti. Sepse kapitali i jetës përdoret vetëm një herë.

Mje Hadith



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- P J E S A X I V -

SHPËRTHIMI KIAMETIT

Kur të jenë shfaqur të gjitha shenjat e vogla e të mëdha të Kiametit dhe të vijë çasti i vdekjes së kësaj bote, i caktuar prej Allahut të Madhëruar, atëherë do të realizohet edhe premtimi i madh hyjnor.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“..Kiameti do të ndodhë patjetër dhe menjëherë, saqë kur shitësi dhe blerësi të kenë hapur copën (e pëllhurës), nuk do të kenë kohë as për të bërë pazar dhe as për ta mbledhur atë. Edhe pse njeriu do ta ketë mjelë qumështin e devesë, nuk do të ketë kohë ta pijë, sepse Kiameti do të shpërthejë papritur. Po ashtu, kur njeriu ta ketë rregulluar mirë basenin e ujit, Kiameti do të shpërthejë papritur, pa pasur mundësi që ai ta përdorë ujin. Njeriu do ta ngrejë dorën për të futur kafshatën e bukës në gojë, por nuk do të mund ta hajë, sepse Kiameti do të shpërthejë papritur.” (Buhari, Rikak, 40; Ahmed, II, 369. Shih. Muslim, Fiten, 140, Iman, 248.)

Fryrja e Surit

Shpërthimi i Kiametit do të fillojë me fryrjen e Surit. Suri është një lloj borie në formë briri, të cilit do t'i fryjë meleku Israfil (a.s.), njëherë për të filluar shpërthimin e jashtëzakonshëm të Kiametit dhe njëherë për të filluar ringjalljen e njerëzve pas Kiametit dhe mbledhjen e tyre në sheshin e madh të Mahsherit.

Lidhur me këtë bori (Sur), e cila përmban shumë aspekte të panjohura për ne, gjejmë disa të dhëna në këto hadithe fisnike:

“Suri është briri, që i fryhet (në ditën e Kiametit)” (Ebu Daud, Sunnet, 24.)

Në Kuranin Fisnik lajmërohem se Surit do t'i fryhet dy herë. Në këto ajete fisnike, na bëhen të ditura disa prej ngjarjeve që do të ndodhin në univers si rezultat i fryrjes së parë:

“Dhe kur t'i fryhet një herë Surit, kur toka dhe malet të ngrihen lart e të thërrmohen me një goditje shkatërrimtare, atëherë do të ndodhë Ngjar-

ja e pashmangshme (Kiameti). Dhe do të çahet qielli, që atë ditë do të jetë i thyeshëm.” (Hakka, 13-16.)

“Ditën, kur Toka dhe malet dridhen e bëhen si pirgje rëre të lëvizshme.” (Muzzemmil, 14.)

“Kur yjet të shuhen dhe, kur qielli të çahet dhe, kur malet të thërrmohen si pluhur dhe, kur të dërguarit të tubohen në kohën e caktuar.” (Murselat, 8-11.)

“Ditën, kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt!..” (Ibrahim, 48.)

“Atë Ditë, Ne do të palosim qiellin, ashtu siç paloset letra e librit. Ashtu siç e filluam krijimin e parë, do ta përsërisim atë. Ky është premtimi Ynë. Ne do ta bëjmë këtë me të vërtetë.” (Enbija, 104.)

“Kur të të pyesin ty (o Muhamed) për malet, thuaj: «Ato do t'i bëjë hi e pluhur Zoti im, ndërsa toka do të bëhet fushë e shkretë, nuk do të shohësh në të as lugina, as brigje!»” (TaHa, 105-107.)

Ndërsa në këto ajete fisnike na bëhet e ditur gjendja e njerëzve në të dyja fryrjet e Surit:

“Kur do t'i fryhet Surit, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do Allahu; pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin.” (Zumer, 68.)

“Ditën kur do të dridhet gjithçka nga ushtima (që lajmëron Kiametin), e cila do ta ndiqet nga një e dytë, disa zemra do të jenë të mbushura me tmerr e shikimet e tyre do të bien përdhe.” (Naziat, 6-9.)

Padyshim, dita kur t'i fryhet Surit, do të jetë më e tmerrshme për jetën e kësaj bote. Foshnjat do të kthehen në pleq të thinjur për shkak të tmerrit të asaj dite. Lidhur me këtë Allahu i Madhëruar lajmëron:

“Qysh do të mbroheni ju, nëse mbeteni jobesimtarë, Ditën në të cilën fëmijët do të thinjen? Atë ditë qielli do të çahet e premtimi i Zotit do të



përmushet.” (Muzzemmil, 17-18.)

Por do të ketë edhe njerëz, të cilët do të jenë nën mbrojtjen e Allahut atë ditë të tmerrshme dhe do të jenë të sigurt prej hidhërimit dhe frikës. Lidhur me këtë, në Kuran sqarohet:

“Dhe Ditën kur të fryhet në Sur, do të tmerrohet çdokush që gjendet në qiej e në Tokë, përveç atyre që Allahu nuk dëshiron t’i frikësojë. Të gjithë do t’i vijnë Atij të përlulur.” (Neml, 87.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“E si mund të gëzohem e të kënaqem me mirësitë, ndërkohë që meleku përgjegjës e ka marrë surin në dorë dhe është duke pritur t’i fryjë atij menjëherë, sapo të vijë urdhri!”

Kjo gjendje iu duk tepër e rëndë sahabëve. Prandaj i Dërguari i Allahut, (a.s.) iu këshilloi:

“Thoni kështu: «Allahu i Madhëruar na mjafton, Ai është mbrojtësi më i mirë. Ne mbështetemi tek Allahu!»” (Tirmidhi, Kijamet, 8/2431; Ahmed, I, 326.)

BATH (RINGJALLJA)

Ringjallja, e cila do të ndodhë ditën e Kiametit, do të fillojë me fryrjen për herë të dytë të Surit nga ana e Israfilut (a.s.). Pra, me fryrjen për herë të dytë të surit, do të ringjallen të gjitha gjallesat që kanë qenë krijuar në këtë botë të përkohshme. Kjo quhet *“Ba’thu ba’de’l-meut”*, domethënë *“ringjallja pas vdekjes”*.

Ebu Hurejre (r.a.) e ka pyetur Profetin (a.s.), se sa kohë do të kalojë midis dy fryrjeve të Surit dhe ai i ka thënë *“dyzet”*.

Pasi Ebu Hurejre (r.a.) e përmendi këtë thënie të Profetit, sahabët e pyetën:

“O Ebu Hurejre! Dyzet ditë?”

“S’mund të them gjë!” – Iu përgjigj ai.

“Dyzet vjet?” – E pyetën sahabët.

“S’mund të them gjë!” – tha përsëri ai.

“Dyzet muaj?” – E pyetën sërish sahabët.

“S’mund të them gjë!” – tha sërish Ebu Hurejre (r.a.) dhe pastaj e plotësoi hadithin deri në fund:

“Allahu do të lëshojë ujë nga qielli dhe njerëzit do të mbijnë nga toka siç mbijnë perimet dhe bimët. Përveç një kocke, i gjithë trupi i njeriut kalbet e humbet. Kjo kockë që nuk kalbet është “axhbu’dh-Dheneb”, kocka e kërbishtit. Prej kësaj kocke do të fillojë edhe ringjallja ditën e Kiametit.” (Buhari, Tefsiru Sure 39/3; Muslim, Fiten, 141; Muuatta, Xhenaiz, 48; Ebu Daud, Sunnet, 24; Nesai, Xhenaiz, 117.)

Në disa transmetime bëhet e ditur se koha midis dy fryrjeve të Surit është dyzet vjet¹, gjë të cilën e kanë pranuar edhe shumica e dijetarëve.²

Sipas mufesirit dhe dijetarit të gjuhës, Ferras:

“Njerëzit dhe të gjitha krijesat do të vdesin me Surin e parë. Ndërmjet tij dhe Surit tjetër do të kalojnë dyzet vjet. Në këtë kohë Allahu i Madhëruar do të dërgojë një shi, i cili do të bierë në formë viskoze, si “uji” i mashkullit, dhe njerëzit do të mbijnë në varret e tyre ashtu si zhvillohen në barkun e nënës. Kjo është faza për të cilën aludohet edhe në këtë ajet fisnik:

“...po kështu do t’i ringjallë edhe të vdekurit...” (A’raf, 57.)

Domethënë, ashtu siç i nxjerrim bimët prej një vendi të vdekur, ashtu do t’i nxjerrim edhe të vdekurit nga varri.³



(Neml, 87.)

1. Ibn-i Mende, Ebu Abdullah Muhammed b. Is'hak b. Muhammed b. Jahja el-Abdi (v. 395.), *el-Iman* (I-II), Verifikuar nga Ali. B. Muhammed b. Nasir el-Fakih, Bejrut: Muessesetu’r-Risale, 1406, II, 794; Bejhaki, Shuabu’l-Iman, I, 541.

2. Gazali, Ebu Hamid Muhammed b. Muhammed (v. 505.), *ed-Durretu’l-Fahire fi Keshfi Ulumi’l-Ahire* (Në brendësi të *Mexhmuatu Resaili’l-Imam el-Gazali*), Bejrut: Daru’l-Kutubi’l-Ilmijje, 1409, fq. 118; Begau, VII, 132; Kurtubi, *et-Tedhkire*, I, 287; Sujuti, *el-Buduru’s-Safire*, fq. 86-88; Bebek, “Sur” md., DIA, XXXVII, 534.

3. Ferra, I, 382. Edhe Taberiu përmend të njëjtin transmetim pa zinxhir. Transmetohet se në hadithin e përcjellë prej tij, ky lloj shiu quhet “Mau hajeuan”. (Taberi, XII, 493-494.) shih. Ibn-i Ebi Hatim, VIII, 2784; Bejhaki, Shuab, I, 541; Ebu Hajjan, V, 79.

Në transmetimet sahih, është bërë e ditur se Allahu i Madhëruar do të lëshojë një shi nga qielli dhe me të do t’i rikrijojë të vdekurit njësoj siç i rrit bimët. (Buhari, Tefsir, 78/1.) Mirëpo, transmetimet në lidhje me përbërjen e këtij shiu janë të dobëta.

Në Kuranin Fisnik, Allahu iu drejtohet atyre që kanë dyshime në lidhje me faktin se si do të realizohet ringjallja:

“O njerëz, nëse ju dyshoni në ringjalljen, mendoni si Ne ju kemi krijuar prej dheut, pastaj prej pikës së farës, pastaj prej droçkave të gjakut, pastaj prej një cope mishi me trajtë të plotë ose jo të plotë, për t’jua bërë të qartë! Dhe Ne e mbajmë në mitër atë që duam deri në kohën e caktuar. Pastaj ju nxjerrim si fëmijë e pas kësaj do të arrini moshën e pjekurisë. Disa nga ju vdesin e disa ngelin deri në pleqëri të thellë, që të mos dinë asgjë nga ajo që kanë ditur më parë. Dhe ti e sheh tokën të tharë, por, kur Ne lëshojmë ujë mbi të, ajo trazohet dhe gufon dhe prej saj mbijnë gjithfarë lloj bimësh të mrekullueshme në çift.

Kjo ndodh (që ta dini) se Allahu është e Vërteta, se Ai i ringjall të vdekurit, se Ai është i Fuqishëm për çdo gjë, se Ora (e Kiametit) do të vijë, gjë për të cilën s’ka dyshim dhe se Allahu do t’i ringjallë ata që janë në varre.” (Haxh, 5-7.)

Ndërsa në suren Mu’minun tregohen fazat mesimdhënëse që kalon njeriu nga jeta në barkun e nënës, në jetën e dynjasë, vdekjen dhe ringjalljen pas saj:

“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës, e pastaj, e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër). Më pas, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë; mandej, me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe pastaj e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin). Qoftë lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur!

Mandej, pas kësaj ju do të vdisni, pastaj, ju me siguri që do të ringjalleni në Ditën e Kiametit.” (Mu’minun, 12-16.)

Këto të vërteta, për të cilat na ka njoftuar Allahu i Madhëruar, shprehen kështu edhe në një bisedë midis Profetit tonë (a.s.) dhe Ebu Rezin-it (r.a.):

Ebu Rezin el-Ukajdi (r.a.) tregon:

Një ditë e pyeta të Dërguarin e Allahut, (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Si i ringjall Allahu i Madhëruar krijesat? A ka ndonjë shembull në këtë botë?”

Ndërsa ai u përgjigj:

“A nuk ke kaluar ndonjëherë në kohën e thatësisirës në luginën ku jeton populli yt? Më pas, a nuk ke

kaluar përsëri në kohën e verës kur çdo anë është e gjelbëruar?”

“Sigurisht!” – u përgjigja unë.

“Ja pra, ky është shembulli se si e kryen Allahu ringjalljen. Kështu do t’i ringjallë Allahu edhe të vdekurit!”- tha ai (s.a.u.s.) (Ahmed, IV, 11.)

Ndërsa tronditja dhe pendimi i madh që do të ndjejnë mohuesit e botës tjetër kur të ringjallen, shprehet në këtë mënyrë në këto ajete fisnike:

“Ai (zëri i bririt të ringjalljes) do të jetë një zë i vetëm dhe të gjithë (mohuesit e ringjallur) do të shohin (se ç’do të bëhet me ta) dhe do të thonë: «Mjerë për ne, kjo është Dita e Gjykimit!» Po, kjo është Dita e Gjykimit, të cilën ju e keni përgënjeshtuar!” (Saffat, 19-21.)

“Me sy të përulur do të dalin nga varret, sikur të ishin karkaleca të shpërndarë, duke shpejtuar drejt Lajmëtarit. Atëherë, mohuesit do të thonë: «Kjo është ditë e vështirë!»” (Kamer, 7-8.)

E në fakt, ata e konsideronin si gënjeshtër jetën e Ahiretit dhe pandehnin se jeta e tyre ishte vetëm ajo që bëjnë në dynja. Lidhur me këtë, Kurani Fisnik shprehet:

“Ata thonë: «Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron». Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu.

Kur atyre u lexohen shpalljet Tona të qarta, argumenti i tyre i vetëm është: «Ringjallni të parët tanë, nëse thoni të vërtetën!» Thuaju:

«Allahu jua jep jetën, pastaj ju bën të vdisni e mandej do t’ju tubojë në Ditën e Kiametit, e për këtë nuk ka kurrfarë dyshimi; por shumica e njerëzve nuk e dinë».” (Xhathije, 24-26.)

Ubej ibn Halef ishte një prej armiqve të betuar të Islamit dhe e mohonte kategorikisht ringjalljen pas vdekjes. Njëherë, ai mori një kockë të kalbur nga toka dhe duke e shkërmoqur me dorë, u kthye nga Profeti ynë (a.s.) dhe në një mënyrë tallëse tha:

“Ti beson se Allahu do t’i ringjallë këto kocka të kalbura?”

I Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Po, Allahu do të ringjallë ty dhe do të fusë në Xhehenem!” (Kurtubi, el-Xhami, XV, 58; Uahidi, fq. 389.)

Pas kësaj ngjarjeje zbritën këto ajete:

“A nuk sheh njeriu se si Ne e krijuam atë prej pikës së farës, e megjithatë ai bëhet kundërshtar i hapët?! Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet dhe thotë:

**«Kush do t’i ngjallë eshtrat kur të kalben?»
Thuaj:**

«Do t’i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë!» (JaSin, 77-79.)

Allahu i Madhëruar, në fillim të sures Kijame, na e bën të qartë se për Të nuk është aspak e vështirë t’i ringjallë njerëzit pasi të vdesin:

“Betohem në Ditën e Kiametit!” (Kijame, 1.)

“Betohem në shpirtin qortues!” (Kijame, 2.)

“A mendon njeriu se nuk do të mund t’i mblehim eshtrat e tij?!” (Kijame, 3.)

“Po, si jo! Ne jemi të Zotë t’ia ribëjmë bashkë me përsosmëri edhe majat e gishtave⁴ të tij.” (Kijame, 4.)

Ndërsa në suren Lukman, Zoti ynë i Madhëruar urdhëron:

“Krijimi dhe ringjallja e ju të gjithëve është njësoj si krijimi i një njeriu të vetëm. Vërtet, Allahu i dëgjon dhe i sheh të gjitha.” (Lukman, 28.)

Padyshim se, krijimi për herë të parë është një argument edhe për krijimin për herë të dytë, sepse të krijosh nga asgjëja është më e vështirë se të asgjësosh atë që ekziston dhe ta ringjallësh. E të pranosh të vështirën, ndërkohë që pretendon se më e lehta është e pamundur, nuk është aspak e logjikshme. Për më tepër, Allahu i Madhëruar, i Cili ka dije dhe fuqi të pakufishme, nuk ka shfaqur asnjë lloj dobësie apo pamundësie në krijimin e parë, por ka krijuar krijesa të panumërta, ku secila prej tyre është një krijim më vete.

Allahu i Madhëruar i pyet kështu robërit e Tij:

“Vallë, a mos u lodhëm Ne gjatë krijimit të parë? Jo, por ata dyshojnë në krijimin e sërishëm.” (Kaf, 15.)

Gjendja e birit të njeriut, kur të ringjallet e të ngrihet nga varri, përshkruhet kështu në ajetet fisnike:

4. Dega shkencore e daktiloskopisë, e cila studion gjurmët e gishtave, ka zbuluar se gjurmët e gishtave të njeriut, qëndrojnë të njëjta dhe të pandryshueshme gjatë gjithë jetës. Gjithashtu, gjurmët e gishtave të një njeriu nuk ngajnë aspak me ato të cilido njeriu tjetër. Për këtë shkak, në polici dhe në drejtësi, identifikimi më i sigurt i personave, bëhet me anë të gjurmëve të gishtave. Ky zbulim, është bërë në fund të shekullit të 19. dhe prej atëherë, njerëzimi ka filluar të përfitojë prej kësaj mirësie. Mirëpo, Kurani Fisnik, na e ka tërhequr vëmendjen në këtë të vërtetë që katërmbëdhjetë shekuj më parë, duke shfaqur kështu një mrekulli më vete. Dhe ky është vetëm një prej shembujve të panumërt që tregon se Kurani është gjithmonë në krye, ndërsa shkencat pozitive i vijnë nga pas duke e interpretuar dhe vërtetuar.

“Dhe, kur të fryhet në Sur, ata do të dalin nga varret dhe do të nxitojnë drejt Zotit të tyre, duke thënë: «Mjerë ne! Kush na ngriti prej varreve tona?»⁵ (Atëherë do t’u thuhet):

“Ja, kjo është ajo që ka premtuar i Gjithëmëshirshmi; të dërguarit kanë thënë të vërtetën!” (JaSin, 51-52.)

“Ditën, në të cilën do të dalin nga varrezat duke vrapuar, sikur të ishin duke nxituar drejt një altari, me shikim të frikësuar e të kapluar nga poshtërimi. Ajo është Dita që u është premtuar atyre!” (Mearixh, 43-44.)

“Atë Ditë, toka do të hapet e ata do të dalin me nxitim. Për Ne është e lehtë t’i mbledhim ata të gjithë.” (Kaf, 44.)

“Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse, Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta?!” (Adijat, 9-11.)

Tmerri dhe mjerimi i asaj dite përshkruhet kështu në Kuran:

“Kur të fryhet në Sur (Ditën e Ringjalljes), atëherë, midis tyre nuk do të ketë lidhje farefisnore dhe ata as që do të pyesin për njëri-tjetrin.” (Mu’minun, 101.)

“Por, kur të vijë Ushtima, atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t’i mjaftojë.” (Abese, 33-37.)

Nëna jonë, Aishja (r.a.), transmeton:

“Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

«Ditën e Gjykimit njerëzit do të ringjallen të zbatshur, të zhveshur dhe të pabërë sunet.» (E habitur) I thashë:

«O i Dërguari i Allahut! Meshkujt dhe femrat bashkë, të shikojnë njëri-tjetrin!?»

Ai tha:

«Oj Aishe! Situata do të jetë aq e tmerrshme, saqë askujt nuk do t’i bjerë ndërmend të shikojë tjetrin.» (Buhari, Rikak, 45; Muslim, Xhennet, 56.)

Po ashtu, siç na bëhet e ditur edhe në një hadith tjetër, kur të vdekurit të ringjallen, të parit që do t’i vishen rrobat, do të jetë Ibrahim (a.s.).⁶ Më pas, do t’i vishen Profetit tonë (a.s.). Pas kësaj, Profeti

5. Mendimet e mufesirëve në lidhje me këtë çështje janë si më poshtë:

a. Këtu, vdekja është krahasuar me gjumin, sepse në të dyja gjendjet nuk ka lëvizje. Për shkak të tmerit të asaj dite, mendja e njeriut do të hutohet dhe ata mund ta kujtojnë veten në gjumë.

b. Kur të kuptojnë gjendjen pas jetës së varrit dhe tmerrin e dënimit të Xhehenemit, varri do t’u duket si gjumë në krahasim me to. Prandaj edhe mund të thonë ashtu. (shih. Alusi, Ruhul-Meani, XII, 31.)

6. shih. Buhari, Enbija, 8.

ynë (a.s.) do të qëndrojë në anën e djahtë të Arshit, vetëm. Për këtë arsye, atë do ta kenë zili edhe të mëparshmit, edhe të mëvonshmit.

Allahu i Madhëruar do t'i mbledhë të gjitha pjesët e trupit të njeriut në një vend dhe duke iu kthyer shpirtrat, do t'i nxjerrë të vdekurit nga varret. Për njerëzit, që sapo janë rikrijuar, do të fillojë një jetë që nuk do të ketë fund.

Ditën e Kiametit, njeriu që do të ringjallet dhe do të dalë i pari nga varri, është Profeti ynë (a.s.).⁷

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), kishte hyrë në xhami. Në njërin krah të tij qëndronte Ebu Bekri (r.a.), ndërsa në tjetrin Omeri (r.a.). Profeti ynë (a.s.) u kapi duart dhe u tha:

“Ja, kështu do të ringjallemi ditën e Kiametit.” (Tirmidhi, Menakib, 16/3669.)

SHEMBUJT E RINGJALLJES NË KURANIN FISNIK

Edhe pse ka pasur diskutime në lidhje me çështjen nëse ringjallja do të jetë me trup apo me shpirt, në Kuranin Fisnik gjenden shumë ajete të cilat tregojnë se ringjallja do të jetë me trup. Pra, Allahu i Madhëruar do t'ia kthejë shpirtin çdo njeriu dhe do t'i ringjalli me trup.

Me qëllim që të forcojë zemrat e besimtarëve, në lidhje me faktin se ringjallja pas vdekjes është e vërtetë dhe se për Të kjo nuk është aspak e vështirë, Allahu i Madhëruar ka ringjallur disa krijesa që në jetën e kësaj bote dhe shembujt e tyre i ka përmendur në Kuranin Fisnik:

a) Ringjallja e shpendëve të copëtuar:

Në Kuran sqarohet:

“Ibrahimi tha:

«O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!» – Zoti i tha:

«A nuk beson?»

«Besoj!» - iu përgjigj Ibrahim, «por dëshiroj të më qetësohet zemra.» Allahu i tha:

«Merr katër zogj dhe copëtoji. Shpërnda në çdo kodër nga një copë prej tyre pastaj thirri! Ata do të të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dish se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.» (Bekare, 260.)

Sipas transmetimit, Allahu i Madhëruar e urdhëroi Ibrahim (a.s.) të priste katër shpend, t'ua hiqte puplat dhe t'ua ndante mishin në copa. Më pas, e urdhëroi që t'i mbante kokat e tyre, ndërkohë që pjesët e trupave të tyre duhet t'i vendoste në majën e çdo kodre.

Po sipas transmetimeve, thuhet se Ibrahim (a.s.) zuri një pallua, një gjel, një korb dhe një shqiponjë.

Çdonjërin prej tyre e ndau në katër pjesë, i përzjeu mirë e mirë me njëri-tjetrin (si brumë) dhe vendosi në çdo majë kodre nga një pjesë të përzierjes. Më pas, i thirri: *“Ejani tek unë me lejen e Allahut!”*. Pas kësaj, çdo pjesë e tyre fluturoi drejt pjesëve të tjera të ngjashme, duke formuar nga një trup të vetëm, secili më pas u bashkua me kokën përkatëse dhe morën formën e tyre origjinale.⁸

Thuhet se fakti që Ibrahim (a.s.) i vuri pjesët e shpendëve në majat e kodrave, tregon se rreth tij ka pasur edhe një grup të madh njerëzish. Domethënë, urdhri për t'i vendosur pjesët e shpendëve në majat e kodrave, ka qenë me qëllim që ato të shihen lehtë nga njerëzit e tjerë. Po ashtu, thuhet se kjo ngjarje ka ndodhur si pasojë e lutjes së Ibrahimit (a.s.), i cili kërkoi prej Allahut të Madhëruar një mrekulli për t'u dhënë argumente të qarta atyre që e mohonin ringjalljen në botën tjetër.

Siç dihet, Ibrahim (a.s.) është një prej profetëve të mëdhenj. Prandaj është e pamundur të mendohet se ai ka pasur ndonjë dyshim në lidhje me çështjen e ringjalljes së të vdekurve nga Allahut i Madhëruar. Po ashtu, edhe Allahu i Madhëruar e dinte se Ibrahim (a.s.) ishte besimtar i devotshëm. Mirëpo, me qëllim që të dihet nga të gjithë se çfarë donte të thoshte Ibrahim (a.s.) me frazën: **“O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!”**, e pyeti atë: **“A nuk beson?”**. Ndërsa Ibrahim (a.s.), ashtu siç bëhet e ditur edhe në ajetin fisnik, shprehet se ai kërkoi diçka të tillë prej Allahut të Madhëruar, me qëllim që besimi i tij të ngrihej në gradën “hakka'l-jakin”⁹ dhe zemra e tij të qetësohej, duke e parë me sytë e vet të vërtetën hyjnore. E në fakt, dihet se kur njeriu e sheh me sytë e vet diçka që e beson, besimi i tij bëhet edhe më i fortë e i palëkundur.

Nga ana tjetër, është e qartë se Ibrahim (a.s.) e ka shprehur këtë dëshirë, me qëllim që zemra e tij të arrinte qetësinë dhe sigurinë e plotë në lidhje me faktin se ai ishte “mik i Allahut”.

Përveç këtyre, nga ky ajet fisnik del në pah e vërteta se, çfarëdo pozite shpirtërore të arrijë një njeri, ai ka ende rrugë për të bërë drejt përsosmërisë së besimit dhe qetësisë së zemrës. Edhe Ibrahim (a.s.), për të cilin lajmërohem në Kuran se ka qenë prej profetëve të mëdhenj (Ulu'l-Adhm) dhe mban-te titullin “Halilullah/Mik i Allahut”, duke gëzuar edhe plot lavdërime të tjera, i është lutur Allahut të Madhëruar që t'i shtohet qetësia dhe siguria e zemrës.

Një gjë është e sigurt: aq sa shtohet afërsia e njeriut me Allahun e Madhëruar, aq shtohet edhe horizonti i tij në botën e zemrës. Ai e kupton edhe

8. shih. Taberi, Xhamiu'l-Bejan, III, 81-82.

9. Besim i mbështetur në dijen e përjetuar dhe të ndjerë me të gjitha shqisat. Dije e sigurt dhe pa asnjë fije dyshimi.

7. shih. Darimi, Mukaddime, 8; Tirmidhi, Menakib, 1/3616.

më qartë dobësinë e tij, nevojën, mangësinë dhe të qenit asgjë karshi Allahut. Prandaj, edhe Ibrahim (a.s.), në kuadër të këtyre ndjesive, iu lut Allahut duke thënë:

“Dhe mos më turpëro Ditën kur do të ringjallen njerëzit, Ditën kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, e as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Shu’ara, 87-89.)

Në lidhje me ajetin në të cilin Ibrahim (a.s.) kërkon prej Allahut të shohë ringjalljen e të vdekurve, në tefsirin “Letaifu’l-Isharat” të Imam Kushejrit thuhet:

“Ibrahim (a.s.) me këtë lutje ndaj Allahut, ka kërkuar ringjalljen e zemrës. Ndërsa Allahu i Madhëruar i ka bërë të ditur se zemra e tij duhet t’i shkëpusë lidhjet me gjërat e tjera. Nisur nga kjo, me katër shpendët që copëtoi Ibrahim (a.s.), aludohen katër cilësi të këqija që ka nefsi/egoja. Pailloj përfaqëson zburimin, korbi përfaqëson dëshirat e pafundme, gjeli përfaqëson epshin, ndërsa shqiponja përfaqëson lakminë. Për rrjedhojë, ata që nuk i presin fytyrën këtyre cilësive negative të egos, me anë të përpjekjes dhe edukimit shpirtëror, nuk mund të arrijnë ringjalljen e zemrës (vetëm) me vëzhgim.” (Kushejri, “Letaifu’l-Isharat”, I, 121.)

b) Ringjallja e atyre që vdiqën nga goditja e rrufesë:

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Kujtoni kur i thatë Musait:

«O Musa! Ne nuk do të të besojmë ty, derisa të shohim Allahun haptazi!».

Atëherë një rrufe ju goditi, ndërsa ishit duke parë. Pas vdekjes suaj, Ne ju ringjallëm, që të bëheni falënderues.” (Bekare, 55-56.)

Siç kuptohet edhe prej ajeteve, disa persona prej popullit të Musait (a.s.) deklaruan se nuk do ta besonin profetin, pa e parë Allahun haptas, dhe Allahu i Madhëruar i goditi ata me rrufe. Më pas Allahu i ringjalli personat që vdiqën nga goditja e rrufesë, duke i bërë ata vetë dëshmi të gjallë të fuqisë së Allahut dhe të madhështisë së Tij. Pra, edhe kjo ndodhi që na rrëfëhet në Kuranin Fisnik, ka si qëllim sqarimin e atyre që mohojnë ringjalljen, në lidhje me thjeshtësinë me të cilën Allahu i Madhëruar e realizon diçka të tillë. Madje, dihet mirë se për t’i treguar fuqinë e Allahut atyre që e mohojnë ringjalljen në botën tjetër, janë dhënë edhe shembujt

e Isait (a.s.), i cili shfaqti mrekullinë e ringjalljes së të vdekurve, dhe të As’habi Kehf-it, të cilët u zgjuan pasi u mbajtën në gjumë për treqind e ca vite.

c) Ringjallja e atij që qëndroi njëqind vjet i vdekur:

Një nga çështjet për të cilën idhujtarët e kundërshtonin më shumë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), ishte ringjallja e të vdekurve. Ata nuk donin ta pranonin këtë të vërtetë, për shkak të egos së tyre, por edhe për shkak se nuk arrinin ta kuptonin se si do të ngjallehin përsëri trupat e kalbur ose ata që nuk ekzistonin më. Mirëpo, Allahu i Madhëruar i shpalli Profetin tonë (a.s.) shumë ajete të cilat do t’i eliminonin këto mendime të idhujtarëve. Me anë të shumë shembujve, Ai e ka shpjeguar qartë në Kuranin Fisnik të vërtetën e ringjalljes pas vdekjes. Një prej këtyre shembujve, është edhe ai i njeriut, në kohën e Uzejrit (a.s.), i cili u ringjall pasi qëndroi i vdekur për njëqind vjet. Në Kuran urdhërohet:

“(A nuk ke dëgjuar) Për atë i cili, kur kaloi pranë një qyteti të rrënuar përtokë, tha:

«Si mund ta kthejë në jetë Allahu këtë qytet tani që ai është i vdekur?!» Dhe Allahu e vdiq atë për njëqind vjet e pastaj e ringjalli dhe e pyeti:

«Sa kohë ke ndenjur këtu?» - Ai u përgjigj:

«Një ditë ose gjysmë dite.»

«Jo!» - i tha Allahu, «por ke ndenjur njëqind vjet. Shiko ushqimin dhe pijen tënde që nuk janë prishur! Shikoje gomarin tënd (si do ta ringjallim) që të të bëjmë ty dëshmi mrekullie për njerëzit; vështroji eshtrat se si i bashkojmë e pastaj i veshim me mish!»

Kur atij iu bë e qartë, ai tha:

«Tashmë e di se Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë!» (Bekare, 259.)

Në disa tefsirë thuhet se ky person ka qenë vetë Uzejri (a.s.), i cili kur arriti në një qytet të rrënuar, banorët e së cilit kishin vdekur e ishin zhdukur, filloi të mendonte me vete se si do t’i ringjallte Allahu të vdekurit. I zhytur në këto mendime, Allahu i Madhëruar ia merr jetën dhe ia kthen përsëri pas njëqind vjetësh. Kur u ringjall, ai pandehte se kishte fjetur për një kohë të shkurtër dhe ishte zgjuar, sepse ushqimet e tij nuk ishin prishur ende. Mirëpo, kur ai pa gomarin e vet, e kuptoi se ai kishte kohë që kishte ngordhur, sepse atij i kishin mbetur vetëm

**“Ja pra,
vëllezërit e mi në Ditën
e Gjykimit do të vijnë me
fytyrë, duar dhe këmbë të
shndritshme, për shkak se kanë
marrë abdest. Unë do të shkoj
para tyre në krye të hauzit (të
Keutherit) dhe do t’i pres
që t’u jap ujë!..”**



kockat që po i shkërmoqeshin. Pas kësaj, Allahu i Madhëruar e ringjalli gomarin para syve të tij, në mënyrë që ai të dëshmonte personalisht se si Allahu ua merr jetën robërve dhe i ngjall ata përsëri.

HAUZI

Thuhet se njerëzit do të dalin nga varret e tyre të etur dhe për të shuar etjen do të vrapojnë me një frymë drejt “hauzit” që ndodhet në sheshin e madh të Mahsherit. Mirëpo, jo të gjithë do të mund të arrijnë atje.

Në një hadith fisnik bëhet e ditur se, ata të cilët i kanë kthyer shpinën besimit në jetën e dynjasë dhe kanë hyrë në rrugë të devijuara, do të pengohen nga pirja e ujit të hauzit:

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), shkoi tek varrezat dhe tha:

“*Selam ju qoftë o banorët myslimanë të këtij vendi! InshaAllah, një ditë edhe ne do të vijmë pranë jush.*” (Pasi përshëndeti banorët e varreve) Tha:

“*Sa kisha dashur t’i shihja vëllezërit e mi!*” Sahabët pyetën të habitur:

“A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguari i Allahut?”

Profeti (a.s.), u përgjigj:

“*Ju jeni shokët e mi të ngushtë, vëllezërit e mi akoma nuk kanë ardhur në jetë.*”

Sahabët pyetën përsëri:

“Si do t’i njihni Ditën e Gjykimit ata që akoma nuk kanë ardhur në këtë jetë, o i Dërguari i Allahut?”

Mirëpo, Profeti (a.s.) i pyeti:

“*Mendoni një njeri që ka një kalë me ballë dhe këmbë të bardha! A nuk e njeh ky njeri kalin e tij në mesin e një tufe me kuaj të zinj?*”

Sahabët pohuan:

“Po o i Dërguari i Allahut, e njeh!”

Pas kësaj, Profeti (a.s.) vazhdoi:

“*Ja pra, vëllezërit e mi në Ditën e Gjykimit do të vijnë me fytyrë, duar dhe këmbë të shndritshme, për shkak se kanë marrë abdest. Unë do të shkoj para tyre në krye të hauzit (të Keutherit) dhe do t’i pres që t’u jap ujë!*”

Kini kujdes! Disa njerëz do të dëbohen nga hauzi im, ashtu siç dëbohen devetë e huaja nga tufa. Kurse unë do t’i thërras ata: «Ejani këtu!». E mua do të më thuhet:

«*Ata devijuan nga rruga jote dhe morën rrugë të tjera!*»¹⁰

Për këtë arsye, unë do të them:

«*Qofshin larg, qofshin larg!*» (Muslim, Taharet, 39, Fedail, 26.)¹¹

Nga ky rrëfim kuptohet se prej ujit të Hauzit do të pinë vetëm ata që do të arrijnë atje. Ndërsa ata që nuk do të pinë prej hauzit, janë ata që nuk do të kalojnë dot as urën e Siratit.

Në një hadith fisnik, Profeti (a.s.) e ka përshkruar hauzin në këtë mënyrë:

“*Hauzi im është i madh sa një muaj ecje. Uji i tij është më i bardhë se qumështi dhe aroma e tij është më e këndshme se misku. Ndërsa gotat janë të shumta sa yjet në qiell. Kush pi prej tij, nuk e merr më etja përjetësisht.*” (Buhari, Rikak, 53; Muslim, Fedail, 27.)

Ai që nuk arrin të pijë ujë prej atij hauzi, do të jetë përjetësisht i etur.

Sipas transmetimeve mësojmë se i pari që do të arrijë tek hauzi do të jetë Profeti ynë (a.s.), i cili do të përgatitet që të gostisë ummetin e tij me ujë.¹² Ndërsa njerëzit që do të arrijnë të parët tek hauzi, janë të varfrit prej muhaxhirëve.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“*(Ditën e Kiametit) Çdo profet ka hauzin e tij dhe çdonjëri prej tyre krenohet dhe gëzohet karshi të tjerëve me numrin e shumtë të njerëzve që vijnë tek hauzi i tyre. Unë shpresoj të jem profeti të cilit i vijnë më shumë njerëz tek hauzi!*” (Tirmidhi, Kiamet, 14/2443.)

Për rrjedhojë, me qëllim që të mos e zhgënjejmë Profetin tonë (a.s.), ne duhet ta ndjekim sunnetin e tij me kujdes dhe respekt të madh, dhe duhet të përpiqemi të motivojmë edhe njerëzit e tjerë përreth nesh, që të jetojnë në këtë rrugë.

10. Thuhet se këta janë një numër i vogël beduinësh, të cilët e lanë fenë pasi i dhanë besën të Dërguarit të Allahut. Në një hadith tjetër, thuhet: “...*Mua më thuhet: «Pasi u ndave prej tyre, ata u kthyen pas mbi thembrat e tyre dhe që prej asaj dite vazhduan në irtidad (lënie të fesë)!»* (Muslim, Xhennet, 58.)

Lidhur me njerëzit që nuk do të arrijnë dot tek hauzi, ka mendime të ndryshme. Këto mendime janë si më poshtë:

1. Hipokritët dhe murtedët (lënësit e fesë).

2. Ata që kanë jetuar në kohën e Profetit tonë (a.s.) dhe që pas vdekjes së tij kanë braktisur fenë.

3. Ata që kanë kryer gjynahe të mëdha.

4. Ata që kanë ndjekur medh’hebe me besim të gabuar dhe janë marrë me bid’ate. (Sujuti, ed-Dibaxh ala Sahihi Muslim ibn-i Haxhxhaxh, Daru Ibn-i Affan, 1416, II, 43.)

5. Njerëzit e këqij. Pra, ata që nuk e kanë lënë fenë, por janë marrë me punë të këqija. (Neueui, Sherhu Sahihi Muslim, XV, 64.)

11. shih. Nesai, Taharet, 110/150; Ibn-i Maxhe, Zuhd, 36; Muuatta, Taharet, 28; Ahmed, II, 300, 408.

12. shih. Muslim, Fedail, 25-45; Tirmidhi, Kiamet, 15/2444; Ibn-i Ma - he, Zuhd, 36; Ahmed, V, 275; Hejthemi, X, 360-367.

Foshnja që frikësohej nga lindja!

— Ferudun Ozdemir —

Imagjinoni një foshnje në barkun e nënës që ka frikë të lindë e të jetojë në këtë botë.

Përfytyroni sikur t'i thuhej: Mos u frikëso! Mos u shqetëso! Lindja nuk është diçka e keqe.

Ai që të krijoi do të të mbajë këtu në barkun e nënës për një kohë të shkurtër.

Një vend më i mirë nga kjo hapësirë e errët dhe e ngushtë, po pret për ty.

Një botë plot dritë!

Aty ka male të larta, dete të mëdha, fusha të harlisura, re fluturuese dhe erëra që fryjnë.

Ka kopshte të stolisura më mijëra lule shumëngjyreshe, pemë dhe fruta me shije, aromë, ngjyra e forma që do të të mahnisin nga bukuritë e tyre.

Do gjesh bletë që të dhurojnë mjaltë, kafshë që të dhurojnë qumësht të bardhë si bora, flutura që të magjepsin me bukurinë dhe hijeshinë e tyre e zogj që thurin melodi vetëm për ty.

Do shohësh diellin të varur në qiell që lind vetëm për të të ndriçuar dhe ngrohur ty.

Do gjesh një nënë dhe baba që presin me shumë mall e dashuri për të të përqaftuar dhe për të të lumturuar.

Do të gjesh fëmijë të tjerë që mezi presin të luajnë me ty e miq të mirë më të cilët do ndash çdo gjë tënden.

Mendoni sikur t'i thuhej: “Mos u shqetëso! Të gjithë këto mirësi do jenë tuat, vetëm prit edhe pak se ti shumë shpejt do jesh pjesë e kësaj bote.”, foshnja vështirë do besonte për ekzistencën e një bote që kurrë më herët nuk e ka parë.

Por sikur foshnja t'i kushtonte pak më shumë vëmendje trupit të tij, do gjente prova të mjaftueshme për ekzistencën e një bote të quajtur: Dynja!

Trupi i tij vazhdimisht në rritje që herët kishte filluar t'i tregonte se tashmë ai nuk mund të jetonte më në këtë botë të errët dhe të ngushtë.

Sytë çdo ditë në rritje e lajmëronin për ekzistencën e ngjyrave, veshët për praninë e zërave, këmbët i tregonin që një ditë do ishte i zoti të ecte mbi këtë tokë, mushkëritë ishin lajmëtarë të ajrit që do thithte, ndërsa goja e stomaku për shijen e ushqimeve të panumërta që do shijonte.

Këto organe nuk mund të ishin dhuruar për t'u përdorur në një vend aq të errët e të ngushtë.

Atëherë përse vallë?

Dhe foshnja mendoi...

Ai që ka më ka krijuar me gjithë këto organe dhe ndenja, natyrisht duhet të ketë krijuar edhe vendin ku do t'i përdor.

Ai zë ishte i vërtetë...

Vërtet ekzistonte një botë e quajtur: Dynja

Ashtu si foshnja që nuk beson në ekzistencën e kësaj bote, o njeri, mos dysho për ekzistencën e botës tjetër, sepse dëshirat e tua të pakufishme janë lajmëtare të ekzistencës së botës tjetër të quajtur: Ahiret!

“Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse arrëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!”

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI



EL-HASIB

“HASBUNALLAH”

— Ilir Hoxha —

Ashtu si çdo Emër i Bukur i Allahut, edhe emri el-Hasib, ka disa kuptime të lidhura me rrënjën e kësaj fjale. Për shembull, “Hisab”, do të thotë, “Ai që njeh dhe llogarit çdo gjë”. (shih. Nisa, 6.) “Haseb”, do të thotë, “i lartë dhe i nderuar”. Ndërsa “Hasb”, do të thotë, “i mjaftueshëm”, fjalë kjo që përdoret saherë që ndodhemi në situata të vështira dhe të pashpresa, duke thënë, “hasbunallahu ue ni’mel uekil / Na mjafton Allahu! Ai është mbrojtësi më i mirë!”

Sipas Imam Gazaliut, kuptimi i emrit Hasib është “mjaftueshmëri” dhe se cilësia “i mjaftueshëm”, i takon vetëm Allahut të Madhëruar, sepse asnjë krijesë në gjithësi nuk është e mjaftueshme vetvetiu për asgjë.

Kuptimi i parë i emrit Hasib, është “të mbash llogari”. Por, kur i atribuohet Allahut, nuk i ngjan aspak mbajtjes së llogarisë që bëjnë njerëzit. Kjo, do thotë se Allahu i Madhëruar e përfshin gjithçka me dijen e vet, mban llogarinë e tyre dhe ia bën të ditur njeriut përfundimin. Si Hasib, Allahu nuk ua çon dëm asnjë punë robërve të Vet dhe ruan të gjitha veprat e tyre. Ai nuk lë asnjë të mirë pa shpërblyer dhe asnjë të keqe pa ndëshkuar. Një argument i qartë i këtij fakti na jepet edhe në ajetin 86 të sures Nisa, ku Allahu i Madhëruar bën të ditur se Ai e shënon edhe se kush jep më bukur selam.

Edhe pse në Kur’anin Fisnik gjenden shumë emra dhe folje që rrjedhin prej rrënjës “h-s-b”, të cilat

i atribuohen Zotit tonë të Madhëruar, emri Hasib që flet për Allahun, përdoret në tre vende. Dihet se në ajetet që përfundojnë me emrat e Allahut, ka një lidhje të jashtëzakonshme të këtyre emrave me temat që trajtohen në ato ajete. Prandaj, për ta kuptuar sadopak thellësinë e kuptimit të secilit prej Emrave të Bukur të Allahut, duhet ta analizojmë me kujdes këtë lidhje. Për shembull, në dy prej tre ajeteve për të cilat folëm më lart, theksohet se Allahu do t’i kërkojë llogari njeriut për të gjitha sjelljet e tij. (shih. Nisa, 6, 86.) Ndërsa në ajetin e tretë, spikat më tepër kuptimi “i mjaftueshëm”. Kështu që, duke filluar prej profetëve, ata që u predikojnë njerëzve urdhrat hyjnorë, nuk kanë frikë prej askujt përveç Allahut, sepse Ai u mjafton si mbrojtës të gjithë atyre. (shih. Ahzab, 39.)

Ndërsa fjala “hasb”, që shpreh kuptimin e të qenit i mjaftueshëm, zë vend ndër ajetet që këshillojnë Profetin (a.s.) dhe besimtarët të ruajnë forcën e tyre shpirtërore kundër veprimtarive tinëzare të mohuesve dhe hipokritëve në dëm të Islamit dhe ndjekësve të tij, që të mos i humbin shpresat dhe të jenë të sigurt se Allahut i Madhëruar do t’i mbrojtë patjetër. Përveç kësaj, në ajetet 2 dhe 3 të sures Talak theksohet se, kur midis bashkëshortëve të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, urdhërohet që palët, sidomos pala e burrit, të sillen me drejtësi dhe ndjenja njerëzore dhe se kush mbështetet tek Allahu, Ai do t’i mjaftojë atij.

Siç e kemi thënë edhe më herët, në një aspekt, Emrat e Bukur të Zotit tonë shprehin mirësi dhe bujari, e në një aspekt tjetër, shprehin paralajmërim dhe kërcënim. Kjo vlen edhe për emrin Hasib, sepse ky emër vepron në favor, ose në disfavorin tuaj kudo që të jeni dhe për çfarëdo që të bëni. Për shembull, në ajetin 6 të sures Nisa, pasi tregohet qartë se si duhet të jetë qasja e kujdestarëve ndaj pasurisë së jetimëve, thuhet se, **“Allahu mjafton si llogaritës”**, duke kërcënuar kështu çdokënd që tenton të bëjë padrejtësi dhe, në të njëjtën kohë, i qetëson zemrat e atyre që u bëhet padrejtësi. Siç shprehet edhe në Kur’an, Allahu është “seriu’l-hisab / i shpejt në llogari” (shih. Bekare, 202; Maide, 4.) dhe “esrau’l-hasibin / më i shpejti i llogaritësve” (shih. En’am, 62.) Allahu i llogarit krijesat e Tij me një shpejtësi të paimagjineshme. Asnjë fjalë apo vepër, madje as qëllimet nuk i shpëtojnë vëmendjes së Tij. Ai di në detaj çdo gjë. Po ashtu, edhe lutja e Profetit (a.s.), **“O Zoti im që je Seriu’l-hisab! Shpartalloi armiqët tanë që janë bashkuar kundër nesh!”** (Buhari, Xhihad, 96.) tregon se kjo cilësi hyjnore, nuk manifestohet vetëm në botën tjetër, por edhe në këtë botë.

Nëse ne arrijmë të themi me bindje të plotë, ashtu siç thuhet edhe në ajetin 6 të sures Nisa, **“Allahu mjafton si llogaritës!”**, atëherë do të kemi shpëtuar prej presionit të çdo llogaritësi tjetër. Kushejri shprehet se ai që i beson plotësisht emrit Hasib, do të fitojë vetëdijen se ditën e kiametit do të merret në llogari për çdo vepër të tij në këtë botë dhe, për këtë arsye, ai e llogarit veten para se të vijë ajo ditë.

Në të njëjtën kohë, Kushejri, qëndron në idenë se kuptimi i emrit Hasib është, “i mjaftueshëm për gjithçka”. Për rrjedhojë, nëse ky emër bëhet pjesë e moralit të një njeriu, Allahu e ruan atë njeri prej lakmisë së kësaj bote dhe e ngre në gradën e atyre që mjaftohen me atë që zotërojnë. Kushejri thotë se nuk ka mirësi më të madhe se kur Allahu i Madhëruar e shpëton dikë nga ndjenja, “e konsiderimit të vetes si i mjaftueshëm” dhe më pas ia plotëson

të gjitha nevojat. Po sipas tij, njeriu që beson me bindje se vetëm Allahu është i mjaftueshëm për gjithçka dhe se do ta bëjë atë të panevojshëm ndaj çdo gjëje tjetër përveç Vetes, nevojat personale ia paraqet vetëm Allahut dhe vetëm tek Ai ndihet i sigurt. Lidhja e kësaj grade besimi me nderin dhe dinjitetin njerëzor, është e qartë në mënyrë të padiskutueshme. Dihet se dëshpërimi më i madh në këtë botë, buron prej ndjenjës së pamjaftueshmërisë. Njeriu që beson se Allahu i mjafton atij në çdo çështje Ai vendos në shpirtin e tij ndjenjën e rehatisë dhe mjaftueshmërisë, e cila e mbron prej lakmisë ndaj gjërave që zotërojnë të tjerët. Në këtë mënyrë ky njeri përjeton një lumturi që buron prej ndjenjës së mjaftueshmërisë, të cilën ai nuk do ta ndërronte me asgjë tjetër në botë.

Nëse e analizojmë në aspektin e komunikimit dhe menaxhimit njerëzor, emri Hasib na tregon rëndësinë që ka regjistrimi, kontrolli dhe kërkesa e llogarisë. Të jesh i hapur për të dhënë llogari dhe për t’u marrë në llogari, është tregues i civilizimit. Mirëpo, shumë njerëz e konsiderojnë kërkesën e llogarisë si mosbesim ndaj tyre dhe për këtë arsye ata irritohen nga dhënia e llogarisë. Ata që gjenden në pozitën e menaxhimit të njerëzve, duhet ta vendosin patjetër kulturën e dhënies së llogarisë. Megjithatë, ata nuk duhet ta realizojnë këtë duke i turpëruar njerëzit dhe duke i trajtuar si të akuzuar. Pra, kërkesa e llogarisë duhet të konsiderohet plotësisht si një proces informacioni.

Shkrimin e filluam me shprehjen “hasbunallah” dhe po e mbyllim po me këtë. Nisur nga kuptimi i kësaj shprehjeje, njeriu që beson me gjithë qenien e vet se Allahu i mjafton atij, ai i kryen adhuret vetëm për Allahun. Për këtë njeri, i cili është i vetëdijshëm se Zoti i vet i mjafton atij në çdo çështje, edhe shpresa për Xhenet, edhe frika ndaj Xhehenemit qëndrojnë në plan të dytë, sepse atij i mjafton Allahu...





Begatia që vjen prej kursimit

— As. dr. Mustafa Xhanllë —

Transmetohet nga Amr ibn Shuajbi, nga babai i tij dhe nga gjyshi i tij se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“HANI, JEPNI LËMOSHË DHE VISHUNI (SI TË DËSHIRONI) PA RËNË NË MENDJEMADHËSI DHE HARXHIM TË TEPËRT!”

(Nesai, Zekat, 66.)

Të urtët kanë thënë:

“MIKU I NJERIUT ËSHTË KURSIMI, NDËRSA ARMIKU I TIJ ËSHTË HARXHIMI I TEPËRT.”

Një ditë Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë, (a.s.), shkoi te Sa'd bin Ebi Vakkasi, (r.a.). Hazreti Sa'di po merrte abdest. Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), vuri re se Sa'di përdorte shumë ujë për të marrë abdest, i tha:

“Ç'është ky harxhim i tepërt?”

Sa'di (r.a.), e pyeti:

“A ka harxhim të tepërt edhe në abdest?” I Dërguari i Allahut, (a.s.), i dha përgjigje me këto fjalë që do të na ndriçojnë deri në Ditën e Kiametit:

“Po, kjo është israf / harxhim i tepërt edhe sikur të jesh duke marrë abdest në buzë të një lumi që rrjedh.” (Ibn Maxhe, Taharet, 48.)

Abdullah ibn Abbasi, (r.a.), i cili ishte fëmijë në kohën kur merrte abdest i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili i kishte njësoj fjalët dhe veprat, tregon:

“...I Dërguari i Allahut, (a.s.), u ngrit dhe mori abdest nga një torbë e vjetër uji. Ujin e përdorte

pak nga pak. Edhe unë u ngrita dhe veprova siç bëri ai.” (Nesai, Taharet, 105.)

Po, besimtari nuk duhet të harxhojë shumë ujë edhe kur të marrë abdest, sepse të mos harxhosh më shumë se duhet, domethënë, ta kursesh ujin është një ibadet si vetë abdesti.

Nisur nga kjo që thamë më lart, kursimi është ibadet dhe një nevojë që e nxjerr në pah nënshtrimi ndaj Allahut të Lartësuar. Ndërsa harxhimi i tepërt është dalje jashtë kufijve të nënshtrimit ndaj Krijuesit.

Nëse e shohim nga ky këndvështrim, kursimi është qëndrim brenda kufijve, ndërsa harxhimi i tepërt është shkelje e këtyre kufijve në fjalë. Vlen të theksojmë se Allahu, (xh.sh.), nuk i do ata që e teprojnë. Një herë kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), po i mësonte mënyrën e marrjes së abdestit një beduini, ia tregoi abdestin duke i larë gjymtyrët nga tri herë dhe i tha:

“Ja, kështu merret abdest. Kushdo që bën diçka më tepër se kjo, vepron gabim, e tepron dhe bën padrejtësi.” (Nesai, Taharet, 105.)

Kursimi është begati. Një besimtar që bën kursim sheh begati përgjatë jetës së tij. Edhe nëse fiton pak, Allahu, (xh.sh.), i jep begati fitimit të tij ngaqë ka kursyer. Në këtë mënyrë, arrin të mbledhë pasuri më tepër se ai që fiton dhe që harxhon më shumë se ai.

Për këtë arsye, kursimi është pasuri. Ndërsa harxhimi i tepërt është varfëri, sepse ai që harxhon tepër nuk mund ta shikojë begatinë e fitimit të tij. Kjo ndodh për shkak se është një vepër që nuk e do Allahu i Lartësuar. Kur Allahu (xh.sh.), të mos e dojë një vepër, prej saj e largon begatinë.

Kursimi e kënaq Allahun Mëshirëplotë, ndërsa harxhimi i tepërt e gëzon shejtanin. Në të njëjtën kohë është edhe një vepër që nuk e gëzon aspak Allahun e Madhëruar. Në ajetin fisnik thuhet:

“Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara, hurma dhe bimë, me shije të ndryshme, ullinj e shegë, të ngjashme dhe të ndryshme. Hani frutat e tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre! Por mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë!” (En’am, 141)

Mugire bin Shu’be, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Allahut nuk i pëlqen që ta shpërdoroni pasurinë tuaj.” (Buhari, Istikraz, 19.)

Madje, ai që bën israf e gëzon aq shumë shejta-

nin saqë është vëllazëruar me të. Në ajetet fisnike thuhet:

“Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepruar. Dorëshpuarit me të vërtetë, janë vëllezërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.” (Isra, 26-27)

Për këtë arsye, një besimtar që pohon se i beson Allahut të Madhëruar, nuk duhet ta teprojë qoftë edhe me një kafshatë dhe nuk duhet ta gëzojë djallin e mallkuar. Në lidhje me këtë, edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Nëse dikujt prej jush i bien në tokë kafshata që ka në dorë, le t’ia pastrojë dheun dhe ta hajë! Le të mos ia lërë atë shejtanit!” (Muslim, Eshribe, 136.)

Besimtari nuk duhet të shfaqet mendjemadh në lidhje me këtë çështje, por duhet t’i fryjë kafshatës së rënë në tokë dhe ta hajë nëse nuk është bërë me baltë apo gjëra të tjera të ngjashme me të. Besimtari gjithmonë duhet ta nderojë ushqimin e tij.

Besimtari është urdhëruar që të përfitojë nga mirësitë që ia ka dhënë Allahu i Lartësuar duke mos rënë në mendjemadhësi dhe duke mos bërë harxhime të tepërta. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Hani, jepni lëmoshë dhe vishuni (si të dëshironi) pa rënë në mendjemadhësi dhe harxhim të tepërt!” (Nesai, Zekat, 66.)

Kursimi është maturi dhe ekuilibër. Ndërsa harxhimi i tepërt është sjellje e pamatur dhe ç’ekuilibër. Edhe njëri prej koncepteve që ka pozitë të rëndësishme në fenë islame është ekuilibri. Siç duhet ta mbajmë ekuilibrin dynja-ahiret në këtë jetë, gjithashtu duhet ta mbajmë atë edhe në të ngrënë, në të pirë, në veshje, madje edhe në sjellje dhe në të folur. Allahu i Lartësuar e shpreh me këto fjalë këtë ekuilibër në ajetin fisnik:

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!”; dhe ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë; dhe ata që thonë: “O Zoti ynë, largoje prej nesh ndëshkimin e Xhehenemit, sepse, me të vërtetë, dënimi i tij është i përjetshëm e ai është vendbanim dhe vendstrehim i keq”; dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes; dhe ata që, pos Allahut, nuk adhurojnë zot tjetër, nuk vrasin njeri, gjë që Allahu e ka ndaluar, përveçse me të drejtë dhe që nuk bëjnë kurvëri. E kush i bën këto, do të marrë gjynahe.” (Furkan, 63-68)

Kursimi është respektim i të drejtave të të tjerëve. Ndërsa israfi është shkelje e të drejtave të të tjerëve dhe padrejtësi.

Për shembull, e drejta dhe drejtësia në çështjen e ngrënies dhe të pirjes është të ngrënët dhe të pirët aq sa mund të jetojmë të shëndetshëm. Siç nuk janë të mira për shëndetin tonë e pakta dhe e shumta e këtyre, gjithashtu janë një gjendje e papëlqyeshme në aspektin e respektimit të të drejtave të të tjerëve dhe të drejtësisë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka theksuar se është israf të ngrënët e tepërt duke thënë:

“Të hash çdo gjë që ta kërkon vetja është israf.”
(Ibn Maxhe, Et’ime, 51.)

Nëse e shtjellojmë këtë çështje nga aspekti i shpenzimeve që bëjmë, harxhimi me dorë të shtrënguar dhe harxhimi i tepërt është padrejtësi. Ndërsa kursimi apo harxhimi me maturi është respektim i mirësisë e pasurisë dhe drejtësi.

Kursimi është mirënjohje ndaj mirësive që ka dhënë Allahu Teala. Ndërsa israfi është mosmirënjohje. Allahu i Madhëruar na ka dhuruar mirësi të pafundme. Një besimtar që i përdor me maturi këto mirësi, do të thotë se ka vepruar duke ua ditur vlerën atyre mirësive.

Nisur nga këto që thamë më lart, kursimi apo harxhimi i pasurisë me maturi është një lloj falënderimi ndaj Zotit (xh.sh.). Besimtari, në një lloj mënyre, e falënderon Allahun Teala duke ua ditur vlerën mirësive që i posedon. Allahu, (xh.sh.), na njofton se do t’i falë begati atij që e harxhon pasurinë me maturi dhe duke kursyer: *“(Kujtoje) kur Zoti juaj kumtoi: “Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t’ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia, por, nëse ju mohoni mirësitë e Mia, (atëherë dijeni se) dënimi Im është i rëndë.”* (Ibrahim, 7) Një njeri që nuk ua di vlerën atyre mirësive që ka dhe jeton duke e shpërdoruar pasurinë, do të thotë se po shfaq mosmirënjohje ndaj Zotit (xh.xh.), i Cili ia ka dhënë ato mirësi dhe nuk po e falënderon.

Kursimi është pasuri. Ndërsa israfi është varfëri, skamje dhe pendim. Një besimtar që kursen dhe e përdor pasurinë e tij me maturi, asnjëherë nuk bëhet pishman ngaqë e ka falënderuar Zotin duke ua ditur vlerën mirësive dhe ngaqë i ka bërë harxhimet pa e shpërdoruar pasurinë. Ndërsa ai që bën israf, bëhet pishman. Allahu i Lartësuar e shpjegon kështu këtë gjendje:

“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë.” (Isra, 29)

Ai që e harxhon pasurinë me maturi, do ta ketë të

lehtë edhe llogarinë. Ndërsa llogaria e shpërdorimit të pasurisë është e rëndë, sepse njerëzit do të merren në llogari edhe për shpërdorimin e mirësive. Shpërdorimi i jetës, shpërdorimi i i rinisë, shpërdorimi i pasurisë, shpërdorimi i dijes... Në hadithin fisnik thuhet kështu në lidhje me këto çështje në të cilat njeriu mund të bëjë israf:

“Ditën e Kiametit njeriu nuk do të lëvizë dot nga vendi pa u marrë në llogari për pesë gjëra: Si e ka shpërdoruar jetën, si e ka kaluar rininë, ku e ka fituar pasurinë, ku e ka shpenzuar pasurinë dhe si ka punuar me dijen që ka mësuar.” (Tirmidhi, Sifatu’l-Kijame, 1.)

Përdorimi me maturi i mirësive është moral i lartë. Ndërsa shpërdorimi i tyre është moral i ulët. Sa moral të lartë që posedon një besimtar që kursen dhe sa shtëpi e begatë është ajo shtëpi në të cilën kursehen dhe nuk shpërdorohen mirësitë.

Allahu i Lartësuar na bëftë të gjithëve prej atyre që ua dinë vlerën mirësive, e falënderojnë Zotin (xh.sh.), për ato mirësi dhe që i përdorin mirësitë me maturi! Gjithashtu, mos na bëftë prej atyre që shfaqin mosmirënjohje për mirësitë, që i shpërdorojnë ato dhe që nuk ua dinë vlerën atyre!

“...O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!” (Ali Imran, 147)

Amin!..



Mbi drejtësinë, lirinë dhe paqen

— Edison Çeraj —

“Njerëzit lindin me aftësi të ndryshme. Nëse ata janë të lirë, atëherë nuk mund të jenë të barabartë. E nëse janë të barabartë, atëherë nuk mund të jenë të lirë.” (Sollzhenicin)

Ka shumë të ngjarë që totalitarizmi ka dy origjina: mund të jetë fetar ose afetar. Origjina fetare e totalitarizmit lidhet me atë individ apo grup individësh që besojnë se janë misionarët e Zotit në tokë dhe jeta duhet jetuar ashtu siç përcakton ky mision, që sipas tyre Zoti e ka bërë detyrim për të gjithë, duke harruar apo mohuar faktin se çdo tekst i shenjtë tregon qartazi se njeriu është dhe duhet të jetë i lirë. Tjetër gjë është të veprësh në emër të fesë, tjetër është sipas fesë. Shumë njerëz veprojnë në emër të fesë, por jo sipas fesë.

Kurse origjina afetare ka të bëjë me atë apo ata që mohojnë ekzistencën e Zotit dhe në një mënyrë apo në një tjetër e shpallin veten zota, duke zënë kështu fronin e boshatisur, dhe si të tillë kanë të drejtën të vendosin për mënyrën se si duhet të jetojnë njerëzit.

Disa tipare të totalitarizmit të parë i gjejmë në Arabinë Saudite ose në Iran, si dhe në regjimet fashiste. Ndërsa tipare të totalitarizmit të dytë, atij afetar, i gjejmë në vende si Korea e Veriut dhe në të gjitha vendet socialiste/komuniste dje dhe sot.

Pavarësisht këtij dallimi ndërmjet dy llojeve të totalitarizmit, ajo që i bën bashkë si *modus operandi* është kërcënimin ndaj lirisë. Pse kërcënohet kaq shpesh liria? Sepse në shumë raste ne nuk jemi të drejtë. Sepse ne kërkojmë nga shteti (përbindëshi) dhe nga institucionet e tij të ndryshme, ose nga njerëz të caktuar që të jenë të drejtë, që të mbajnë drejtësi, por vetë nuk jemi të drejtë.

Po çfarë do të thotë të jesh i drejtë? Përgjigjen e kësaj pyetjeje e dimë të gjithë, mjafton të mos na shtrohet si pyetje. Çdo njeri është i pajisur me atë që jemi mësuar ta quajmë ndërgjegje, dhe është pikërisht ndërgjegjja, qoftë dhe tek ata njerëz që e tradhëtojnë atë, që nuk na lë rehat apo së paku na jep një lloj sinjali deri sa të bëjmë atë që duhet të bëjmë. A mjafton vetëm ndërgjegjja? Kjo është një temë më vete, por, një përgjigje e shkurtër është:

jo, nuk mjafton, ama ajo luan dhe duhet të luajë rolin e pazëvendësueshëm që i takon.

Kështu, thelbi i drejtësisë në lidhje me rolin që ka ndërgjegjja është parimi i mirënjohur që të duam për tjetrin atë që duam për veten, apo të mos i bëjmë tjetrit atë që nuk do të donim të na e bënte dikush ne. Së këndejmi është nxjerrë edhe imperativi kategorik i Kant-it, për të vepruar sipas atij parimi që do të donim të ishte rregull/ligj universal.

Kjo nënkupton qartazi se edhe mund të bëjmë të kundërtën, sepse fundja jemi të lirë, dhe po e ushtrojmë atë; por, në këtë pikë vijmë te liria si përgjegjësi, pra te pasojat e lirisë, pikërisht kur e ushtrojmë në atë drejtim që cenon/dëmton tjetrin.

“Falë Zotit që në vendin tonë kemi tri gjëra fort të shtrenjta: lirinë e shprehjes, lirinë e ndërgjegjes dhe maturinë për të mos praktikuar asnjërin prej tyre.” (Twain)

Vetëm mrekullia e lirisë apo liria si mrekulli mund të sigurojë ekuilibrin e domosdoshëm mes kaosit dhe rendit, mes rebelimit dhe bindjes, mes privates dhe publikes.

Qysh nga njeriu i parë e deri më sot, në një mënyrë apo në një tjetër ne vazhdojmë të përballemi me sfidën për të zgjedhur ndërmjet lirisë dhe lumturisë, gjë që e ka trajtuar me aq art e urtësi Dostojevski te *Vëllezërit Karamazov*, ku dialogu mes kryepeshkopit dhe Jezuit kulmon me “akuzën” e kryepeshkopit ndaj Jezuit: “Ti i ke mësuar njerëzit të jenë të lirë, por ata nuk e duan lirinë; ata duan të jenë të lumtur.”

Freud-i e shpjegon këtë duke thënë se liria është përgjegjësi, dhe njerëzit përpiqen t’i shmangen përgjegjësisë.

Me sa duket, kulmi i kësaj lumturie është barazia, të cilën u mundua të ndërtonte komunizmi, por e dimë fort mirë se çfarë ndodhi e çfarë po ndodh akoma në vende si Korea e Veriut, Kina apo Rusia.

Drejtësia sjell lirinë dhe liria paqen. Asnjë qenie nuk mund të jetë në paqe me veten nëse nuk është e lirë, sikurse nuk mund të jetë e lirë nëse nuk është e drejtë.

Profeti ynë SHEMBULL

Ferit Piku

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin famëlartë: **“Ju keni një shembull të lartë tek i dërguari i Allahut. Ka një shembull për të gjithë ata njerëz, që presin shpërblimin e Allahut, që e besojnë ditën e ringjalljes, për të gjithë ata njerëz që e përmendin shumë Zotin e tyre”.** (Ahzab: 21).

Kemi folur për profetin (a.s), të cilin e edukoi Allahu (xh.sh) me edukatën hyjnore qysh kur lindi, derisa ndërroi jetë. Me të vërtetë, kur njerëzit duan dikë, ia tregojnë botës të mirat e atij personi dhe ia mbulojnë gabimet, sepse ata e duan atë njeri. Atëherë del detyrë për çdo musliman, që të flasë për profetin (a.s), jeta e të cilit nuk ka asnjë të keqe por vetëm të mira. Madje edhe armiqtë e tij, të cilët e urryen më shumë, folën për sinqeritetin e tij, për pastërtinë dhe ndershmërinë e tij.

Do të flas për një moment mjaft kyç në historinë botërore, për momentin më të rëndësishëm që ka kaluar në historinë e kësaj toke, për momentin kur zbriti ajeti i parë kuranor: **“Lexo me emrin e Zotit Tënd që të krijoi”.** (Alak: 1).

Meleku Xhibril (a.s) zbret mbi njeriun më të pastër të tokës, mbi profetin Muhamed (a.s), në një vend shumë të thjeshtë, në një shpellë e cila nuk i kalon disa metra katrorë, në qytetin e lashtë të Mekes, në gadishullin arab, për të sjellë misionin më madhështor, për t'i treguar botës, se tani u lidh toka me qiellin, tani u lidh njeriu me Krijuesin e tij.

Xhibrili (a.s) vjen dhe i thotë profeti (a.s) fjalët e Zotit: **“Lexo”** e profeti Muhamed (a.s) nuk dinte të lexonte. Ai thotë: **“Nuk di të lexoj”.** Atëherë Xhibrili (a.s) e kap fort për rrobash, e shkund fort dhe i thotë: **“Lexo”.** Profeti (a.s) përsëri i përgjigjet: **“Unë nuk di të lexoj”**¹.

Për herën e tretë Xhibrili (a.s) i thotë: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili të krijoi. Krijoi njeriun nga një gjak i ngjizur. Lexo se Zoti yt është më bujari. Ai i mësoi njeriut të shkruajë me pendë. Ai i mësoi njeriut atë që nuk e dinte”.** (Alak 1-5).

Për ne duket mjaft normale, por këto ajete hapën një faqe krejt të re të historisë botërore. Këto ajete e rrotulluan me 180 gradë atë histori, e cila lëngonte në çdo moment. Momentet kur zbritën këto ajete, janë momentet më historike të botës, janë momente kur lindi dielli i profecisë, për të mos perënduar asnjëherë.

Lindi Islami, lindi Kurani për të mos vdekur kurrë. Dielli ndonjëherë mbulohet me re, por pas reve ekziston gjithmonë dielli, që nuk zhduket kurrë e ai është dielli i profecisë.

Për të gjithë ata njerëz që duan të drejtohen, le ta dinë se Zoti ka zbritur fjalën e Tij, ka dërguar profetin e Tij. Ndërsa ata që nuk duan të udhë-

1. Buhariu dhe Muslimi.

zohen, do të vazhdojnë të jetojnë të verbër, pa e shikuar rrezatimin e këtij dielli edhe pse ai futet thellë në zemrat e besimtarëve.

Profeti (a.s) u frikësua jashtë mase, kur para tij doli Xhibrili (a.s). Kjo tregon se ai nuk e priste që t'i vinte Xhibrili (a.s). Ai u tremb, sepse nuk e dinte se çfarë e priste. Nuk e dinte, që për të ishte caktuar një mision hyjnor. Kjo tregon se profetët i zgjedh vetë Allahu (xh.sh) dhe nuk zgjidhen vetë. Besimtarët zgjidhen nga Zoti dhe nuk mund të jenë besimtarë ata që lavdërojnë veten dhe që pretendojnë, se janë besimtarë e shërojnë në emër të Zotit.

Mund të mendonim se arabët do të gëzoheshin jashtë mase, kur të dëgjonin se Muhamedi (a.s) ishte bërë profet edhe pse nuk ishte me dëshirën e tij. Arabët krenoheshin kur nga mesi i tyre dilte ndonjë poet apo luftëtar i aftë. Por ndodhi komplet ndryshe. Ata u mërzitën shumë, kur dëgjuan se Muhamedi (a.s) po shpall profecinë, po tregon se i ka zbritur ajeti kuranor dhe meleku i Zotit.

Nga një anë hapet një diell, hapet një faqe drite, por nga ana tjetër për habinë e të gjithëve u hap një valë dhune dhe torturash mbi njeriun më të pastër, mbi profetin (a.s) dhe mbi të gjithë ata, që ndoqën rrugën e tij.

Pse vallë? Teorikisht kjo nuk është llogjike. Kjo tregon se e mira dhe e keqja kanë luftuar, po luftojnë dhe do të luftojnë njëra – tjetrën, sa të jetë kjo jetë, sepse kështu desh Allahu (xh.sh), na pëlqen ne apo jo. Kjo ndodhi për të na treguar se ka njerëz besimtarë, që paguajnë gjithçka për të mbajtur fenë dhe misionin e Zotit, por ka edhe njerëz që shejtani i ka mashtruar, të cilët verbërisht bëjnë punën e shejtanit edhe pse nuk e dinë diçka të tillë.

U luftua profeti (a.s) dhe shokët e tij, burra dhe gra, të medhenj e të vegjël. Çfarë krimi kishin bërë këta njerëz? A mos ishin të pandershëm? A mos kishin vjedhur. A mos thoshin fjalë të ndaluara? Ata thonin vetëm një fjalë: **“LA ILAHE IL ALLAH, MUHAMEDUN RESULULLAH”**. Është një fjalë që duket fare e thjeshtë, por që në vetvete është revolucion në mendjen e njerëzve. Të adhurohet vetëm një Zot, t'i dorëzohesh Atij dhe vetëm për të ta vesh ballin në sexhde.

U luftua Bilali (r.a) një rob i zi. Ai ishte skllav dhe askush nuk merrej me të, por pasi pranoi fenë Islame, pronarët e tij e merrnin, e nxirrnin ne shkretëtirën përvëluese të Mekes, e shtrinin mbi rërën e nxehtë, pa robra dhe mbi kraharonin e tij vinin një

gur, të cilin nuk mund ta mbanin dy burra dhe i thoshin: “Ose do të digjesh në rërë, ose moho fenë e Muhamedit”.

Çfarë thoshte Bilali (r.a)? Ai njeri, që deri dje rrihej vetëm për një kafshatë bukë, sot po rrihej për diçka tjetër. Dje vuante, ndërsa sot gëzonte dhe thoshte: **“EHADUN EHAD (Ai është një, Ai është një – Zoti është një)”**. Këtë fjalë e ka thënë Bilali (r.a), e kanë thënë profetët e Allahut (xh.sh) e kanë thënë të gjithë besimtarët edhe pse kjo nuk u pëlqen armiqve të kësaj feje.

U dënuan edhe gratë. Po pse vallë? Çfarë bënë ato? Ato pranuan Islamin dhe pranuan, që profeti (a.s) të jetë drejtuesi i tyre për në xhenet. Gruaja e parë, e cila u vra në fenë islame, është Sumejja. Ajo u vra, se nuk hoqi dorë nga feja e Muhamedit (a.s). Çfarë vullneti patën këto gra? Ato patën besim në zemrat e tyre. U vra ajo, u vra burri i saj, vuajti edhe djali i tyre, pra një familje e tërë. Profeti (a.s) i shikonte dhe nuk kishte se çfarë t'u bënte. Ai vetëm u thoshte: **“Durim o familja e Jasirit. Premtimi juaj është**

xheneti”².

Ishte kjo sprovë nga Allahu (xh.sh), me të cilën do të provoheshin besimtarët e vërtetë. Çdo gjë e shtrenjtë ka çmimin e saj, kështu që edhe xheneti ka çmimin e tij.

Profeti (a.s) bashkë me besimtarët vuajtën për tre vite në shkretëtirë, të bojkotuar nga familjet e tyre, pa ushqim dhe pa pije. Nuk kishin të drejtë as të jepnin as të merrnin nuse nga banorët e Mekes.

Një presion i vërtetë psikologjik. Ata duruan, sepse në zemrat e tyre kishte besim, sepse në zemrat e tyre kishte arritur flladi i atij dielli që lindi, kishte arritur flladi i xhenetit.

Duroi edhe Habbab Ibn Eret (r.a), i cili kur tregoi për vuajtjet e tij, nuk tha asnjë fjalë, vetëm ngriti robën e tij dhe të pranishmit panë se nuk kishte pjesë të lëkurës së tij, që të mos kishte shenjë prej shpate, prej thike apo prej heshte. Mjaftoi trupi i tij për të treguar se sa kishte vuajtur ai njeri. Vuajtën të gjithë muslimanët, por më e habitshmja është se vuajti profeti i Zotit, njeriu më i dashur i Allahut (xh.sh) e kjo tregoi, se për të arritur kënaqësinë e Allahut (xh.sh) duhet të sakrifkohet. Kjo nuk është fe për t'u tallur, nuk është fe për dembelët apo për ata që duan të plotësojnë epshet e tyre, që pretendojnë se dyert e xhenetit do t'i presin krahëhapur.

Lindi Islami,
lindi Kurani për të mos
vdekur kurrë. Dielli
ndonjëherë mbulohet me
re, por pas reve ekziston
gjithmonë dielli, që nuk
zhdukët kurrë e ai është
dielli i profecisë.

2. Ibn Is'haku.

Profeti (a.s) vuajti, për të na i treguar të gjitha këto. Vuajti nga presioni psikologjik, kur pas shpinës së tij rrinte xhaxhai i tij, njeriu më i afërt dhe kur profeti (a.s) i ftonte njerëzit në fe, xhaxhai i tij u fliste njerëzve me shenja: “Ky është i çmendur, është magjistar, unë e njoh më mirë, e kam djalin e vëllait tim”. E imagjino dot vallë, që dikush të flasë këto fjalë për ty: “Magjistar, i çmendur, budalla”. A do të duroje vallë? Profeti (a.s) duroi, sepse e kuptoi, se rruga e drejtë, rruga e Allahut (xh.sh) është e shtruar me vështirësi. Ai e kuptoi mirë thënien e Allahut (xh.sh): **“Ne do të të zbresim ty një barrë të rëndë”**. (Muzemmil: 5).

Profeti Muhamed (a.s) është shembull sakrifice. Ai duroi me trupin e tij. E imagjino dot, që trupin e profetit të Zotit, njeriut më të pastër, ta prekin duart më të pista të atyre, që nuk besonin në Allahun (xh.sh)?! Ai e pranoi këtë, jo sepse ishte i dobët, por sepse të tillë e deshi rrugën Allahu (xh.sh).

Një herë ndërsa profeti (a.s) po falej para Qabes, pas shpinës së tij ishin mbledhur paria e Mekes. Ata e luftonin këtë njeri, sepse i shqetësonte jash-të mase dhe u prishte interesin dhe qejfet e kësaj bote. Menduan se çfarë mund t’i bënin këtij njeriu, i cili po i mërzhiste pa masë. Dikush prej tyre tha: “Unë kam një mendim. Filani ka therur devenë e tij. Unë do të shkoj të marr plëndësin e devesë e t’ia vendos në kokë Muhamedit, të rrijë ashtu siç është me ballin në sexhde”. Me të vërtetë e bëri diçka të tillë. Mori plëndësin e kësaj deveje me të gjithë pislleqet e saj dhe e vendosi mbi kokën më të pastër, mbi flokët e profetit (a.s) kur ai ishte në sexhde. Imagjinoje pak veten tënde para kësaj pamje. Këta njerëz po tentojnë të poshtërojnë figurën e profetit (a.s), në momentin kur ai është në sexhde. Ata filluan të qeshin e të zgërdhien nga kënaqësia e asaj që bënë, pa e ditur se kanë merituar mallkimin e Allahut (xh.sh).

Kur Fatimja (r.a) e pa këtë gjendje, filloi të qajë me të madhe. Pastaj vajti dhe ia hoqi papastërtinë, që profeti (a.s) kishte mbi shpinë dhe filloi të mallkojë armiqtë e Zotit. Profeti (a.s) i tha: “Mos mallko o Fatime”. Pastaj ngriti duart drejt qiellit dhe tha: **“O Zot merre hakun tim ndaj këtyre njerëzve”**. Ata e njihnin profetin (a.s), prandaj në atë moment u ngriu buzëqeshja në buzë, sepse e dinin se po të lutej profeti (a.s) për diçka, Allahu (xh.sh) do t’i përgjigjej. Të gjithë këta njerëz vdiqën në një formë makabre. Të gjithë vdiqën në një vend në betejën e Bedrit, të varrosur dhe të grumbulluar në një gropë, gropë dynjaje dhe gropë xhehenemi.

Profeti (a.s) vuajti edhe herë të tjera më shumë se kaq. Vuajti kur u kthye nga Taifi, kur këmbët e tij të bekuara u gjakosën nga gurët dhe duart e atyre



njerëzve, që nuk e njihnin Allahun (xh.sh), por këtë rradhë zemra e tij ishte zemër tjetër.

Këtë rradhë tha: **“O Zot! Fale popullin tim, ata nuk dinë. Ta dinin se jam profet, nuk do ta bënin diçka të tillë”**. Koha rrodhi dhe sot e dimë të gjithë fare mirë se kush është profeti (a.s). Është ai njeri, të cilin e përmendin mbi 1 miliardë besimtarë muslimanë. E përmend e gjithë bota, e lavdëron njeriu 5 herë në ditë, e lavdërojnë librat, e lavdëroi Allahu (xh.sh).

Po ata njerëz që e luftuan kush i njehej vallë?! Nuk u njohën as në dynja e as në ahiret. Populli i Taifit që luftoi profetin (a.s), sot është popull besimtar, sepse profeti (a.s) nuk u lut kundër tyre. Profeti Muhamed (a.s) do të na tregojë me jetën e tij, se nëse nuk beson në ahiret, nuk do ta kuptosh fenë e Allahut (xh.sh), sepse fenë nuk mund ta materializosh e ta bësh fe dynjaje. Islami është fe e ahiretit,



është fe e xhenetit.

Një moment që duhet të prekë të gjithë zemrat e besimtarëve është momenti, kur shoku i tij Omer Ibn Hattabi (a.s) futet në shtëpinë e profetit (a.s). Ai s'kishte hyrë ndonjëherë në shtëpinë e profetit (a.s), prandaj u habit se në shtëpinë e profetit të Zotit, në shtëpinë e presidentit të shtetit islam, në shtëpinë e atij që e kishin në zemrat e tyre, gjeti vetëm një lëkurë të varur në mur dhe një rrogaz ku ishte shtrirë profeti (a.s). Aty nuk kishte as ushqim, as krevat asgjë prej gjëje. Kjo ishte shtëpia e profetit Muhamed (a.s). Kur pa shenjat që rrogazi kishte lënë mbi trupin e profetit (a.s), Omerit (r.a) i shpërthyen lotët.

Profeti (a.s) i tha: **“Pse qan o Omer?”** – Omeri iu përgjigj: “E si të mos qaj o profet i Zotit. Ti je profet i Zotit, je njeriu më i dashur i Zotit dhe jeton në këto kushte, kurse mbreti romak dhe pers, armiqtë

e Allahut (xh.sh) rrinë në frone. Atyre iu bëjnë hije shërbëtorët e tyre, ata i ruajnë ushtarë”. Profeti (a.s) e kapi fort Omerin (r.a) për kraharori dhe i tha: **“O Omer! A po dyshon në fenë e Allahut (xh.sh)”?** “Jo – tha Omeri – nuk dyshoj, por nuk më vjen mirë kjo lloj gjendjeje”. Atëherë profeti (a.s) i tha: **“O Omer a nuk të mjafton, që Zoti na ka dhënë neve xhenetin dhe këtyre dynjanë”?**

Nëse ne nuk besojmë në xhenet, pasha Zotin kurrrë nuk do ta kuptojmë këtë situatë, por zemrat e besimtarëve besojnë në xhenet. Në qoftë se fenë do ta fusësh vetëm në dynja, ajo nuk të jep zgjidhje, sepse ajo është fe e dynjasë por edhe e ahiretit.

Ne e dimë mirë që edhe biznesmenët më të suksesshem kanë patur ditë vuajtjesh e mundimesh. Ne e dimë mirë, se për t'i marrë erë trëndafilin, që është mes ferrave edhe mund të gjakosesh, për të marrë xhevahiret, që janë poshtë detit njeriu duhet të durojë presionin e ujit për ta nxjerrë këtë xhevahir.

Ne i pranojmë të gjitha këto, por sa prej nesh e pranojnë se për të arritur në xhenet, duhet të paguash duhet të derdhësh djersë, duhet të punosh.

Pretendojmë se për të ndërtuar një shtëpi në dynja, duhet punë e mund. Ndërsa për të ndërtuar një shtëpi në xhenet, mendojmë se nuk është e nevojshme të lodhemi aspak, por mjafton të themi se e kemi zemrën e bardhë!

Profeti (a.s) ka thënë: **“Çdo mall e ka çmimin e tij dhe malli më i shtrenjtë është xheneti, e ai e ka çmimin e tij.”** Ai (a.s) ka thënë gjithashtu: **“Xheneti është shtëpi e bukur, është familje e lartë, është vend ku nuk ka vdekje, aty ka gjëra, që nuk t'i ka marrë mendja, nuk t'i ka parë syri, nuk t'i ka dëgjuar veshi”.**

Ai foli për bukuritë e xhenetit e më pas tha: **“A ka prej atyre njerëzve, që i përveshin krahet për xhenet”?** Shokët e tij i thanë: “Po, ne i kemi përveshur krahet”. Profeti (a.s) u tha: **“Thoni Inshallah”.**

Feja jonë nuk thotë, që duhet t'i lemë të gjitha kënaqësitë e kësaj dynjaje e të merrremi vetëm me punë për ahiret, por thotë: “Ekuilibroji gjërat, mos e harro ahiretin se po e harrove atë, jeta jote nuk do të ketë kuptim”.

Lusim Allahun (xh.sh), ta bëjë profetin (a.s) dhe shokët e tij shembull në zemrat tona dhe në jetët tona. Lusim Zotin, të na jap forcë për ta ndjekur rrugën e tij. Lusim Allahun (xh.sh), të dërgojë erëra e t'i pastrojë sytë dhe zemrat tona nga retë, që pengojnë shikimin e diellit të Islamit. Lus Zotin e gjithësisë, që zemrat tona t'i drejtojnë nga besimi. Lus Allahun (xh.sh), që mëshira e tij të na përfshijë të gjithëve.

Amin!..



Detyrësia që vjen nga PËRKUJTIMI I ALLAHUT

— Nurten Selma Çevikollu —

Për fat të keq, po dëshmojmë me një bindje të plotë se gjendja e përgjithshme e botës islame në gjeografinë e dynjasë që jetojmë, me të vërtetë është shumë e dhimbshme. Pothuajse në çdo vend të botës, për fat të keq janë myslimanët ata që gjithmonë shtypen, kolonizohen, torturohen, vriten dhe vdesin. Ata që nuk i marrin dot të drejtat e tyre, ata që dhunohen dhe ata që u merret atdheu nga duart, përsëri janë myslimanët. Krahas këtyre të vërtetave të dhimbshme, “detyra për ta bërë sunduese të vërtetën” është një detyrë e shenjtë që Allahu i Lartësuar ua ka ngarkuar besimtarëve. Kjo detyrë është detyra e përfaqësimit të Allahut të Madhëruar në sipërfaqen e tokës. Ndërhyrja ndaj ngjarjeve që ndodhin në kundërshtim me urdhrat dhe dispozitat që ka vendosur Allahu Teala është detyrë e çdo myslimani. Vendosja në pikat kyçe të faktorëve që nuk janë myslimanë dhe udhëheqja e tyre në çfarëdo pozite që të kenë, ua djeg zemrat

njerëzve me besim dhe nuk i lë të flenë gjumë. Andaj, e kemi kusht jetik që të shpëtojmë nga ky poshtërim.

Nëse myslimanët, të cilët po rrokullisen në humerën e fatkeqësive, dëshirojnë të shpëtojnë nga këto vështirësi, së pari duhet të hetojnë fetarinë e tyre, duhet të marrin në llogari veten e tyre dhe duhet ta rregullojnë përsëri jetën e tyre islame.

Veçanërisht në ditët e sotshme, disa fuqi në shkallë botërore po sulmojnë më të gjithë forcën e tyre duke e vlerësuar me mediat, shkollat, tregjet dhe mjediset e tyre çdo mundësi që u jepet për të përhapur armiqësi ndaj Islamit, për t'i shkëputur myslimanët nga Islami dhe për t'i ngatërruar besimtarët me njëri-tjetrin duke ua nxjerrë në pah kontradiktat që kanë ndërmjet tyre. Nëse këto sulme nuk mund t'i bëjnë haptazi, shpesh herë i kanë bërë fshehurazi dhe pa rënë në sy. Besimtarët e kanë kusht që ta vendosin fenë islame në



qendrën e jetës së tyre me një vetëdije serioze, në mënyrë që të mos zhduken prej këtyre sulmeve, të mos shkatërrohen dhe të mos bien në devijimet e armiqve të tyre. Myslimanët duhet të formojnë lidhje të vazhdueshme me Allahun e Lartësuar, në mënyrë që asnjëherë të mos verbërohet ndjenja “për ta bërë sunduese të vërtetën” që gjithmonë e kemi në brendësinë tonë, sepse, kjo lidhje e shenjtë është një lumturi e vërtetë dhe absolutisht i jep njeriut një prehje shpirtërore. Ja pra, kjo lidhje që nuk duhet të shkëputet është “dhikrullah / përmendja e Allahut”. Ata që e bëjnë dominuese këtë lidhje të shenjtë në jetën e tyre, e marrin veten në llogari, kanë frikë nga gabimet, edhe nëse bëjnë gabime kthehen menjëherë, pendohen dhe i kërkojnë falje Allahut Teala duke iu përgjyruar me lot në sy.

Kur besimtarët i drejtohen dhikrit, do të thotë se kanë vendosur për ta ndryshuar veten e tyre. Ata që nuk arrijnë ta rregullojnë veten me përkujtimin e Allahut Teala dhe me mendime, nuk kanë të drejtë të presin lajmet e fitores nga frontet në të cilat luftohet për Islamin, sepse çdo besimtar është një front prej fronteve. Përmendja e Allahut është ilaçi i vetëm që i fshin gjërat negative të cilat ndodhen në zemër. Dhikrullah / përmendja e Allahut është një ushqim i fshehtë që i ushqen zemrat. Ata të cilët nuk marrin pjesë nga ky ushqim, bëjnë një jetë të shuar, të ngrirë dhe të harxhuar vetëm për gjërat materiale. Një jetë e tillë nuk mund t’i sjellë robët ndonjë fitim shpirtëror. Një jetë e tillë është një jetë monotone, jo emocionale dhe e pakëndshme. Ndërsa jeta me përmendjen e Allahut Teala shndërrohet totalisht në një jetë tjetër. Nisur nga ky aspekt, përmendja e Allahut është ajo që i jep kuptim jetës.

Kuptimi leksikor i fjalës dhikr në gjuhën arabe është: “Të kujtosh, të përmendësh dhe të këshillosh.” Ndërsa dhikrullah do të thotë “përmendje e Allahut Teala, mos’harrim i Allahut (xh.sh.) dhe mosshkujdesje ndaj Allahut, azze ve xhelle. Megjithëse fjala dhikr përdoret në kuptime të gjera si emër në Kuranin Fisnik, përfundimisht të gjitha kuptimet bashkohen në çështjen e përmendjes së Allahut, (xh.sh.).

Vetë Allahu i Lartësuar e quan Kuranin dhikër:

“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Dhikrin (Kuranin) **dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.**” (Hixhr, 9)

“Ne nuk ia kemi mësuar atij (Muhamedit) **poezinë e ajo as që është për të. Ky** (libër që ka sjellë) **është vetëm dhikr** (këshillë) **dhe një Kuran i qartë.**” (Jasin, 69)

Në lidhje me këtë çështje ka edhe ajete të tjera si:

“Kushdo që i kthen shpinën dhikrit (Këshillës Sime), **do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.**” (Taha, 124)

“A ta tërheqim Përkujtimin (Kuranin) **prej jush ngaqë jeni popull i shfrenuar?”** (Zuhruf, 5)

Në Kuranin Fisnik shohim se dhikri është një ibadet në vete dhe se zë vend si njëri prej urdhrave që Allahu Teala ka kërkuar të kryhet nga robërit e Tij. Ja ajetet që e vërtetojnë këtë:

“O ju që keni besuar! Përmendeni shpesh Allahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje!” (Ahzab, 41-42)

“Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) **që Unë t’ju kujtoj** (me shpërblime) **dhe falënderomëni Mua** (duke M’u bindur) **e mos i mohoni dhuntitë e Mia** (me mosbindje)!” (Bakara, 152)

“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve qetësohen kur përmendet Allahu. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Rra’d, 28)

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjur ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) **“O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh** (nga çdo e metë)! **Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.**” (Al Imran, 190-191)

Siç kuptohet edhe nga ajetet fisnike, përkujtimi i Allahut të Lartësuar siguron qetësinë e zemrës. Ndërsa meditimi rreth madhësisë së Atij, azze ve xhelle, lartësisë dhe bukurisë në krijim, e zbukuron botën e brendshme të njeriut. Gjithashtu bëhet e qartë se dhikri / përkujtimi i Allahut Teala është i rëndësishëm, në mënyrë që besimtarët të mos bien në neglizhencë. Domethënë se përkujtimi i Allahut të Madhëruar është mjaft i rëndësishëm. Kështu që një njëri i cili e ka humbur cilësinë e përmendjes së Allahut për shkak të rrëmujës së kësaj bote, nuk mund të gjejë prehje shpirtërore në asnjë lloj mënyre. Sikur kjo të mos mjaftonte, i shqetëson edhe të tjerët me dëshpërimin e tij. Njerëzit e tillë që nuk kanë prehje shpirtërore, e zvarrisin edhe botën drejt dëshpërimit.

Në lidhje me rëndësinë e përkujtimit të Allahut Teala, edhe i Dërguari i Allahut, alejhis’s-salam, ka shumë hadithe fisnike. Ja disa prej tyre:

“Çdo gjë e ka zbukurimin e saj. Ndërsa zbukurimi i zemrave është përmendja e Allahut. Ajo që



do ta mbrojë njeriun më shumë nga ndëshkimi i Allahut është vetëm Dhikrullah / përmendja e Allahut.” I thanë:

-A edhe xihadi në rrugë të Allahut nuk është më i mirë se (dhikri)? Pejgamberi u përgjigj:

“Jo, prapë se prapë është dhikri edhe nëse lufton derisa të vritesh.” (Buhari, Deavat, 5.)

“Allahu, (xh.sh.), ka thënë:

“Unë jam siç më pandeh robi Im. Unë jam me atë kur më lutet dhe më përkujton.

Kush më përkujton mua në vetvete, edhe Unë e përkujtoj në vetvete.

Kush më përkujton Mua në një xhemat, edhe Unë e përkujtoj atë në një xhemat më të mirë se ai.

Nëse ai më afrohet një pëllëmbë, Unë i afrohem atij një hap. Nëse ai më afrohet një hap, Unë i afrohem atij një pash. Nëse ai vjen te Unë duke ecur, Unë shkoj te ai duke vrapuar. Kush më vjen me mëkate sa toka, por pa më bërë shirk, edhe Unë do ta pres atë po me aq falje.” (Buhari, Tevhid, 15, 35, 50)

“Ai që e përkujton Allahun me atë që nuk e përkujton, është si i gjalli me të vdekurin.” (Buhari, Deavat, 67.)

“Mos u zhysni në biseda të padobishme duke e harruar Allahun, sepse bisedat e gjata që bëhen pa e përkujtuar Allahun, e ngurtësojnë zemrën. Ai që është më larg Allahut, është ai që ka zemrën e ngurtësuar.” (Tirmidhi, Zuhd, 62.)

Siç kuptohet edhe nga ajetet dhe hadithet fisnike, duket qartazi se përmendja e Allahut Teala e zhvillon dhe e ndryshon njeriun në drejtimin pozitiv. Qetësia shpirtërore, gjë të cilën mund ta quajmë edhe paqe e brendshme, arrihet vetëm me përmendjen e Allahut (xh.sh.). Burimi i çdo mirësie, bukurie dhe përsosmërie është Allahu i

Madhëruar. Atëherë, ai që e përmend Atë, bëhet shkak që të shfaqen edhe te vetja e tij të njëjtat mirësi. Njeriu mund t'i arrijë të gjitha llojet e pjekurisë, virtytet e larta dhe cilësitë e përsosura vetëm nëpërmjet rrugëve që ka treguar Allahu i Lartësuar. Kjo arrihet vetëm duke iu afruar Allahut Teala. Ndërsa dhikri është afrimi më sublim, mënyra më e lehtë dhe rruga më e shkurtër për te Allahu Teala. Personaliteti më i përsosur që mund të gjendet te një njeri janë reflektimet që mund t'i vijjnë nga Allahu i Lartësuar.

Përmendja e Allahut Teala, e cila i hap rrugën dashurisë ndaj Allahut në zemër, e preokupon zemrën me Krijuesin, e largon atë nga cytjet e shejtanit, i prish kurthet dhe mashtrimet e djallit, nuk e lë besimtarin t'u bindet epsheve dhe dëshirave të nefsit, e forcon besimin, e fshin ndryshkun e zemrave, e ndriçon zemrën e shpirtin dhe e bën shpirtin të kujdesshëm kundrejt mëkateve. Për shumë gabime që ndodhin në ditët e sotshme, për përhapjen e mëkateve dhe për prishjen e moralit gjejmë si shkak kryesor jetën e njerëzve të larguar nga përkujtimi i Allahut Teala. Të gjitha krimet që bëhet haptazi tregojnë se lidhja shpirtërore e njerëzve me Allahun Teala është shkëputur. Ndërkohë jeta fal kënaqësi vetëm me përkujtimin e Allahut (xh.sh.). Nëse një njeri dëshiron të ndjejë kënaqësi nga jeta që bën, le të përmendte Allahun e Lartësuar. Madje, le ta përmendte shumë, sepse diçka që thuhet shpesh, bën vend në zemër, e bën njeriun ta dojë atë që e thotë dhe ia shto dashurinë. Njeriu e do atë që e përmend shpesh. Ai që e përmend shpesh dynjanë, do të thotë se e do dynjanë. Ai që e përmend shumë emrin e Allahut Teala, do të thotë se e do shumë Atë.

Lus Allahun e Lartësuar që t'i japim jetës sonë një drejtim më të mirë me përkujtimin e Tij si besimtarë që jemi!..

Aventura martesore

— Esin Akdeniz Tuxhar —

Bëjmë përpjekje për të vizatuar një pikturë të martesës...

Sigurisht që komentimi i kësaj pikturë ndryshon në varësi të kohës dhe të vendit. Por në fund të fundit, çdo pikturë ngjason me pikturat e tjera. Ndryshojnë vetëm tonet e ngjyrave.

Marrëdhëniet mes njerëzve të cilat ndryshojnë nga vendi dhe kultura e shtetit, në fakt ushqehen nga i njëjti burim...

ÇFARË ËSHTË NJERËZORE? ÇFARË E BËN TË VIRTUTSHËM NJË VEPRIM?

Si mund t'i gjejnë rrugët e bashkëbisedimit një grua dhe një burrë?

Çfarë duhet bërë për të sjell dashuri dhe qetësi tek familjet tona?..

Sikur ne njerëzit të bënim të gjitha përpjekjet e mundshme për t'u marrë vesh me njëri- tjetrin do të ulej ndjeshëm numri i luftërave dhe ngatërresave!..

Fatkeqësisht në ditët tona është rritur shumë numri i divorceve dhe të gjithë jemi bërë të pandjeshëm ndaj kësaj dukurie.

Ky do të jetë shqetësimi jonë për sot...

Po bëjmë përpjekje për të studiuar dhe komentuar shkaqet e kësaj dukurie dhe për të kuptuar rrugën e zgjidhjes së këtij problemi...

Bismillah...

NDRYSHIMET MES GRUAS DHE BURRIT

Në këtë shkrim duam që të përqendrohemi tek ndryshimet mes gruas dhe burrit.

Le ta nisim shkrimin me një shembull nga jeta jonë:

SHSEMBULL NGA JETA

Është pasdite dhe gruaja e burri janë ulur në sallon. Gruaja po i tregon gjërat që ka bërë gjatë ditës. Zotëria ia ka ngulur sytë ekranit dhe nganjëherë i flet nga një fjalë fëmijëve të vet. Në shtëpi mbizotëron një bisedë shumë e zjarhtë (?)... Gruaja vazhdon të tregojë:

“Nga çanta e fëmijës doli një shënim; sot në shkollë paska pasur takim me prindër. Sigurisht që fëmijë është dhe mund të harrojë. Sa mirë që unë e dallova... U bëra gati menjëherë dhe arrita në çastin e fundit. Mësuesja më tha që duhet të blejmë një libër. Pastaj mbledhja mbaroi dhe ne u bëmë gati të dilnim. E çfarë të shikoja?! Fqinja jonë e vjetër, zonja Hanife... Ato janë zhvendosur por paskan ardhur përsëri. Fëmijën e kishin regjistruar në të njëjtën shkollë, edhe burri i saj po kërkonte punë në këtë zonë...”

Gruaja vazhdonte që të fliste me gjallëri kur i shkuan sytë tek burri të cilit ishin duke iu mbyllur sytë por që vazhdonte të shikonte televizion. Ajo u nervozua shumë dhe tha :

“- Ti nuk po më dëgjon mua!” Bashkëshorti i thoshte me këmbëngulje:

“- Jo, jo; jam duke të dëgjuar! Sot ka pasur mbledhje në shkollë. Zonja Hanife qenka kthyer në lagjen tonë. Burri i saj po kërkon punë...”

Po, ato që gruaja i shpjegoi me hollësi janë të njëjta me fjalitë e shkurta që tha burri. Fjalët e gruas ishin kuptuar por ajo ishte pala e lënduar në këtë bisedë. Burri i cili nuk e shikonte gruan në

sy, i kishte dëgjuar fjalët e saj por ato nuk kishin ngjallur interesin e tij. Tema ishte kuptuar por nuk ishte shfaqur interes.

Pikërisht kjo është tema më shqetësuese në martesat e ditëve të sotme... Gruaja ankohet nga mungesa e interesit të bashkëshortit kurse burri ankohet sepse nuk arrin ta kuptojë dot gruan.

Mund të themi që temat të cilat sjellin më tepër shqetësime në martesë janë problemet që lindin nga ndryshimet mes burrave dhe grave; le t'i hedhim një shikim më të detajuar kësaj çështjeje:

Një marrëdhënie normale kërkon interes nga të dyja palët. Çdo gjallesë ka nevojë për interes. Bisedat që nuk bëhen sy më sy nuk na lejojnë që të marrim shijen e vërtetë të interesit që na tregon bashkëbiseduesi. Në nervozohemi me të riun i cili na flet pa na shikuar në sy. Në fakt këtë mësim na e japim më së mirë fëmijët e vegjël sepse ato janë më të pastër se çdokush... Kur nëna nuk e shikon fëmijën e vogël ai ia kap fytyrën mes duarve dhe ia kthen nga ana e vet.

Sipas studimeve që janë bërë, 70 % e komunikimit është komunikimi pa fjalë kurse pjesën e mbetur e zë komunikimi me fjalë. Nga kjo kuptojmë që gjuha e trupit është shumë më efikase se gjuha dhe fjalët...

Në martesë gruaja përqendrohet më shumë tek qëndrimi i bashkëshortit dhe nervozohet me të duke i thënë: "Ti nuk më dëgjon, ti nuk më kupton!"

Gruaja e cila i tregon burrit të vet ngjarjet e ditës, e bën më shumë për të ruajtur komunikimin në familje dhe për të mbajtur gjallë interesin mes pjesëtarëve të familjes; ajo merr jetë nga ky interes.

Nga ana tjetër, burri e shikon si të pakuptimtë këtë gjë. Shumicën e kohës, akuzës së gruas për mungesë vëmendjeje i përgjigjet me fjalinë: "Prej ku e nxore këtë përfundim?!"

Një grua përdor 20 mijë fjalë në ditë kurse burri përdor vetëm 7 mijë fjalë. Ky studim tregon se gratë flasin tre herë më shumë se burrat. Ky është një ndryshim biologjik mes gruas dhe burrit.

Ndryshimet mes dy gjinive mund të vihen re që në moshë të vogël. Vajzat janë të prira që të flasin në moshë më të re se djemtë. Vajzat e vogla janë më të afta për ta shpjeguar diçka me fjalë në krahasim me djemtë. Vajzat që në moshë të vogël janë shumë të ndjeshme dhe më të kujdesshme me sendet e tyre. Ato mund t'i kuptojnë më mirë shprehjet e fytyrës së prindërve të vet dhe si rrjedhojë ato janë më të ndjeshme ndaj çdo teme. Nga ana tjetër, djemtë mendojnë në mënyrë

racionale dhe janë më të interesuar tek zgjidhja e problemit.

Burrat dhe gratë e shikojnë problemin me qëllim të ngjashëm por me metoda të ndryshme. Pjesa më e madhe e grave kanë nevojë që t'i ndajnë shqetësimet me dikë tjetër dhe këtë e shikojnë si afrimetet dhe si një mundësi për të forcuar lidhjen e tyre. Gratë merren më shumë me problemin se me zgjidhjen e tij. Burrat janë të interesuar vetëm për zgjidhjen e problemit. Sipas tyre, zgjidhja e problemit tregon fuqinë e tyre dhe rëndësinë që i jep ai lidhjes. Burrat krenohen me aftësinë e tyre për të zgjidhur probleme, jo me mënyrën sesi është zgjidhur ai problem.

Dihet që gratë janë më të prira për të gabuar sepse ato janë shumë të ndjeshme dhe mendojnë me zemër, jo me logjikë. Burrat kur duan të kujtojnë diçka, përdorin rrugë të ndryshme. Një ngjarje që ka ndodhur më përpara ato e kujtojnë pjesë-pjesë, pastaj i bashkojnë. Burrat janë më të shpejtë për të kujtuar garat ose sjelljet fizike.

Nga të gjitha kuptojmë që ndryshimi në kujtesën e dy gjinive, vjen nga faktorë natyror dhe kimik. Tek gratë, në pjesën e trurit përgjegjëse për kujtesën shikohet një përqendrim i madh i estrogenit dhe progesteronit; kurse tek burrat ka përqindje të lartë të testosteronit.

Për shembull; një grua teksa është duke diskutuar, mund të kujtohet për një çështje të së kaluarës dhe ta përmend atë. Le ta përfundojmë shkrimin tonë me një histori nga jeta e përditshme:

SHEMBULL NGA JETA

Ishin në mes të një grindjeje. Ishin duke diskutuar për një ngjarje që kishte ndodhur atë ditë. Tema kishte lidhje me familjen e burrit... Teksa po fliste, gruas i vjen në mend një ngjarje e shumë viteve më përpara. Kur kishte qenë e fejuar, vjehrra nuk i kishte blerë orën që i kishte premtuar.

"- Ajo është gjithmonë kështu; sikur të isha sado pak e rëndësishme për të do ta mbante fjalën. Ajo nuk më bleu as një orë."

Burri shtanget dhe nuk di se si të përgjigjet.

"- Sa shumë që të pëlqyekan orët!"- i thotë i habitur.

Tashmë u hap një temë e re diskutimi...

Gruaja lëndohet shumë nga ajo fjalë e burrit dhe në shtëpi fillon një grindje që do të vazhdojë për shumë ditë.

Po, gruaja nuk harron dhe ta kujton diçka në



një moment që ti nuk e pret.

Burri nuk arrin ta kuptoj dot një veprim të tillë dhe shtanget para tij; as nuk mundet që t'i jap zgjidhje as nuk mundet të largohet prej kësaj .

Gjendja bëhet më kritike kur burri përgjigjet më një fjali të gabuar...

Në grindje të tilla , burrat zakonisht përpiqen që të dalin nga situata me fjalët: “po të dëgjoj” dhe “ të kuptoj”.

Gruaja nuk dëshiron ta dëgjoj burrin e vet; ajo do që fjalët e saj të kuptohen teksa ajo përpriqet që të shpjegoj atë që ndjen. Ajo dëshiron që t'i ndaj ndjenjat dhe mendimet e veta me bashkëshortin.

ÇFARË DUHET BËRË?!

Në çaste diskutimi, pushoni së foluri dhe dëgjoni se çfarë ju thotë gruaja / burri. Thoni shpesh njëri-tjetrit : “ Unë të kuptoj ...” Kjo është një përgjigje shumë e favorshme në çaste kaotike sepse ul nivelin e nervozizmit .

Shkurtimisht mund të themi:

- Gratë flasin tre herë më shumë se burrat.
- Gratë bëjnë kujdes për detajet dhe janë vëzhguese të mira. Burrat janë përgjithësues.
- Gratë i shikojnë gjërat me kujdes dhe nuk harrojnë kollaj. Burrat e kanë kujtesën me pjesë dhe i bashkojnë pjesët ato në fund.
- Gruaja është e interesuar për zhvillimin e ngjarjes kurse burri për përfundimin. (Shumica e problemeve në familje burojnë nga ky dallim mes gjinive)
- Gratë kanë mendime abstrakte kurse burrat kanë kujtesë konkrete.

- Për gruan, të diskutosh një problem është një gjë shumë e rëndësishme.

- Gratë në përgjithësi merren me problemin kurse burrat merren vetëm me zgjidhjen e problemit. Burri nuk mjaftohet me dëgjimin dhe kuptimin e problemit, ai ka nevojë që të gjejë një zgjidhje.

- Burrat nuk i japin shumë rëndësi mënyrës së zgjidhjes, ato i gëzon vetëm përfundimi.

- Gratë kanë kujtesë shumë të mirë dhe shpesh hapim tema shumë të vjetra.

- Gratë kanë aftësi të mira për të menaxhuar gjërat, punët dhe lidhjet.

Ndryshimet mes dy gjinive nuk duhet të jenë shkas për të hapur diskutime, ato janë burim i diversitetit dhe pasurimit të jetës.

Ndryshimet mes gruas dhe burrit duhet të shfrytëzohen për mirë. Bashkëshortët duhet që t'i dëgjojnë mendimet e njëri-tjetrit dhe të përfitojnë prej tyre. Kur burri dhe gruaja plotësojnë njëri-tjetrin lidhja bëhet më e fortë dhe më e bukur.

Në të vërtetë, ndryshimet nuk janë luftë për pushtet.

Këto ndryshime duhen shqyrtuar me kujdes dhe duhet krijuar mundësia për të mbajtur gjallë respektin dhe dashurinë në familje. Martesa nuk është një ditë e zezë , përfundimin e së cilës mezi e presim... Ajo është një kopsht qetësie e lumturie, që na jep motiv në mëngjesin e çdo dite të re. Le të jenë frutat e martesave tona : breza të drejtë e të mirë.

SI TË PËRMIRËSONI QARKULLIMIN E GJAKUT në mënyrë natyrale

Qarkullimi i gjakut është tepër i rëndësishëm për shëndetin.

Nëpërmjet sistemit të qarkullimit, organizmi furnizohet rregullisht me gjak, në mënyrë që muskujt dhe organet të funksionojnë siç duhet.

Kur qarkullimi i gjakut është problematik, atëherë njeriu mund të përballë me simptomat e mëposhtme: Rëndesë, mungesë energjie, ndjesi dhimbjeje të fortë në gishta dhe gjymtyrë, mpirje të trupit.

Për fat të mirë, ka disa metoda të cilat mund të përmirësojnë qarkullimin e gjakut, të cilat do t'i mësoni në artikullin e mëposhtëm.

SI FUNKSIONON QARKULLIMI I GJAKUT

Zemra pompon gjak të pasur me oksigjen që i dërgohet trurit, mëlçisë, veshkave, stomakut dhe muskujve.

Gjaku që dërgohet në këto organe rikthehet në zemër.

Gjaku që nuk ka oksigjen të mjaftueshëm lëviz nëpër vena dhe drejt e në zemër.

Nga aty, shkon në mushkëri ku merr oksigjen të pastër.

Ky cikël përsëritet kur gjaku i pasur me oksigjen rikthehet në zemër nga mushkëritë dhe pompohet sërish për në të gjithë organizmin.

Disa nga ushqimet më të mira për të përmirësuar qarkullimin e gjakut janë:

SPECI I KUQ

Speci i kuq pluhur përmban kapsaicinë, një substancë që rregullon nivelin e kolesterolit, pastron enët e gjakut dhe vetë atë.

Këtë erëz mund ta përdoni në disa gatime, supa dhe lëngje.

Një i tillë ka të bëjë me përzierjen e lëngut të tre limonëve, dy gotave me ujë, një

luge gjelle me mjaltë dhe dy lugë çaji me spec të kuq pluhur.

Lëngun futeni në frigorifer dhe servireni.

Pini një ose dy gota në javë.

FËRKIMI I TRUPIT

Fërkimi i trupit me një furçë të butë por të thatë përmirëson paraqitjen e lëkurës, rrit furnizimin e gjakut, u jep qelizave më shumë oksigjen dhe përmirëson qarkullimin.

Blini një furçë druri të butë dhe bëjini trupit masazh me lëvizje rrethore.

Bëjeni masazhin dy herë në javë.

Ky masazh është i dobishëm kundër celulitit dhe eliminon qelizat e vdekura.

BANJË ME UJË TË NXEHTË DHE TË FTOHTË

Banajat me ujë të nxehtë dhe të ftohtë përmirësojnë qarkullimin.

Uji i ftohtë kontraktton enët limfatike ndërsa uji i ngrohtë i zgjeron ato.

Alternimi mes të dyjave përmirëson qarkullimin në enët e gjakut.

Rekomandohet që të alternoni dushin mes ujit të ftohtë dhe atij të nxehtë për çdo pesë minuta.

KËRCIMET NË AJËR

Kërcimi në ajër përmirëson qarkullimin dhe shpërndarjen e mirë të gjakut në të gjithë në organizmin.

Qëndroni drejt me duart e lëshuara në anë. Këmbët mbajini të veçuara por në drejtim paralel me shpatullat.

Përkulini gjunjët dhe hidhuni sa më lart në ajër.

Në të kundërt mund të përdorni një litar.

Për një qarkullim efikas duhet të kërceni çdo ditë 30 herë me intervale të shkurtra.

REKOMANDIME TË TJERA

Ushqehuni shëndetshëm me perime dhe fruta.

Pini 1.5 deri në 2 litra ujë në ditë, por mos e teproni nëse e shihni që fryheni.

Konsumoni ushqime të pasura me fibër që ulin

kolesterolin, vitaminë C dhe E.

Mos u stresoni shumë.

Hani më shumë hüdher.

Mjaftojnë disa ndryshime dhe do të ndiheni plot gjallëri dhe me një qarkullim të mirë të gjakut.

Si ndikon dimri

TEK SHËNDETI I TË GJITHË ORGANIZMIT

Kur flasim për dimrin përjetimet dhe mendimet mund të jenë të ndryshme.

Ka persona që stinën e ftohtë e pëlqejnë dhe ka të tjerë që nuk e preferojnë aspak.

Përtej preferencave, dimri njihet si stina ku viruse të ndryshme gripale prekin organizmin për shkak të motit të ftohtë.

Temperatura të cilat kanë shumë ndikim tek procese apo funksione të të gjithë trupit.

Pyetjes se, nëse kjo periudhë e vitit i bën mirë trupit i përgjigjen e ekspertët.

Ndiqui më poshtë të gjitha këshillat e tyre mbi ndikimin e dimrit në organizëm.

I FTOHTI DHE TRURI

Nëse e keni pyetur veten a është i ftohti mirë për shëndetin e trurit tuaj, përgjigja është po.

Ekspertët thonë se, truri funksionon më mirë dhe më shpejt kur ndodhet në një ambient të ftohtë të, në krahasim me të nxehtin.

Kështu që shëtitjet herë pas here jashtë ambienteve të mbyllura gjatë dimrit janë rifreskuese për trurin.

DJEG KALORITË

Gjatë periudhave të të ftohtit trupi harxhon më shumë energji për të mbajtur një temperaturë të balancuar trupi.

Për këtë arsye ju ndihmon që të digjini më shumë kalori e të dobësoheni.

LARGON ALERGITË

Nëse keni alergji nga mjedisi i jashtëm, gjatë dimrit nuk keni pse të shqetësoheni.

Polenet, lulet apo pemët gjatë dimrit nuk janë aspak prezente, ndaj ju mund të dilni e të shëtisni të qetë kudo që dëshironi.

KUNDËR INFLAMACIONIT

Nëse vuani nga fryrja e kyçeve, duarve apo e këmbëve, gjatë dimrit ky problem do të jetë më pak i pranishëm.

Kjo sepse temperaturat e ftohta e ndihmojnë organizmin që të qetësojë zonat ku po zhvillohet inflamacionit.

FLINI MË MIRË

Temperatura e trupit është më e ulët gjatë kohës kur flini gjumë.

Gjatë verës procesi i uljes së temperaturës për të siguruar gjumë të mirë zgjat rreth dy orë, ndërsa në dimër kryhet shumë më shpejt.

I BËN MIRË LËKURËS

Moti i ftohtë i bën mirë lëkurës sipas ekspertëve.

Temperaturat e ftohta ngushtojnë enët e gjakut që kalojnë në lëkurë dhe funksionojnë si një tonik natyral.

Sigurisht bëhet fjalë për temperatura të ftohta normale dhe jo për periudha të acarta të papërballueshme për trupin e njeriut.

ZBULOHEK HARTA E EMOCIONEVE FALE FILMIT "FORREST GUMP"

Gëzimi, euforia, zemërimi, trishtimi dhe melankolia. Të gjitha emocionet e jetës sonë janë mbyllur në vetëm tre centimetra katrore të trurit, në kryqëzimin e duhur temo-parietal.

Për ta identifikuar këtë gjë, ishte e mjaftueshme për të "ndeuzur" në trurin e disa vullnetarëve përmes vizionit të një filmi shumë emocional si "Forrest Gump".

Ky zbulim, i cili mund të ketë pasoja të rëndësishme për trajtimin e depresionit dhe fobive, është botuar në revistën "Natyrë Communications" nga studiuesit e Laboratorit Molekular Mind në Luka.

Grupi i studiuesve, i udhëhequr nga psikiatri Pietro Pietrini, zbuloi se truri është në gjendje të përfaqësojë topografikisht kompleksitetin e asaj që ndien.

Mekanizmi është pak a shumë i njëjtë me funksionet themelore siç janë shikimi, dëgjimi, era, shija dhe prekja.

Çelësi për ta demonstruar këtë ishte filmi "Forrest Gump".

Të dhënat u krahasuan më pas me ato të marra në Gjermani me 15 persona të tjerë, të përfshirë në shikimin e të njëjtit film, ndërsa aktiviteti i tyre i trurit studiohej me imazhe funksionale të rezonancës magnetike.

Në këtë mënyrë ishte e mundur të tregohej se ekzistojnë rajone të trurit të afta të parashikojnë gjendjen shpirtërore që na përfshijnë në një moment të saktë, duke na dhënë përsëri hartën e përvojës sonë emocionale.

QELIZAT E TRURIT VEPROJNË NË KOR

Qelizat e trurit nuk janë të vetmuara, por në shumë raste ato veprojnë si në një kor duke ndarë aktivitetin e tyre elektrik, sipas zbulimit të botuar në "Journal of Neuroscience".

"Si një libër, ku faqet individuale nuk janë të ndryshme, por tregojnë pjesë të vogla të tekstit të zakonshëm ose si një grup njerëzish që fishkëllejnë një motiv shumë të ngjashëm", shkruajnë studiuesit, të cilët zbuluan fenomenin e quajtur "korrelacion".

Studiuesit vëzhguan aktivitetin e dy neuroneve ngacmuese, pra të atyre që stimulojnë aktivitetin e neuroneve të tjera dhe të neuroneve frenuese, të cilat bllokojnë veprimin e dy të parëve.


Zbulimi tregon se qelizat ngacmuese kanë tendencë të preferojnë individualitetin dhe të zvogëlojnë tepërcën e mesazheve të veta, ndërsa ato ndaluese reagojnë si një kor. Të gjitha këto na lejojnë të shtojmë një pjesë të re në të kuptuarit se si neuronet organizojnë informacionin në tru.

ZBULOHEN ALGORITMET E BUKURISË

Është përmbledhja e parë e perceptimit të bukurisë, pavarësisht nga karakteristikat e detajeve individuale.

Inteligjenca artificiale e demonstroi këtë, falë algoritmeve të zhvilluara në Itali, në studimin e kryer nga Departamenti i Fizikës i universitetit "La Sapienza" të Romës dhe botuar në revistën shkencore "Reports".

Metoda e analizës është rezultat i Vittorio Loreto, i cili së bashku me Miguel Ibanez-Berganza dhe Ambra Amico gjetën algoritme të afta për të identifikuar vetitë e fytyrës nga të cilat varet perceptimi i bukurisë duke siguruar kështu një përgjigje të teknologjisë së lartë për një pyetje antike.



Nga letërsia në pikturë, në fakt, nuk ka qenë kurrë e lehtë të përcaktohen kriteret që përcaktojnë bukurinë në mënyrë unike dhe askush nuk ka gjetur kurrë një rregull të thjeshtë për të përcaktuar karakteristikat e një fytyre të bukur.

Tani përgjigja tregon se një përcaktim universal nuk ekziston.

Pika e fillimit ishte imazhi dixhital i një fytyre, detajet e së cilës u modifikuan nga vullnetarët që morën pjesë në eksperiment.

"Qasja jonë, bazuar në algoritmet e deformimit të imazhit dhe algoritmet gjenetike, lejon që subjekti eksperimental të 'skalisë' variantin e tij të preferuar të një fytyre referimi", theksuan autorët.

A ËSHTË TKURRUR MALI MË I LARTË NË BOTË?

Nepali po dërgon një ekip ekspertësh alpinistësh, për të rimatur lartësinë e malit Everest mes frikës së është zvogëluar pas një tërmeti të vitit 2015.

Katër alpinistë të emëruar nga qeveria, të cilët kanë kaluar dy vjet trajnim për ekspeditën, do të shkojnë në vargun e Himalajeve, në kufirin midis Nepalit dhe Kinës për të kryer misionin e tyre. Shkencëtarët besojnë se maja e malit më të lartë në botë, mund të jetë shkurtuar nga një termet shkatërrues, me 7.8 magnitudë në Nepal.

Është hera e parë që vendi ka dërguar ekipin e tij për të kryer një studim të malit më të lartë të botës. Lartësia zyrtare e Everestit është 8.848 metra dhe është regjistruar së pari nga një sondazh indian në vitin 1954. Ekipet e shumta të tjera kanë matur kulmin, edhe pse lartësia e 1954-ës mbeten zyrtare dhe e gjerësisht.

Por një debat i nxehtë shpërtheu pas një tërmeti masiv në Nepal më 2015, me sugjerime se dridhja e fuqishme mund të kishte shkurtuar lartësinë e majës së malit. Si pasojë e kësaj, autoritetet nepaleze urdhëruan matjen e lartësisë së Everestit dhe në vitin 2017, nisën përgatitjet e ekspeditës, për të sqaruar dyshimet.





Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

- 1 Staf arsimor cilësor
- 2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta
- 3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive
- 4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar
- 5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)
1
NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“Bindjuni Allahut
dhe të Dërguarit të Tij
dhe mos u grindni
ndërmjet jush,
sepse do të humbni guximin
e do t’ju lërë fuqia.
Bëhuni të durueshëm,
sepse Allahu, me të vërtetë,
është me të durueshmit.”

(Enfal, 46)

